



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

TABELA E PËRMBAJTJES:

• Fjala e Kryetarit të Komunës.....	fq. 3-4
• 01 Zyra e Kryetarit të Komunës.....	fq.5-45
• 02 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.....	fq.46-56
• 03 Drejtoria e Financave.....	fq.57-78
• 04 Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.....	fq.79-84
• 05 Drejtoria e Infrastrukturës.....	fq.85-90
• 06 Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.....	fq.91-95
• 07 Drejtoria e Arsimit.....	fq.96-112
• 08 Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	fq.113-131
• 09 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	fq.132-202
• 10 Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit	fq.203-213
• 11 Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë.....	fq.214-222
• 12 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.....	fq.223-234

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Viti 2020 në nisjen e tij ishte me ritmin e punës për ndryshimin e Ferizajt. Ishin ditët e para të tij, kur me patjetër, projektet nisën të zhvilloheshin pandalshëm për ta bërë më të mirë jetën e ferizajasve. Por, pikërisht në këtë hov pune, ishte dhe është pandemia globale COVID-19, që bëri të ndalojnë të gjitha zhvillimet normale në përditshmërinë e zakonshme të punës sonë dhe të qytetarëve. Që nga dita e parë e shpalljes së gjendjes emergjente, përkitazi me këtë krizë shëndetësore, mbledha të gjithë akterët relevant të shëndetësisë, sigurisë, inspektimeve, shërbimeve publike dhe formuam Shtabin Emergjent Lokal, institucion ky që do të bart mbi supe gjithë menaxhimin lokal të pandemisë e që në këtë rast, paraqet punën me shtrirjen më të gjerë duke qenë aktiv gjatë gjitha vitit në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve dhe ndihmës për familjet në nevojë dhe bizneset. Qytetarët u mbyllën brenda shtëpive të tyre, pothuajse gjithçka u mbyll dhe humbi kuptimin e normalitetit. Ishte frika nga armiku i padukshëm që sfidoi e kërcënoi shëndetin e gjithsecilit. Megjithatë, ekipet tona të formuara enkas për menaxhimin e kësaj situate, me dorën e mbështetjes e solidaritetin e pashoq të dhjetëra bizneseve vullnetmira, ia dolëm të menaxhojmë pandeminë në pikëpamje të ndihmës për nevojtarët. Janë mbi 5000 pako ushqimore, higjienike, materiale didaktike, pajisje teknologjike e të tjera me të cilat u ndihmuam mijëra familje ferizajase që u ndodhën në vështirësi ekonomike nga kjo pandemi. Vlen të theksohet edhe mobilizimi i gjithë levës sonë qeverisëse, duke bërë dezinfektimin e hapësirave publike, shtimin e kontroleve inspektuese, ndalesat e veçanta si masë lokale të parandalimit të përhapjes së virusit, bën që me përpjekje maksimale të arrihet që të mbrohet shëndeti i qytetarëve dhe rastet e para me virusin SARS Cov-2 të paraqiteshin më vonë në Komunën tonë sesa në komunat tjera, pa lënë anash as faktin e ndarjes së fondit financiar nga Komuna për ndihmë nevojtarëve dhe lehtësirat që ndërmorëm karshi dhe në ndihmë bizneseve. Këtu, as që mund të parafytyrohet menaxhimi i suksesshëm i pandemisë, pa angazhimin e jashtëzakonshëm, mbinjerëzor, të stafit shëndetësor, mjekëve e infermierëve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt, Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Ferizaj dhe gjithë grupet tjera që ndihmuam në aspektin shëndetësor, heronj të vërtet që bën pandeminë më lehtë të menaxhueshme e shëndetin e qytetarëve në duar të sigurta.

Edhe në pikëpamje të investimeve publike, ndonëse pandemia pllakosi e paralizoi pothuajse gjithë veprimtarinë, shënuam suksese domethënëse.

Përparuam deri në përfundim punët për Rrethin e Madh në kuadër të projektit transformues urban “Bashkimi i Qytetit”, përruam një vepër arti në infrastrukturën rrugore siç është nënkalimi në fshatin Varosh-Nikadin, avancuam punimet në tjetrën vepër publike infrastrukturore të nënkalimit për vetura në rrugën “Liman Reka”, pas dekada lënie patrajtuar, transformuam zonën urbane duke rregulluar trotualet e mbjellë drunj dekorativ përgjatë gjithë rrugës së qendrës “Dëshmorët e Kombit”, asfaltuam dhjetëra rrugë me qindra kilometër gjatë për mijëra familje anembanë Ferizajt, investuam si asnjëherë më parë në shenjëzimin rrugor, shtrimë 109 km rrjet të ri të ndriçimit publik, nisëm ndërtimin e Stacionit të Ri të Autobusëve në lokacion të ri, vendosëm gurthemelin e kopshtit të ri për fëmijë në rrugën “Rexhep Bislimi” objekt me shtrirje 2100m² dhe kapacitet pranimi të 200 fëmijëve, përruam një nga fazat e projektit unik në Kosovë – Parkun Memorial të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Jezerc, dinamizuam punimet për ndërtimin e dy shkollave të reja të mesme, përfituam projektin madhor infrastrukturor për rrugën Prelez i Jerlive- Fshat i Vjetër me katër korsi dhe rikonstruktim tërësor të urës në Bibaj, dyfishuam numrin e studentëve përfitues të bursave komunale,

renovuam dhjetëra nyje higjienike-sanitare dhe rregulluam oborre duke transformuar shumë nga shkollat tona, nisëm ndërtimin e shkollave në Talinoc të Muhaxherëve, Zaskok dhe Shkollës Model “Ahmet Hoxha”, ndërtuam për herë të parë në Ferizaj fushat e tenisit dhe të pingpongut, nisëm ndërtimin e objektit kulminant kulturor, atë të Pallatit të Kulturës, për herë të parë punësuam me kontrata të rregullta pune aktorë dhe staf artistik e teknik në Teatrin “Adriana”, transformuam hapësirat e modernizuam shërbimet për qytetarë në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve, hapëm Zyrën për Zhvillimin Ekonomik për ofrimin e asistencës dhe lehtësirave për bizneset, përruam Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dardani, të tri nivelet e shëndetësisë u bënë bashkë, për të ofruar mijëra shërbime shëndetësore për pacientët e infektuar me COVID-19 dhe sëmundjet tjera, nisëm procedurat për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Softaj, renovuam tërësisht duke e kthyer në një ambient miqësor, Zyrën e Kontaktit për fëmijët me prindër të divorcuar pranë Qendrës për Punë Sociale, krijuam dhe mbështetëm fuqishëm, të parët në vend, Shërbimin psikologjik dhe logopedik me konsulta falas për qytetarët gjatë pandemisë, hapëm Ambulancën Veterinare Shkollore, të parën e këtij lloji në gjithë Republikën, rregulluam Parkun e jashtëzakonshëm të pishave në zonën Mirosalë-Rahovicë, ndërtuam tualetet publike të munguara për vite në Parkun e Lirisë, mbështetëm 38 biznese prodhuese e të tjera me makineri e pajisje pune në kuadër të Fondit të Punësimit, mbështetëm ndërtimin e sistemit antibreshër për mbrojtjen e kulturave bujqësore nga fatkeqësitë natyrore, qindra bujq e fermerë përfituan subvencione dhe mekanizëm bujqësor gjatë gjithë vitit, mbollëm 30,000 lule e mbi 1000 drunj në hapësirat e gjelbërta në qytet e fshatra, shpërndamë 500 komposterë dhe shumë kontenjerë familjar për nevojat e qytetarëve, ndihmuam mbi 5000 familje me pako ushqimore e higjienike gjatë gjithë pandemisë, nisëm procedurat për ndërtimin e shtëpive për 22 familje në kushte të rënda ekonomike, ndërtuam 8 hidrantë (pika grumbulluese të ujit) për të shkurtuar kohën e reagimit në raste të fatkeqësive nga zjarri, furnizuam si asnjëherë më parë me pajisje e materiale pune Brigadën e Zjarrfikësve në Ferizaj, nisëm ndërtimin e objektit modern të KRM “Pastërtia” në lokacion të ri, investuam në blerjen e automjeteve të reja bartëse për grumbullimin e mbeturinave, nisëm ndërtimin e Fabrikës së Ujit për të ofruar furnizim të rregullt me ujë të pijes për dhjetëra fshatra e shtim të kapaciteti për fshatrat tjera, përfunduam investimet në sigurimin e furnizimit me ujë të pijes në fshatin Greme, eliminoam problemin me ujërat e zeza në fshatin Tërrn dhe fshatrat përreth, transformuam infrastrukturën rrugore në pjesën kryesore të qytetit, ndërtuam kënde lojërash në parqe e hapësira tjera publike në qytet dhe fshatra, investuam në infrastrukturën dhe promovimin e turizmit në Ferizaj e shumë projekte të tjera, për të mos u ndalur asnjë ditë të vetme në synimin tonë për ta bërë Ferizajn më të mirë, më të zhvilluar në çdo pikëpamje, ashtu siç jemi zotuar e kemi marr besimin e ferizajasve.

Ndonëse vit me vështirësi të shumta të shkaktuara nga pandemia COVID-19, fare qartë, Ferizaj edhe në vitin 2020, përjetoi investime si asnjëherë më parë, vizion e vullnet që karakterizon punën tonë të përditshme për Ferizajn siç e meritojnë ferizajasit.

Ju faleminderit!

Me respekt,

Agim Aliu

Kryetar i Komunës së Ferizajt



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA LIGJORE

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2020

Për periudhën kohore 03.01.2020 e deri më 31.12.2020, Zyra Ligjore ka kryer punët si në vijim:

1. Janë pranuar dhe evidentuar si kërkesa nëpërmjet zyrës pritëse 562 lëndë të qytetarëve të cilat janë drejtuar Zyrës së Kryetarit të Komunës, të cilat janë proceduar;
2. Janë mbajtur gjithsej 634 seanca në çështje kontestimore pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, degën në Shtëpi të Gjykatës Themelore në Ferizaj si dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Divizioni për konteste administrative;
3. Janë ushtruar 83 ankesa kundër Aktvendimeve – Aktgjykimeve për shkallën e dytë të Gjykatës kompetente;
4. Janë ushtruar 4 prapësime për përmbarim në gjykatën përmbarimore;
5. Janë ushtruar 442 përgjigje në padi në Gjykatën Themelore në Ferizaj;
6. Janë përgatitur gjithsej 770 shkresa të ndryshme (vendime, njoftime, formime të komisioneve të ndryshme që kanë rrjedhë nga Zyra e Kryetarit të Komunës);
7. Janë pranuar dhe adresuar gjithsej 562 kërkesa të ndryshme zyrtare;
8. Janë hartuar 4 rregullore të ndryshme dhe janë dërguar për aprovim në Kuvendin e Komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PROKURIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

[illegible]

[illegible]

Vegetation per plot/simulacrum reported:

[illegible]



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PERSONELIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Në Zyrën e Personelit gjatë periudhës 1 vjeçare Janar – Dhjetor 2020 janë kryer këto punë dhe detyra:

- Zyra e Personelit për çdo ditë ka mbajtur evidencë dhe ka nxjerrë raporte të vijueshmërisë së nëpunësve civil;
- Gjatë muajit Janar 2020, Zyra e Personelit kryesisht është marrë me procesin e pranimi të formularëve të vlerësimit të shërbyesve civil nga ana e drejtorëve të drejtorive;
- Janë përgatitur kërkesa për rivlerësimin e titujve të punës gjegjësisht për ndryshimin e koeficienteve të pagave mujore për shërbyes civil dhe janë përcjellur në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës.
- Janë përgatitur 54 kërkesa të pushimit për shërbyes civil;
- 11 punëtor janë pensionuar gjatë vitit 2020 dhe të njëjtëve iu është lëshuar vendimi;
- Gjatë vitit 2020 janë hartuar konkurse për plotësimin e vendeve të lira të punës gjegjësisht stafit të Teatrit “Adriana” përkatësisht stafit administrativ-teknik dhe aktorëve. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit është përgatitur dosja dhe janë kompletuar dokumentet për zyrtarët e pranuar në punë. Për të gjitha këto vende të punës është hartuar përshkrimi i detyrave të punës, është hartuar konkursi dhe është përgatitur për publikim konform ligjeve në fuqi. Konform Ligjit të Punës dhe Ligjit të Teatrove janë hartuar dhe kompletuar formularët;

- Është udhëzuar dhe monitoruar Komisioni i Ankesave për mbarëvajtjen e shqyrtimit të ankesave;
- Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar 34 ankesa;
 - Gjatë vitit 2020 janë përgatitur 4 vendime për pushim të lehonisë;
 - Me kërkesën e MAP-it janë plotësuar formularët si më poshtë:
 - Plan i vjetor për trajnime;
 - Regjistri i shërbyesve civil të cilët pensionohen në vitin 2020;
 - Formulari i planifikimit të personelit për vitin 2020 (përmes SIMBNJ);
 - Formulari individual i trajnimit.
- Janë përgatitur formularët për paga dhe janë dërguar në MEF në formë elektronike si dhe për pagat e anëtarëve të Asamblesë dhe të Komiteteve për seancat e tërë vitit;
- Është dërguar në MAP raporti për strukturën e të punësuarve në Shëndetësi, Arsim dhe Administratë për periudhat tre mujore Janar-Mars, Prill-Qershor, Korrik – Shtator, Tetor – Dhjetor 2020;
- Është plotësuar raporti statistikor për vitin 2020;
- Janë skanuar 19 dosje të punëtorëve. Këto janë bërë në përputhje me rregulloren për dosje;
- Janë nxjerrë vërtetime për punëtorë dhe për praktikantë;
- Janë përgatitur vendime për përvojën e punës për punëtorët e rinj dhe punëtorët që kanë sjellë dëshmi shtesë të përvojës;
- Për çdo muaj janë plotësuar formularë të ndryshëm për paga të punëtorëve;
- Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur kontratat për punëtorët e rinj (aktorët dhe stafin tjetër të teatrit);
- Janë nxjerrë nga sistemi dhe janë printuar regjistrat e pagave për punëtorët e administratës komunale, punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë për vitin 2020 të cilat janë kompletuar dhe janë dërguar për nënshkrimin e pagave nga ana e të punësuarve;
- Janë kontaktuar vazhdimisht përmes postës elektronike zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe janë dërguar shkresa të ndryshme për ndryshim të koeficientëve të punëtorëve për pagesën e beneficioneve tjera;
- Urdhërpagesat për pagat ose (CPO-të), për të gjitha kodet buxhetore janë dërguar të nënshkruhen nga të gjithë drejtorët e Drejtorive dhe pas nënshkrimit origjinalet janë dërguar në MEF;
- Janë hartuar 2 njoftime për rezultate të konkursit të aplikantëve;

Zyra e Personelit përpos punëve të përditshme ka zhvilluar konsultime të ndryshme me nëpunësit civil lidhur me të drejtat e tyre edhe me procesin e vlerësimit të shërbyesve civil përkatësisht janë udhëzuar për këtë proces.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Gjatë vitit që sapo lamë pas, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksion në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës z. Agim Aliu, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Komunës së Ferizajt.

Për një vit kalendarik, kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Ferizajt, gjendjen e përgjithshme si dhe menaxhimin e pandemisë COVID-19 në rrethanat lokale.

Pavarësisht asaj që gjatë vitit 2020 kishim edhe pandeminë COVID-19, Zyra e Informimit dhe Komunikimit me Publikun, pavarësisht se me staf të përgjysmuar ka arritur gjithmonë dhe në kohë rekorde që të informojë publikun jo vetëm të Ferizajt, por edhe të gjithë Kosovës në lidhje me gjendjen me të cilën jemi përballur si Komunë. Janë mbi 1000 komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqes dhe faqes zyrtare të Komunës së Ferizajt në rrjete sociale, kanë informuar qytetarët mbi rrethanat e pandemisë, menaxhimin e saj si dhe aktivitetin e përditshëm të Komunës së Ferizajt.

Përveç komunikatave të lëshuara gjatë gjithë kohës, intervistave nga më të ndryshme, zyrtarët e kësaj zyre kanë arritur që të kryejnë edhe shumë punë të tjera të cilat nuk kanë të ndërlidhura drejtpërdrejt me Zyrën e Informimit dhe Komunikimit, detyra këto të deleguara në funksion të menaxhimit më të mirë të pandemisë.

Uebsajti i komunës sonë çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në Komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në Komunë, por edhe jashtë Komunës. Vlen të theksohet se në faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt, janë bërë edhe ndryshime të shumta të cilat shkojnë në të mirë të Komunës sonë, në mënyrë që qytetarët tanë të kenë njohuri të plota lidhur me atë se çfarë punohet konkretisht në Komunën e Ferizajt.

Në mënyrë që Komuna e Ferizajt të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe të mbledhjeve të Kuvendit, publikimin e procesverbaleve të Kuvendit, po ashtu edhe proceverbale të mbledhjeve të

Komitetit për Politikë dhe Financa. Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në faqen zyrtare të Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Vlen të cekët se gjatë viti që lamë pas Komuna jonë ka aprovuar në Kuvendin e Komunës edhe Rregulloren e re të Transparencës, e cila është bazuar në katër udhëzimet e reja administrative të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, por kjo rregullore është dashur të ndryshohet sërish, për shkak të asaj se është bërë ndryshimi i Udhëzimit Administrativ të Transparencës në Ministrinë e Pushtetit Lokal. Në fund të vitit 2020 në bashkëpunim edhe me USAID-in amerikan është arritur që të bëhet edhe Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim 2021-2023.

Zyra për Informim po ashtu ka funksionuar në bazën edhe të Planit të Transparencës, por edhe udhëzimeve të reja administrative të transparencës.

Po ashtu vlen të theksohet se në ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyre. Në kuadër të projektit të USAID-it “Komunë Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse”, është punuar mjaft shumë ku jemi renditur si njëra ndër komunitetet e para sa i përket transparencës në publikimin e dokumenteve të cilat janë të qasshme për publikun.

Përparësi e faqes zyrtare të Komunës së Ferizajt është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në faqen tonë zyrtare, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnimit të uebfaqes komunale nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, zyra jonë nuk ka pasur asnjë probleme sa i përket plasimit të informacioneve, por edhe publikimeve të ndryshme sepse këtë e ka bërë edhe përmes faqes së saj zyrtare në rrjete sociale, ku aty shikueshmëria por edhe përcjellja e informacioneve ka qenë dukshëm më e madhe sesa në uebfaqen zyrtare të Komunës.

Në kuadër të Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun funksionon edhe zyrtari për qasje në dokumente publike. Gjatë vitit 2020, edhe pse në rrethana të pandemisë dhe shpesh me staf të reduktuar si pasojë e vendimit të Qeverisë për masat mbrojtëse, janë pranuar 79 kërkesa, për të cilat – të gjithave i është lejuar qasja, pra nuk ka pasur asnjë refuzim të qasjes në dokumente publike, rekord ky i numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike. Ky fakt flet mjaftueshëm mbi qasjen transparente dhe llogaridhënëse që aplikon qeverisja lokale dhe puna e përkushtimi i Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun.

Veç tjerash, presim që të vazhdojmë me realizimin e objektivave dhe me po të njëjtin ritëm të punës, në mënyrë që ueb faqja e Komunës së Ferizajt, çdo here të jetë e freskët me lajmet më të reja dhe në mënyrë që secili qytetarë të ketë informacionin mbi punën dhe aktivitetet e Komunës së Ferizajt.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

INSPEKTORATI I KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Gjatë vitit 2020, Inspektorati i Komunës së Ferizajt, ka zhvilluar procesin e punës sipas objektivave dhe Planit të Punës të parashikuar për periudhën një vjeçare, si dhe duke i tejkaluar edhe objektivat për shkak të kërkesave të ndryshme dhe pandemisë Covid 19.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

1. Organizimi dhe planifikimi i punëve të brendshme të sektorit;
2. Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja e tyre me pëlqim të kushteve minimale teknike;
3. Inspektimi dhe monitorimi i deponive ilegale të mbeturinave në kuadër të Komunës së Ferizajt;
4. Inspektimi i subjekteve për pajisje me LMK (Leje Mjedisore Komunale);
5. Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për shqiptimin e Gjobave Mandatore;
6. Inspektimi dhe monitorimi i shitësve ambulant;
7. Monitorimi i rrugëve të qytetit;
8. Inspektimi dhe monitorimi i të gjitha shkollave, për plotësimin e kushteve higjienike -sanitare;
9. Inspektimi dhe monitorimi i furrave të bukës për nivelin higjieno – sanitar;
10. Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja me pëlqim për plotësimin e kushteve sanitare;
11. Aksione me Policinë e Kosovës, Stacionin Policor në Ferizaj si dhe Njësinë Kundër Trafikimit me Qenieve Njerëzore;
12. Monitorimi i subjekteve të cilat janë mbyllur për shkak të zhvillimit të veprimtarive devijante;
13. Monitorimi dhe largimi i shitësve ambulantë nga Bulevardi i qytetit;
14. Monitorimi dhe kontrollimi i objekteve me ose pa leje;
15. Lirimi i hapësirave publike në vend punishte;

16. Lirimi i trotuareve nga pengesat e ndryshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Kompaninë “Pastërtia”;
17. Kontrollimi dhe monitorimi i thertoreve në baza ditore.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Sektori i Tregut:

Në kuadër të Sektorit të inspeksionit funksionon edhe njësia e Inspektoratit të Tregut.

Në kuadër të Inspeksionit të Tregtisë gjatë kësaj periudhe Janar-Dhjetor 2020 kanë punuar 3 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune dhe 4 Inspektorë Tregu me angazhim të përkohshëm.

Gjatë kësaj periudhe:

- Kemi kryer 249 kontrolle të rregullta me procesverbal të formuar dhe një mori kontrolle vizuale;
- Kemi lëshuar 96 vendime për dhënien e pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për ushtrimin e veprimtarisë biznesore për subjektet afariste;
- Kemi konfiskuar mallra të ndryshme në 2 (dy) raste;
- Kemi bërë ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë për subjekte afariste në 20 rasteë;
- Kemi shqiptuar 17 gjoba subjekteve afariste për shkelje të ligjeve që janë në kompetenca të Inspeksionit të Tregut;
- Kemi punuar gjatë pandemisë që prej fillimit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Rajoni i Ferizajt, Inspektorët e punës, Inspektorët e ATK-së, pas orarit të rregullt të punës, vikendeve dhe festave me ç’rast kemi shqiptuar 76 gjoba për shkeljet e konstatuara nga lëmia jonë.

Sektori Sanitar:

Në periudhën Janar-Dhjetor 2020 kanë punuar 4 inspektorë në marrëdhënie të rregullte pune dhe një me angazhim të përkohshëm. Gjatë kësaj periudhe:

- Kemi kryer 1178 kontrolle të rregullta;
- Kemi pranuar 108 kërkesa për pranim në objektet afariste në lidhje me kushtet minimale-teknike, sanitare dhe të mbrojtjes dhe sigurisë në punë;
- Kemi 16 kërkesa për asgjësim të produkteve ushqimore të skaduara dhe të dëmtuara në një vlerë prej 132,000 euro dhe të gjitha këto produkte ushqimore janë asgjësuar në mënyrë të kontrolluar;
- Kemi gjithsej 25 lokale të mbyllura, kurse prej tyre 5 lokale kanë mbyllje të përhershme;
- Kemi bërë 5 kontrolle të jashtëzakonshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës- Njësine Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, aksione të përbashkëta për kontrollimin e subjekteve nga lëmitë e hotelierisë.
- Kemi shqiptuar 15 dënime administrative si dhe për disa është inicuar procedura në Gjykatën Themelore të Ferizajt –Departamenti për Kundërvajtje;
- Kemi paraqitur një kallëzim penal ndaj pronarit të një subjekti afarist për shkak të prishjes së vulës zyrtare;
- Kemi marr pjesë në ekshumimin e dy rasteve të personave të vdekur sipas kërkesave të palëve të interesuara;

-Kemi bërë kontroll të rregullt të ujësjellësit të qytetit si dhe ujësjellësve lokal , ku në mënyrë permanente nga QRSHP-ja është bërë analiza e ujit të pijes;

-Janë inspektuar të gjitha objektet shkollore në Komunën tonë duke dhënë vërejtje për eliminimin e parregullsive të konstatuara në to , si dhe gjatë kësaj periudhe të pandemisë për zbatimin e masave kundër Covid-19.

- Që nga fillimi i pandemisë janë bërë inspektime të shumta në lidhje me respektimin e masave anticovid;

- Gjithsej kemi marr 4975 vendime për izolimin e personave të infektuar me virusin SARS-CoV-2 si dhe shfuqizim të vendimeve të njëjta pas shërimit të tyre .

-Për mos zbatimin e masave anti-covid janë inicuar në Gjykatën Themelore - Departamenti për Kundërvajtjeje, 5970 lëndë.

-Në bashkëpunim me QRSHP-në, Rajoni i Ferizajt, janë marr mostrat e ushqimit dhe strishot për përcaktimin e nivelit të higjienës.

Sektori i Ndërtimit:

Inspektorati i Ndërtimitarisë gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2020 ka kryer një varg inspektimesh të rregullta dhe të jashtëzakonshme në gjithë territorin e Ferizajt. Të gjitha këto veprime Inspektorati i Ndërtimitarisë i ndërmori duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit 04/L-110, Ligjit të Inspektoratit të Ndërtimit 04/L-175 dhe udhëzimeve administrative në fuqi. Bazuar në ligjet dhe aktet e lartcekura, si dhe inspektimet e kryera, janë ndërmarrë këto veprime. Në periudhën Janar-Dhjetor 2020 kanë punuar 2 inspektorë në marrëdhënie të rregullte pune.

Lëndë të pranuar nga arkiva (gjithsej)-----15; prej tyre:

- Ankesa (gjithsej- 1), të zgjidhura-----1,
- Kërkesa (gjithsej- 10), të zgjidhura -----13,
- Njoftim ----- 1,
- Inspektime të kryera ----- 160,
- Procesverbale të hartuara ----- 57,
- Vendime për ndërprerje të punimeve-----16,
- Mbyllje të punishtes (vendosje e shiritit dhe shenjës)-----16,
- Vendim –gjoba mandatore-----16,
- Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtës-----4,
- Shkresat për organe dhe institucione tjera-----2,

Përveç këtyre punëve të cekura më lartë, janë kryer edhe punë në bashkëveprim me inspektorët tjerë, përafërsisht 80 inspektime.

Sektori Veterinar:

Inspektorët e veterinarisë gjatë kryerjes së punës së tyre bazohen në Ligjin e Veterinarisë 2004/21, Ligjin e Ushqimit 03/L-016, udhëzimet administrative në fuqi dhe në rregulloret komunale: Në periudhën Janar-Dhjetor 2020 kanë punuar 3 inspektorë në marrëdhënie të rregullte pune dhe 1 inspektor me angazhim të përkohshëm.

Gjatë punës njëvjeçare kemi kryer një numër të konsiderueshëm të kontrolleve veterinarë, kemi kontrolluar gjithsej 1092 therje të kafshëve gjedheve para therjes, gjatë therjes dhe pas therjes, të gjitha këto kërkesa të kafshëve-gjedheve pas therjes kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore të përdoren për konsum human, pastaj janë damkosur dhe pajisur me certifikata shëndetësore të therjes.

Inspektorët veterinar gjatë punës së tyre kanë kryer këto aktivitete :

- Kanë konfiskuar dhe asgjësuar gjithsej 1689 kg mushkëri gjedhi;
- Kanë konfiskuar dhe asgjësuar mëlçi gjedhi gjithsej 635 kg mëlçi gjedhi cilat ishin të prekura nga nekroza dhe parazitë të ndryshëm si: Fasciola, Hepatica, Dicrocelioza, Abscese, tumore , nekroza hepatike etj;
- Kanë konfiskuar dhe asgjësuar 1476 kg mish gjedhi , mish të bluar, mish pule, qumësht dhe produkte të qumështit;
- Kanë hartuar 213 procesverbale të rregullta në terren;
- Kemi qenë monitorues të projekteve të iniciuara nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë për vlerësimin e gjedheve të racës simental të cilat u janë dhënë fermerëve të përzgjedhur të Komunës së Ferizajt;
- Kemi qenë monitorues të projektit për vaksinim të fondit blegtoral, kundër sëmundjeve klostridiale (këmbëzeza);
- Kemi qenë monitorues të projektit për trajtimin e bagëtive të imëta (Dele, Dhi), kundër endo parazitëve;
- Kemi qenë monitorues të projektit të furnizimit me material gjenetik dhe barrësimin artificial të lopëve qumështore dhe mëshqerrave;
- Kemi qenë monitorues të projektit të rregullimit dhe mirëmbajtjes së thundrave tek lopët qumështore;
- Janë paraqitur 6 lëndë në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Departamenti për Kundërvajtje;
- Janë kontrolluar ambulancat veterinarë;
- Janë kontrolluar Tregu i Kafshëve dhe Tregu i Gjelbërt;
- Kemi bashkëpunuar me inspektorët sanitar gjatë kontrolleve në terren.
- Janë kryer edhe punë të tjera në zyrë sipas kërkesave nga palët.

Sektori i Ambientit:

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 kanë punuar 2 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune.

Përshkrimi i punëve zyrtare të kryera gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore:

- Gjatë periudhës kohore dymbëdhjetë mujore janë inspektuar rreth 20 biznese që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale. Numri më i madh i këtyre bizneseve merren me përgatitje të ushqimeve të shpejta, përgatitje të bukës dhe pjekurinave tjera nga mielli, mishtore, përpunues të drurit (mobilerive) etj. Të gjitha këto inspektime janë bërë në bazë të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ 17/2015 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, ku saktësisht precizohet se cilat aktivitete i nënshtrohen LMK-s. Nga këto subjekte afariste është kërkuar që t'i plotësojnë kushtet për pajisje me Leje Mjedisore Komunale.

- Një numër i këtyre subjekteve afariste janë pajisur me LMK, ndërsa tjerat janë në procedurë të pajisjes me LMK.
- Një kujdes i veçantë i është kushtuar mbajtjes së qytetit të pastërt. Kemi pasur disa takime me K.R.M. “Pastërtia” për bashkëpunimin që duhet ta kemi lidhur me mbajtjen sa më të pastër të qytetit. Takime po ashtu kemi pasur edhe me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Kompaninë Publike “Ambienti”, pikërisht për mbarëvajtjen e punëve kolektivisht për një qytet më të pastërt.
- Janë shqiptuar 136 gjoba mandatore duke filluar nga 20 deri në 100 euro, gjoba këto për hedhje të mbeturinave, vajrave në hapësira të ndaluara, shpërndarje të broshurave (fletushkave) promocionale, ndotje të rrugëve etj., që kanë rënë ndesh me Udhëzimin Administrativ në fuqi 06/2018. Vlera monetare e këtyre gjobave arrin shifrën 13,630.00 euro. Të paguara me -50% nga vlera e gjobës totale janë 4180 euro. Të gjitha gjobat e papaguara do të përcillen tek përmbaruesi për ekzekutim të mjeteve monetare.
- Po ashtu pas marrjes së ankesës dhe inspektimit të përbashkët me inspektorët e MMPH-së si dhe me asistimin e Policisë së Kosovës - Rajoni i Ferizajt, është marrë vendim për mbylljen e një subjekti afarist, pasi që nuk ka qenë i pajisur me asnjë dokumentacion për zhvillim të veprimtarisë në fjalë.
- Përveç gjobave edhe përmes një njoftimi të protokolluar i kemi njoftuar qytetarët për orarin e hedhjes së mbeturinave në çdo pjesë të qytetit.
- Kemi pranuar 24 ankesa me shkrim të cilave i jemi përgjigjur në afat të duhur.
- Kemi pranuar po ashtu rreth 40 ankesa verbale nga qytetarët të cilave i jemi përgjigjur menjëherë si dhe efekti ka qenë pozitiv.
- Gjithashtu, gjatë inspektimit në terren kemi bërë 32 procesverbale për konstatim të gjendjes si dhe rekomandime për ecurinë e mëtutjeshme.
- Kemi bërë mbi 30 ditë (orare të ndryshme e jo ditë të plota) inspektime me Insp.Sanitar si dhe të Tregut, lidhur me zbatimin e Ligjit të Ushqimit Nr.03/L-016 Neni 15, si dhe inspektimin e shkollave.
- Po ashtu kemi bërë 15 njoftime/rekomandime me shkrim për eliminimin e deponive ilegale.
- Vëmendje e veçantë i është kushtuar pandemisë Covid-19, me ç’rast kemi qenë të angazhuar lidhur me ecurinë e zhvillimeve dhe implementimin e udhëzuesve të nxjerra nga Qeveria që nga rastet e para me këtë virus.
- Inspektime të kohëpaskohëshme së bashku me Inspektorët e MMPH-së lidhur me Planin Operativ “PARANDALIMI DHE NDALIMI I AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË SEKTORIN MINERAR”.
- Shënimi i Ditës Botërore të Tokës po ashtu me aktivitete simbolike ku pjesëmarrësit ishin të shumtë në shënimin e kësaj dite.

- Pjesëmarrës në sesionet informuese dhe seminarët të organizuara nga OJQ Let's Do It Kosova.
- Kemi qenë pjesë e takimeve të organizuara nga GIZ-i gjerman me temë: PLANI OPERATIV NË KOMUNËN E FERIZAJT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.
- Pjesëmarrës në këtë takim ishim ne inspektorët e mjedisit, GIZ, DSHPE, KIËER, BK Consulting, një grup nga KRM “Pastërtia”.

Spektori Komunal:

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020 kanë punuar 2 inspektorë në marrëdhënie të rregullt pune.

Gjatë periudhës njëvjeçare, Inspektorët Komunal, janë angazhuar për zbatimin dhe implementimin e Rregullores për Rregullin dhe Shërbimet Komunale me nr. 01. Nr. 114 e datës 30/09/2019 të Komunës së Ferizajt. Zbatimi i Rregullores konsiston në mirëmbajtjen e rregullt të hapësirës publike, trotuareve, rrugëve etj.

Vëmendje të veçantë gjatë kësaj kohe i kemi kushtuar trotuareve, parqeve, rrjetit të ujësjellësit të kanalizimit dhe dukurive të tjera negative.

Ne kemi ndërmarrë disa aksione për pastrimin e trotuareve dhe rrugëve të qytetit nga tezgat, reklammat dhe gjësendet të ndryshme për lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve. Këto aksione i kemi kryer me sukses me ndihmën e Kompanive Publike “Pastërtia” dhe “Bifurkacioni” dhe mbështetjen e Policisë së Kosovës – Stacionit Policor në Ferizaj.

Vlen të theksohet se këtë vit për shkak të shtrirjes së rrjetit nëntokësor elektrik nga kompanitë të kontraktuara nga KEDS-i, ka marrë kohë të konsiderueshme, kthimi i rrugëve në gjendjen e mëparshme.

Një nga aksionet që kemi ndërmarr për të gjithë subjektet është urdhëruar që të rregullojnë trotualet nga gjendja e pjerrët në gjendje të rrafshët në mënyrë që të lehtësohet siguria gjatë ecjes së qytetarëve në trotuare dhe kështu të eliminohet mundësia e lëndimeve të ndryshme gjatë kushteve të papërshtatshme atmosferike.

Gjatë këtij aktiviteti kemi proceduar lëndë për veprat e ndryshme si vijojnë më poshtë:

1. Procesverbale - 81 .
2. Gj. Th. Kundërvajtje - 7
3. Kërkesa dhe Ankesa - 105
4. Kallëzime Penale - 2

Vlen të ceket se gjatë kësaj periudhe kohore kemi punuar edhe jashtë orarit të punës si dhe kemi dal në terren në fundjavë gjegjësisht të shtunave dhe të dielave për shkak të respektimit të rregullave të vendosura gjatë kohës së pandemisë .

AKTIVITETET TJERA

Tregu:

- Kontrollimi i të gjitha subjekteve afariste nga Inspektorët e Tregut në kuadër të autorizimeve ligjore;
- Procedimi i lëndëve për procedurën përmbartimore;
- Monitorimi dhe ndalimi i shitësve të mjeteve piroteknike.

Sanitar:

- Kontrollimi dhe monitorimi për kushte higjieno - sanitare në subjektet ushqimore në Ferizaj;
- Inspektime në subjekte afariste të cilat kanë të bëjnë në lidhje me higjienën – sanitari.

Ndërtimi:

- Monitorimi sistematik i objekteve të pajisura me leje ndërtimi;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

Veterinar:

- Monitorimi i të gjitha mishtoreve të cilat operojnë në Ferizaj.
- Veprimet tjera të cilat janë të parapara me Ligj dhe rregullore për këtë inspeksion.

Ambient:

- Monitorimi i deponive ilegale;
- Monitorimi i shitësve ambulant të thëngjillit;
- Njoftimi në vazhdimësi për ruajtjen e ambientit;

Komunal:

- Monitorimi i bulevardit të qytetit;
- Inspektimi në terren në bazë të kërkesave të qytetarëve;
- Monitorimi dhe lirimi i hapësirave publike.

STATISTIKAT

5.1 Punët me palë

- Sektori i tregut – 76 ;
- Sektori sanitar – 91;
- Sektori ambientit - 24;
- Sektori komunal – 95;

5.2 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në procedurë

Sektori i tregut

- Lëndë të kryera – 80 ;
- Lëndë në procedurë 0 ;
- Të refuzuara 2

Sektori sanitar

- Lëndë të pranuar – 5970 nga Policia e Kosovës – Ferizaj, në lidhje me infeksionin dhe pandeminë Covid 19;
- Të kryera 5970
- Në procedurë 0
- Lëndë të pranuar nga arkiva 95
- Të kryera 91
- Të refuzuara 4

Sektori i ndërtimit

- Lëndë të kryera – 15;
- Ankesa 2 të kryera
- Kërkesa 13 të kryera
- 1 Njoftim

Sektori veterinar

- Realizim nga therjet – 4400 €.

Sektori ambientit

- Lëndë të kryera – 24;

Sektori komunal

- Lëndë të kryera – 103;
- Lëndë në procedurë – 2.

SFIDAT

- Këtë vit Komuna Ferizajt konkretisht inspektorati i Komunës përveç sfidave të përditshme në kryerjen e detyrave zyrtare është ballafaquar edhe me situatën e krijuar nga pandemia Covid – 19.
- Gjatë kësaj periudhe për shkak të masave të ndërmarra nga Qeveria Kosovës për parandalimin virusit Covid -19, sektori i inspektoratit të Komunës ka pasur angazhime shtesë, ku si pasojë e këtyre angazhimeve kemi pasur edhe inspektorë të infektuar nga virusi gjë që kemi pasur vështirësi në realizimin e kërkesave nga qytetarët dhe institucioneve tjera relevante.
- Një sfidë tjetër ka qenë edhe mos pagesa e inspektorëve për punët shtesë sipas përgjegjësisë që kanë pasur për parandalimin e përhapjes së virusit Covid -19 dhe duke u nisur nga fakti se inspektorët e Komunës, koeficientin e pagës e kanë në nivelin minimal.
- Mungesa e veturave për Inspektoratin po mbetet ende një problem i madh, duke pasur parasysh numrin e madh të subjekteve dhe ekonomive në Komunën e Ferizajt;
- Mungesa e caktimit të inspektorit të transportit (komunikacionit);



ZYRA E NJËSISË SË AUDITORIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2020. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2020 ka përgatitur Planin Strategjik 2020/2022, si dhe Planin Vjetor 2020 e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2020, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2020-2022-janë të përfshira të gjitha drejtoritë-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2020, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej shtatë (7) auditme të brendshme që janë: katër (4) me rrezik të lartë, tre (3) me rrezik të mesme dhe zero (0) me rrezik të ulët. Mirëpo, për shkak të ndërprerjes së punës gjatë pandemisë një auditim nuk ka mundur të përfundohet.

Për vitin 2020 janë kryer këto auditime:

- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime, komunali, subvencione dhe shpenzimet e derivateve dhe mirëmbajtja e automjeteve- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime kapitale-Drejtoria e Infrastrukturës
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore-Drejtoria e Arsimit
- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Procedurat e menaxhimit të prokurimit për periudhën-Zyra e Prokurimit
- Grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksat e bizneseve dhe qirave-Drejtoria e Financave

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2020, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjashtë (6) auditime të brendshme nga shtatë të planifikuara.

Pra, gjatë vitit 2020, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej gjashtë (6) auditime të brendshme dhe t'i hartoj e dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej gjashtë (6) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë njëzetegjashtë (26) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatitë planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planet e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej njëzetegjashtë (26) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara katër (4)
- Pjesërisht të zbatuara (në proces) trembëdhjetë (13)
- Të pazbatuara nëntë (9)

Trembëdhjetë (13) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2021, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmujorët e vitit 2020 dhe përmbledhjen e vitit ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA PËR INTEGRIME EUROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Zyra për Integritet Evropian funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo zyrë ka rol të koordinimit, monitorimit dhe raportimit në institucionet gjegjëse të cilat merren me integritet evropian. Pra, linjat e komunikimit në mënyrë të vazhdueshme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Integritetit Evropian (MIE).

Gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore, respektivisht Janar - Dhjetor 2020, ne kemi kryer në përpikëri obligimet të cilat i kemi të përcaktuara sipas detyrës zyrtare, pra koordinimin, monitorimin dhe raportimin në institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat merren me integritet evropian.

Kemi bërë raportimin e rregullt periodik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar. Poashtu, kemi kompletuar dokumentacionin dhe dosjet e punëve të kryera. Kemi kryer edhe punë të tjera të arsyeshme zyrtare në kuadër të Zyrës.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Integritet Evropian ka bërë Raportimin e rregullt në MAPL lidhur me implementimin e Planit Individual të Veprimit për Komunën e Ferizajt, dalur nga Agjenda Evropiane për vitin 2020. Kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL, MIE dhe AKK.

Kemi ndërmarr të gjitha ato veprime me prioritet për integritet evropian, me të cilën synohet të jetë krijimi i një klime të volitshme për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së qytetarëve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, tolerancën dhe krijimin e mirëbesimit.

Në periudhën njëvjeçare Janar – Dhjetor 2020 kemi mbajtur kontaktet e përditshme dhe dërgimin e informatave të kërkuara dhe komunikimet tjera me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritet Evropian të MAPL-së, Ministrinë për Integritet Evropian dhe ministritë e linjave.

Në të gjitha takimet konsultative apo tryezat e punës, jemi përgjigjur pozitivisht thirrjeve të ministrive përkatëse, duke dhënë kontributin tonë për çështje të fushëveprimtarisë sonë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Situata pandemike ka penguar aktivitetin e rregullt të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, mirëpo megjithatë, edhe pse me vështirësi për shkak të stafit të reduktuar, kemi arritur t'i përmbushim detyrat tona. Së pari, Komuna e Ferizajt, i është përgjigjur çdo kërkesë të paraqitur pranë zyrës sonë, të qytetarëve në vështirësi ekonomike për t'u ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike. Së dyti, kemi koordinuar të gjitha veprimet me Shtabin Emergjent Lokal, në dobi të komunitetit duke ndihmuar dhe plotësuar kërkesat e tyre të paraqitura pranë zyrës sonë.

Riatdhesimi – Në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve është regjistruar 1 familje me 6 anëtarë të kthyer nga Gjermania, 3 individ të kthyer nga Gjermania, 1 individ i kthyer nga Suedia dhe 1 nga Anglia, dy raste janë nga vitet e kaluara të cilat janë regjistruar në vitin 2020. Nga këto pesë raste janë rekomanduar në Zyrën e Punësimit. Kërkesa për shqyrtim nga Komisioni Komunal për Ri-integrim kemi pasur 2 kërkesa për vazhdim akomodimi, Komisioni Komunal për Ri-integrim ka mbajtur dy takime virtuale në të cilat takim janë aprovuar kërkesat për vazhdim akomodimi.

Vendimet për këto familje janë bashkëngjitur në SMR dhe janë përcjellë tek DRPR-ja. Një kërkesë për akomodim mbetet në proces.

Për shkak të pandemisë numri i personave të riatdhesuar gjatë kësaj periudhe ka qenë i vogël.

Kthimi – Sa i përket kthimit gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur persona të kthyer por as kërkesa të reja për kthim.

Për shkak të pandemisë Covid 19, personat e kthyer por edhe rastet sociale janë përkrahur edhe nga UNHCR, AT si dhe organizata tjera.

Organizata IOM –projekti EU Communiti Stabilization Programme (EU-CSP IV) projekt për stabilizimin e komuniteteve ka bërë thirrje për aplikim, implementimi i këtij projekti ende është në proces.

Draft Planit Komunal i Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme (PKVZHZQ) i cili plan ka mbete në procese për aprovim në Kuvendin e Komunës.

Gjatë viti 2020 janë riatdhesuar 13 persona prej tyre 4 femra dhe 9 meshkuj.

Sipas përkatësisë etnike:

Shqiptar -6 persona (4M -2F, 1 fëmijë -F)

Ashkanli-9 persona (6Mdhe 2F,4 fëmijë-3M-1F).

Kërkesa për përfitim nga fondi për riintegrim 27 për rekomandim te Zyra e Punësimit 23 kërkesa ndërsa për përfitim 4 kërkesa(Akomodim).

Të regjistruar në SMR nga ZKKK-ja kemi 4 raste të vitit 2020 dhe 4 raste të viteve të mëparshme.

KKR ka mbajtur 4 takime në mënyrë virtuale dhe janë shqyrtuar 4 kërkesa, dy për vazhdim akomodimi dhe dy raste të reja (njëra e aprovuar e tjetra e refuzuar).

Gjatë vitit 2020, personat e riatdhesuar janë përkrahur edhe nga organizatat URA2, AËO, DIAKONIA, por ZKKK-ja nuk posedon informatat për aktivitetet dhe ndihmat e ofruara.

Organizata OFAP Kosova ka ofruar shërbime për familjet e riatdhesuar:

Për 7 familje janë ndihmuar 3 herë me pako ushqimore e higjienike.

Për 7 familje të riatdhesuar që kanë fëmijë organizata ka ofruar mbështetje psiko-sociale, gjatë pandemisë por edhe para pandemisë.

Për 7 kryefamiljarë të riatdhesuar janë organizuar trajnime për mbështetje psikologjike.

Familjeve i janë shpërndarë broshura, informata vetëdijësuese për masat mbrojtëse kundrejt Covid 19 janë mbajtur 2 takime me akterët kyç në procesin e riintegrit për personat e riatdhesuar.

Arsimi – Nga ZKKK- ja është paraqitur problemi i ndërprerjes së shkollimit të disa nxënësve në fshatin Dubravë. Nga kryesuesi i Komitetit për Komunitete është organizuar një takim në fshatin Dubravë me të gjithë faktorët relevant që merren me procesin e arsimit. Në koordinim me DKA – në janë regjistruar 3 nxënës të riatdhesuar në shkollën,, Ahmet Hoxha’’.

Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit në Komunën e Ferizajt ka funksionuar si organ administrativ dhe në kuadër të kompetencave të veta ligjore kryen këto punë:

- Zhvillon procedurat lidhur me lëshimin e akteve mbi kushtet urbanistike, lejeve ndërtimore, leje për copëtim të ngastrave kadastrale, lejeve mjedisore komunale, leje për mbindërtim, aneks ndërtim, rekonstruim, leje për rrënimin e objekteve
- Bën vazhdimin e lejeve ndërtimore; kushteve urbanistike; pranimin teknik të objekteve,
- Bën legalizimin e objekteve,
- Menaxhon punën për sistemin e adresave si dhe
- Menaxhon dhe harton plane hapësinore, plane urbanistike dhe përgatit projektvendime për dokumente nga fusha e urbanizmit të cilat i procedon në Kuvendin e Komunës për miratim.

Përveç këtyre kompetencave stafi i kësaj Drejtorie, bën edhe trajtimin e lëndëve për drejtoritë tjera si:

- mbikëqyrjen dhe pranimin teknik të punimeve për projektet kapitale;
- Komisionin për vlerësim të tenderëve;
- Shndërrimet e tokës bujqësore në atë ndërtimore, për zhvillim të veprimtarive të ndryshme;
- Hartimin e projekteve për investime kapitale (PIP)
- Pjesëmarrje në komisionin për evidentimin e rasteve sociale, për ndërtimin e shtëpive dhe riatdhesim. Në këtë kontekst, Drejtori i Urbanizmit dhe Mjedisit, formon një komision ku përfshihet edhe stafi i drejtorisë që realizon projektin.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit është e organizuar në 6 njësi punuese:

- Zyra ligjore me 1 punëtor
- Njësia e Planifikimit Urban me 2 punëtorë të rregullt
- Njësia për dhënien e lejeve me 4 punëtorë të rregullt
- Njësia për Mbrojtjen e Mjedisit me 1 punëtorë të rregullt
- Njësia e Legalizimit me 1 punëtorë të rregullt

Buxheti

Nga totali i Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2020 prej **33,516.833 €**, për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit janë ndarë **217,854.00 €**.

Nga këto, për paga dhe mëditje për stafin prej 10 të punësuarish janë shpenzuar **66,011.00 €**; për mallra dhe shërbime **11,849.00 €** dhe për investime kapitale janë gjithsej **134,013.00 €**.

Të hyrat vetanake

Në vitin 2020, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit ka siguruar të hyra vetanake në vlerë prej **891,866.74 €**. Nga këto, **647,824.07 €** janë të hyra të inkasuara nga taksat për Leje Ndërtimore; të inkasuara nga taksat për Leje Mjedisore Komunale; **147,834.28 €** dhe **90,657.76 €** të hyra të inkasuara nga taksat administrative për Certifikatë Legalizimi.

Azhuriteti – kërkesat e shqyrtuara

Gjatë vitit 2020 kanë arritur një numër i madh i kërkesave nga qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre, gjithashtu është bërë avancimi i punës dhe shërbimeve për qytetarët me theks të veçantë në respektimin e afatit ligjor gjatë shqyrtimit të kërkesave.

Të gjitha njesitë e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit gjatë vitit 2020 kanë pranuar - dorëzuar gjithsej 1219 lëndë të evidentuara në librin intern të protokollit.

Sipas llojit të tyre lëndët ndahen:

- Leje ndërtimore	46
- Kushte Urbanistike.....	48
- Leje Mjedisore Komunale.....	31
- Legalizime të kategorisë së parë	241
- Legalizime të kategorisë së dytë.....	29
- Njoftime, pelqime, vertetime e shkresa te ngjashme.....	824

Objektivat –realizimi i tyre

1. Njëri prej objektivave kryesor të Drejtorisë ka qenë rritja e kualitetit dhe efikasitetit të shërbimeve për qytetarët. Kjo rritje e efikasitetit vërehet tek raporti mes lëndëve të pranura me ato të perfunduara dhe ato në proces.
2. Objektivi tjetër ka qenë finalizimi i procesit për hartimin e Hartës Zonale të Komunes i cili është realizuar afër 90%. Në kuadër të këtij objektivi janë realizuar aktivitete të shumta për përmbylljen e tij. Kanë mbetur vetëm shqyrtimi publik i dokumenteve dhe aprovimi në Kuvendin e Komunës.
3. Funksionalizimi i procesit të legalizimit ka qenë objektivi kryesor i DUM. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit gjatë vitit 2020 ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Mjedisit rreth procesit të legalizimit.

Për realizimin e të gjithë objektivave janë mbajtur diskutime publike me qytetarë dhe grupe të interesit në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga ta dhe nga DUM duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, parimin e pjesëmarrjes publike në proceset zhvillimore.

4. Gjatë vitit 2020, gjegjësisht me në muajin Qershor është krijuar grupi për rregullimin e sistemimit të adresave, qëllimi i këtij grupi ka qenë dhe është që të futen në sistem emërtimet e rrugëve të dalura nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt si dhe rregullimin e numrave. Në kuadër të këtij grupi janë 1 koordinator si dhe dy eksperta të GIS-it.

Raportet sektoriale

Raport për punën e Njesisë së Planifikimit për periudhën Janar - Dhjetor 2020

Kjo Njësi gjatë kësaj periudhe ka punuar në bazë të:

- Vendimeve të miratura nga Kuvendi i Komunës
- Dokumentacionit juridik (Ligjeve, Udhëzimeve Administrative, vendimeve) të aplikueshëm, dhe
- Planeve Urbane ekzistuese të aprovuara,

Në Njësinë për Planifikim Urban gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 kanë punuar:

- 1 (një) udhëheqës i njësisë dhe
- 1 (një) zyrtar i njësisë për planifikim urban

Aktivitetet:

Gjatë muajit Janar 2020:

- Puna me palë;
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve apo kërkesave të qytetarëve rreth PZHK dhe HZK;
- Përmbyllje e punëve dhe sistemim i dokumentacionit nga viti 2020;
- Pjesëmarrja në proces për hartimin e HZK-së;
- Takim pune me kompaninë INSI , përfaqësuesit e MMPH dhe Institutit për Planifikim Hapësinor për hartimin e HZK-së (prezentim i punës së Këshillit Profesional për Urbanizëm);
- Përcjellja e punimeve të projekteve komunale si mbikqyrës apo menaxher i projektit;
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit tenderues të tenderave si anëtar i komisionit vlerësues.

Gjatë muajve Shkurt dhe Mars 2020:

- Puna me palë dhe lëshimi i ekstrakteve nga PZHK;
- Pjesëmarrja në proces për hartimin e HZK-së;
- Takime pune me drejtorin , njoftim me gjendjen në planifikim dhe problemet lidhur me të;
- Punë në plotësimin e databazës për planifikim hapësinor në GIS;
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve të qytetarëve rreth PZHK dhe HZK;
- Takim pune me kompaninë INSI rreth procesit të punës për hartimin e HZK;
- Konsultime për Bifurkacionin rreth vendimit për shpallje si zonë e mbrojtur;
- Përcjellja e punimeve të projekteve komunale si mbikqyrës apo menaxher i projektit;
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit tenderues të tenderave si anëtar i komisionit vlerësues.

Gjatë muajve **Prill, Maj dhe Qershor 2020:**

- Puna me palë dhe lëshimi i ekstrakteve nga PZHK;
- Punë në plotësimin e databazës për planifikim hapësinor në GIS;
- Pranimi i draftit të parë të HZK-së;
- Evidentimi i gabimeve në HZK dhe dhënia e vërejtjeve në pjesën tekstuale dhe grafike;
- Pjesëmarrje në trajnim për emergjenca;
- Pjesëmarrja në proces për hartimin e HZ të Kosovës;
- Përcjellja e punimeve të projekteve komunale si mbikqyrës apo menaxher i projektit;
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit tenderues të tenderëve si anëtar i komisionit vlerësues.

Gjatë muajve **Korrik dhe Gusht 2020:**

- Puna me palë dhe lëshimi i ekstrakteve nga PZHK;
- Pjesëmarrja në proces për hartimin e HZK-së;
- Punë në plotësimin e databazës për planifikim hapësinor në GIS;
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve apo kërkesave të qytetarëve rreth PZHK dhe HZK;
- Përcjellja e punimeve të projekteve komunale si mbikqyrës apo menaxher i projektit;
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit tenderues të tenderave si anëtar i komisionit vlerësues.

Gjatë muajve **Shtator dhe Tetor 2020:**

- Puna me palë dhe lëshimi i ekstrakteve nga PZHK;
- Pjesëmarrja në proces për hartimin e HZK-së;
- Punë në plotësimin e databazës për planifikim hapësinor në GIS;
- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve apo kërkesave të qytetarëve rreth PZHK dhe HZK;
- Përcjellja e punimeve të projekteve komunale si mbikqyrës apo menaxher i projektit;
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit tenderues të tenderëve si anëtar i komisionit vlerësues.

Gjatë muajve **Nëntor dhe Dhjetor 2020:**

- Puna me palë dhe lëshimi i ekstrakteve nga PZHK;
- Pjesëmarrja në proces për hartimin e HZK-së;
- Punë në plotësimin e databazës për planifikim hapësinor në GIS;
- Aktivitete pune rreth fillimit të procesit të legalizimit;
- Krijimi dhe azhurimi i Data Bazës së Legalizimit ;
- Përcjellja e punimeve të projekteve komunale si mbikqyrës apo menaxher i projektit
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit tenderues të tenderëve si anëtar i komisionit vlerësues.

Kemi marrë pjesë në vlerësimin e ofertave të një mori projektsh komunale si anëtar të komisioneve vlerësuese të zhvilluara nga Zyra e Prokurimit. Gjithashtu kemi marrë pjesë edhe në mbikqyrjen apo

menaxhimin e disa projekteve të kontraktuara nga Komuna ku disa janë përfunduar e disa janë ende në proces si dhe punë tjera administrative.

Jemi në proces final të Hartimit të HZK-s në bashkëpunim me Kompaninë “INSI” nga Prishtina e cila është përzgjedhur me procedura të tenderimit për Hartimin e Hartës Zonale Komunale.

Raport i punës për vitin 2020 i Njesisë së Mbrojtjes së Mjedisit

Gjatë vitit 2020, sektori i mbrojtjes së mjedisit pranë Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit ka kryer punët në lidhje me situatën dhe problemet e mjedisit në Komunën e Ferizajt, që shkaktohen nga ndotës të ndryshëm.

Për të gjitha këto probleme kemi koordinuar punën me Departamentin për Mbrojtje të Mjedisit DMM, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor MMPH me Drejtorinë e Inspektoratit në nivelin qendror dhe komunal për eliminimin e çrregullimeve mjedisore dhe atë në bazë të legjislacionit ekzistues deri ku parashihen kompetencat e nivelit lokal dhe atij qendror, me Drejtorinë e Shërbimeve publike, Drejtorinë e Infrastrukturës, me Ndërmarrjet (“Pastërtia”, “Ambienti” dhe “Bifurkacioni”).

Pjesëmarrës në komisione të ndryshme sa i përket lëndëve që duhet të kryhen nga ana e Drejtorisë si:

- Shndërrimet e tokës bujqësore në atë ndërtimore, për zhvillim të veprimtarive të ndryshme,
- Zgjidhjen e lëndëve dhe dhënies së lejeve mjedisore komunale krahas lejeve ndërtimore,
- Zgjidhjes së kërkesave të ndryshme, ankesave
- Bashkëpunim me inspektoratin komunal dalje në terren për eliminimin e parregullësive mjedisore sipas kërkesave të qytetarëve në pjesë të ndryshme.

Pjesëmarrës në:

- Tryeza punuese me njësinë e planifikimit pranë Drejtorisë tonën në përgatitje të hartimit të PZHK,HZ.
- Në diskutimet për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM).
- Pjesëmarrje në konferenca të ndryshme të organizuara nga MMPH, mbështetje institucionale rreth legjislacionit mjedisor e tjera.
- Koordinimi i politikave dhe aktiviteteve mjedisore punuese në nivel komunal dhe qendror.
- Lëshimin e Lejeve Mjedisore Komunale për subjektet mjedisore ne nivel komunal 31.
- Bashkëpunim me zyrtarët për integritet evropiane në aspektin e strategjive të ndryshme në mbrojtje të mjedisit etj.
- Evidentimi i vlerave natyrore në Komunë në bashkëpunim me IKMN, Monumentet natyrore
- Komisione për shqyrtimin e ankesave.
- Debate publike për dhënie te pëlqimeve mjedisore të organizuar nga MMPH.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Arbër Bytyqi
Drejtore i Drejtorisë së Infrastrukturës

Buxheti i Drejtorisë së Infrastrukturës për vitin 2020, ka qenë 5,514,038.29 euro, prej të cilave janë shpenzuar 5,510,753 euro apo shprehur në përqindje 99.94% e buxhetit është shpenzuar nga kjo Drejtori.

- Projekti më i rëndësishëm që u përfundua gjatë vitit 2020, është nënkalimi në fshatin Varosh, në vlerë financiare 746,473.10 euro.

- Një projekt tjetër që filloj realizimin gjatë vitit 2020, poashtu është nënkalimi afër Plus Marketit, projekt që u përfundua mbi 80% gjatë vitit 2020, në vlerë financiare 723,327.45 euro.

- Projekt i rregullimit të Varrezave të Reja të Qytetit po ashtu filloj realizimin gjatë vitit 2020, në vlerë financiare 729,245.36 euro

- Ndërtimi i Stacionit të Ri të Autobusëve - faza e pare, filloj implementimin gjatë vitit 2020, në vlerë financiare 477,744.76 euro.

- Rikonstruimi i ndriçimit publik me bashkëfinancim 900,000 euro nga Agjensioni për Eficiencë të Energjisë u fillua nga Drejtoria e Infrastrukturës gjatë vitit 2020, vlera e projektit në total 2,380,000 euro.

Më poshtë keni listën e punëve që janë kryer gjatë vitit 2020:

Nr.	Projekti	Emri i rrugës	Asfaltim	Ujësjiellës	Kanalizim fekal	Kanalizim atmosferik	Trotuare	Ndriçim	Shtigje për bicikleta
1	Asfaltimi i rrugës që lidhë lagjen Omuraj me lagjen Spahiaj në Greme, dhe rrugëve të mbetura në fshatin Greme - projekt tre vjeçar	Rr. Trojet	400m'						
		Rr. Zahir Aliu	135m'						
		Rr. Halil Murseli	205m'						
		Rr. 3 Veteranët e Uçk-së	325m'						
		Rr. 3 Veteranët e Uçk-së krahu-1	170m'						
		Rr. 3 Veteranët e Uçk-së krahu-2	110m'						
		Rr. Gurziu	420m'						
		Rr. Izajh Murseli	263m'						
		Rr. Izjah Murseli krahu-1	150m'						
		Rr. Njazi Shehu	490m'						
		Rr. Xhemë Gabrica	140m'						
		Rr. Artë			175m'				
		Rr. Loni Glass	135m'						
		Rr. Loni Glass krahu-1	115m'						
		Rr. Loni Glass krahu-2	120m'						
		Rr. Kurtish Hamdiu	145m'						
		Rr. Profil Star krahu-1	115m'						
		Rr. Profil Star krahu-2	110m'						
		Rr. Rilindasit	155m'						
		Rr. Rilindasit krahu-1	95m'						
		Rr. Gani Sejdiu	135m'						
		Rr. Ismet Misini	290m'						
		Rr. Dan Haxhiu (vazhdimi)	135m'						
		Rr. Mikëpritja	400m'						
		Rr. Xhemë Topalli	315m'						
		Rr. Xhemë Topalli krahu-3	85m'						
		Rr. Sali Topalli krahu-1	205m'						
		Rr. Lagjia Spahiaj (rrugica pa emer- shtet)	400m'						
		Totali :	5763 m'		175 m'				
2	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dremjak - projekt dy vjeçar	Rr. Ibrahim Maloku	550m'						
		Rr. Shefki Tahiri	250m'						
		Rr. Arifi	435m'						
		Totali:	1235 m'						
3	Asfaltimi i rrugëve dhe shperndarja e gypit të ujësjiellësit në lagjet ku mungon në fshatin Koshare, Asfaltimi i rrugëve në fshatin Slivovë, Lloshkobare dhe Kosinë - projekt tre vjeçar	Rr. Teteja	162m'						
		Rr. Tre Martirët 2	82m'						
			751m'						
		Rr. Ngastra							
		Totali:	995 m'						
4	Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe asfaltimi i rrugicave në qytet - faza e II-të	Rr. Skenderbeu			539m'	597m'			
					110m'				
		Rr. Tirana							
		Totali:			649 m'	597 m'			
5	Asfaltimi i rrugëve në fshatin e Vjetër, Sojevë, Dardani dhe Meresalë - projekt dy vjeçar	Fshati I Vjetër	m2				2490 m		
		Dardani	160m'						
		Totali:	160 m'				2490 m²		
6	Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve në fshatin Gaqkë - projekt dy vjeçar	Gaqkë	m2				2400		
		Totali:					2400 m²		
7	Asfaltimi i rrugicave në qytetin e Ferizajt -LOT III Nga rruga VIIëzrit Gërvallaj deri te rruga Brahim	Rr. Motrat Qiriazi	150m'						
		Rr. Lidhja e Pejës	280 m'						
		Rr. Ganimete Terbeshi (lagja e Doktorve)	177m						
		Dy rrugica që lidhen me rrugën Xhevë Lladrovci	90m						
		Rr. Skena Shqiptare	m2				250		
		Rr. Ilaz Ilazi	m2				280		
		Rr. Mehmet Begraca	m2				300		
		Totali:	697 m'				830 m²		

8	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Neredime e Epërme	Rr. Hagji Banushi Rr. Te Varrezat	780m 700m						
		Totali:	1480 m'						
9	Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Rakaj	Rruga "Sadik Zenuni" Rruga "Shkupit" Rruga "Sadik Zenuni" Rruga "Sadik Zenuni"	650 m' 650 m' 400m'			150m'			
		Totali :	1300 m'		400 m'	150 m'			
10	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mirash	Rruga "Skender Thaqi" Rruga "Daut Lohaj" Rruga "Bekim Lohaj" Rruga "Sami Prekadini" Rruga "Avni Lohaj" Rruga "Parkingu te shkolla" Rrugica "Bytyqi"	70 m' 90 m' 70 m' 130 m' 70 m' 50 m' 120 m'						
		Totali :	600 m'						
11	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Cërrnillë	Rruga "Dino" Rruga "Burimi" Rruga "Miniera" Rruga "Nazif Kamenica" Rruga "Selmani" Rruga "Osman Xhafaj" Rruga "Bibaj-Prelez" Rruga "Isuf Qalaj" Rruga "Lohaj" Rruga "Bytyqi" Rruga "Shaip Bytyqi" Rruga "Adem Bytyqi" Rruga "Hajrush Bytyqi" Rruga "Rexhep Lohaj"	200 m' 395 m' 215 m' 180 m' 45 m' 150 m' 80 m' 130 m' 90 m' 115 m' 100 m' 60 m' 140 m' 100 m'						
		Totali :	2000 m'						
12	Asfaltimi Mirashi i Ri - Cërrnillë	Rruga "Mirash"	205 m'						
		Totali:	205 m'						
13	Ujësjetësi në fshatin Greme - Dramjak	Rruga "Dramjak"		800 m'					
		Totali :		800 m'					
14	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Surqinë	Rruga "Bajram Llabjani" Rruga "Nebih Llabjani" Rruga "Sylejman Breznica" Rruga "Z.M-"Kah Dibranet Rruga "Z.M" Krahui 1 Rruga "Z.M" Krahui 2 Rruga "Z.M" Krahui 3 Rruga "Z.M" Krahui 4 Rruga "Z.M" Krahui 6	670 m' 689 m' 582 m' 974 m' 142 m' 162 m' 152 m' 106 m' 238 m'						
		Totali :	3715 m'						
15	Asfaltimi i rrugicave pjesa perindimore nga hekurudha LLOT-2	Rrugët "Haxhi Sejda", "Alfabeti", "Ismet Sopa 1", "Kadri Abazi", "Hamit Topojani" dhe "Mikel Lumezi" Rruga "Eqrem Qabej" Rruga "Dritro Agolli" Rruga "Arsim Bega" Rruga "Nazim Bakliu" Rruga "Jakup Ferri" Rruga "Mulla Idriz Gjilan" Rruga "Sefedin Firza" Rruga "Sadik Tafarshiku" Rruga "Riza Goga" Rruga "Sejdi Sejeva" Rruga "Ejup Stataovci" Rruga "Perballi AAB"	415 m' 75 m' 120 m' 80m' 310 m' 1350 m' 295m' 120m' 200 m' 170m' 320m' 80m'			230m'			
		Totali :	1650 m'	240 m'	1995 m'				
16	Asfaltimi i rrugicave në qytet LLOT-I-prej rrugës "Enver Topalli" deri te rr."Rexhep	Rruga "Mujë Ulqinaku" Rruga "Fan Noli"-2 Rruga "Vezir Jashari"	175 m' 152 m' 255 m'						
		Totali:	582 m'						
17	Pjesmarrëja në projektin me donator, ujësjetësi në fshatin Sojevë, Dardani	Fshat Vjetër Sojevë			900 m'				
		Totali		5372 m'	900 m'				

18	Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore të fshatit dhe rrugëve të mbetura në fshatin Komogllavë	Lagja Halilaj	369m'					
		Lagja Kurdiu	315 m'					
		Lagja Toskaj	170 m'					
		Lagja Kaçaj	774m'					
		Lagja Alijaj	424m'					
		Lagja Miraj		370m'				
		Lagja Miraj-Myfti Ismajli	1032m'					
		Totali	3084 m'	370 m'				
20	Infrastruktura nëntokësore dhe asfaltimi i rrugicave të mbetura në qytet – projekt dy vjeçar (LOT –I) Rrugicat pjesa Lindore nga hekurudhat	Rrugët "L. e doktoreve" , "Mehmet Bëgraca" dhe "Motrat Qiriazi" L=1150 m	222m'	700m'	85 m'			
		Dy rrugica në rrugën e "Rezakut" L=40+75=115.00m ; B=4,0m	58m'	40m'	52 m'			
		Rrugët "Kolë Jakova" (1dhe2) L=170m ; B=4,0 m	172m'					
		Rruga "Nazmiye Hoxha" L=120 m ; B=4,0 m	165m'					
		Tri rrugica në rrugën "28 Nëntori" L=275 m ; B=4,0 m	275m'					
		Rrugicë në rrugën "Nora Kelmendi" L=320 m ; B=5,0 m	320m'	320m'	320 m'			
		Rruga "Halit Sejda"	370m'					
		Rruga "Hashani" dhe "Frangu" L=85+45=130m ; B=4,0 m	137m'					
		Rruga "Nuh Berisha" L=95 m ; B=7,0 m b=2x2,0	111m'		150 m'			
		Rruga "Sherif Frangu" , "Vëllezërit Ferizi" dhe "Kruja" L=260.00 m ; B=4,0m	260m'					
		Rruga "Fazli Obrazhda" L=240 m ; B=4,0 m	240m'	240m'				
		Rruga "Halim Spahia" rrugicë në rrugën "Enver Hadri") L=380 m ; B=5,0 m	155m'					
		Rruga "Ibrahim Cernilla" L=200.00 m ; B=4,0m	200m'					
		Rruga "At Nikë Prela" dhe "Ilir Konushevi"	49m'					
		Rruga "Mumin Shkodra" L=345 m ; B=5,5 m	345m'				345 m'	
		Rruga "Hamit Prokupa" L=310 m ; B=4,0 m	310m'	310m'	310 m'			
		Rruga "Oso Kuka" L=85.00 m ; B=4,0m (në rrugën "Vezir Jashari")	85m'					
		Rrugicë që ka qasje në rrugën "Fan Noli" L=152 m ; B=5,0 m ; trotuari b=2x1,5			152 m'			
		Dy rrugica në rrugën "Fan Noli" - rr. "Leka" L=55m B=4,0m dhe rr."Fan Noli-1" L=140m b=3,0m		140m'				
		Rrugicë në rrugën "Ali Hadri" - te Gazmendi L=100.00 m ; B=4,0m	100m'					
		Rruga "Mujo Ulqinaku" (qasje në rrugën "Ali Hadri") L=170 m ; B=5,0 m		170 m'				
		Kanalizimi fekal ne rrugen "Isen Elezi" L=240m ; B=3,0 m		240m'				
		Rruga "Elhami Hasani" (dy rrugica) L=115 m ; B=4,0m	170m'					
		Kanalizim Fekal L=1500 m		1500m'				
		Kanalizimi atmosferik L=1500 m			1500 m'			
		Rruga "Golgota Shqiptare dhe Bajram Kelmendi" L=380.00m ; B=5,0m	363m'					
		Totali:	4549 m'	3660 m'	3184 m'			
21	Rikonstruimi i rrugës "Bajram e Gursel Sylejmani"- projekt tre vjeçar		1550m'			2620 m'		
		Totali:	1550 m'			2620 m'		

22	»Asfaltimi i rrugës Zaskok-Ferizaj -proejkt tre vjeçar«		200m'						
	Totali:		200 m'						
23	»Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balaj -proejkt tre vjeçar«					1800m'			
	Totali:					1800 m'			
	»Asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicave të mbetura në fshatin Tërn dhe Prelez i Jerlive -projekt tre vjeçar«	Bablak	2546m'						
24		Cërnillë	750m'						
	Totali:		3296 m'						
	»Asfaltimi i rrugës Bibaj (kycja R6) – Driton Islami (N2) në Ferizaj - projekt tre vjeçar«	Rruga e "Gurit"	620m'			620m'		620 m'	
25		Rruga "Skender Demiri"	422m'					422 m'	
		Rruga "Ahmet Pollomi"	125m'						
		Rrugët "Kashtanjeva"; "Feriz Sejdiu" dhe "Jashar Kabashi"	610m'						
	Totali:		1777 m'			620 m'		1042 m'	
	»Unaza e jashtme në Ferizaj (Prelez i Jerlive-Kosinë-Llojza-Dremjak-Nerodime-Manastirc-Zaskok-Greme -Topojan) – projekt tre vjeçar«	Rruga Muhaxher-Balaj	2040m'						
26		Rruga Doganaj-Greme	455 m'						
		Rruga Prelez-Kosine	900m'						
		Te parku I lirise	606 m'						
		Rruga ne Rakaj (shtresa e dyte)	349.m'						
		Rruga e arte	1150 m'						
		Rruget stacioni me rrugicat per rreth ne Gaqke	1616 m'						
		Rruga Llojze-Dremjak					922m'		
		Rruga Dremjak-Nerodime					730m'		
		Rruga Manastirc-Zaskok					2215m'		
		Rruga Topojan-Greme					1998.5m'		
		Rruga ne Rakaj pjesa2	1547 m'				301m'		
		Rruga ne Rakaj pjesa1	329m				505 m'		
	Totali:		8992 m'				6671 m'		
27	»Vazhdimi i kanalizimit fekal deri te gropa septike në fshatin Tërn«	Kanalizim në fshatin Tërn			220 m'				
	Totali i pergjithshem		43,830 m'	6,412 m'	7,779 m'	5,731 m'	15,161 m'	1,387 m'	



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Zekir Bytyqi

Drejtore i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Hyrje

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për bizneset, për qytetarët dhe për partnerët ndërkombëtar. Ajo përkujdeset për ofrimin e shërbimeve dhe mundësive për zhvillim ekonomik dhe turizmit dhe atë përmes:

- Dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër;
- Krijimit të Zonave Ekonomike;
- Krijimit të Zonave Industriale;
- Krijimit të Inkubatorëve të Biznesit;
- Bashkëpunimit në financim me partnerë ndërkombëtar dhe vendor.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të gjithë punën e saj e kryen duke u bazuar në legjislacionin e vendit tonë, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet.

Përmbledhje e aktiviteteve:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka vazhduar me aktivitete të cila kanë ndikim në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal ku gjatë këtij viti fokus të veçantë ju ka dhënë; mbështetjes së bizneseve me grante si dhe bashkëpunimit me donatorë dhe ministritë e linjës, që kanë ndikuar drejtpërdrejt në përkrahjen e bizneseve të vogla e të mesme si dhe investimet në fushën e turizmit.

Më poshtë është prezantuar në mënyrë kronologjike një përmbledhje e aktiviteteve të realizuara me sukses me sa vijon:

Mbështetja e bizneseve me grante “Fondi i Punësimit”

Ofrimi i mbështetjes së bizneseve të vogla dhe të mesme, vazhdon të mbetet prioriteti i yni me rëndësi, andaj gjatë këtij viti janë vizituar shumë biznese të Komunës së Ferizajt, për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit të punës, nevojat dhe kërkesat e tyre, drejt realizimit në të bërit biznes dhe mundësinë e të ofruarit ndihmë për zhvillimin e këtyre bizneseve me të gjitha kapacitetet që ne i posedojmë si DZHET. Gjatë muajit Gusht dhe Nëntor kemi bërë thirrje për mbështetje me pajisje dhe mjete pune për bizneset prodhuese dhe përpunuese të Mobilerisë, Rrobaqepësisë, Ushqimeve tradicionale, Ëmbëlsirave dhe shkollën profesionale “Zenel Hajdini”, ku në bazë të kësaj thirrje kanë përfituar gjithsej 38 biznese që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në Komunën e Ferizajt. Kjo skemë mbështetjeje synon që të rris kapacitetet prodhuese tek ndërmarrësit e vegjël ferizajas dhe të rris shansin për krijimin e vendeve të reja të punës.

Investimet në Turizëm

“Parkut i Pishave” tani më një destinacion i ri turistik në Komunën e Ferizajt, për t’iu shtuar një vlerë turizmit, parku është pjesë e vargmaleve të Zhegovcit dhe urë lidhëse mes Ferizajt dhe Gjilanit, gjendet në mes të fshatrave Rahovicë dhe Mirosalë 10km nga qyteti i Ferizajt, është investuar në shtigjet e ecjes mbi 3000m², apo mbi 1km gjatësi të shtegut, këndi i lojërave për fëmijë, ulëse dhe shporta mbeturinash.

Më shumë sesa mbështetje, tregon se qeverisja jonë është e përkushtuar që të krijoj ambiente të tilla, këto hapësira, këto kënde të lojërave begatojnë edhe më shumë këtë hapësirë.

Parku i Lirisë

Pas investimeve të kryera më parë për të rregulluar këndin e lojërave, ndriçimin dhe infrastrukturën përcjellës është kryer edhe pjesa me nyjet e domosdoshme higjienike. Bëhet fjalë për projektin e ndërtimit të toaleteve publike në hapësirën e këtij parku. Me këtë investim, përfundohet cikli i investimeve bazike infrastrukturore,

duke shtuar se edhe rruga që çon në këtë aset natyror me vlerë të jashtëzakonshme për ferizajasit, tani më është përfunduar dhe ka kyçje nga rruga kryesore tek parku, çka përfundimisht, krijohet një hapësirë e përshtatshme, lehtë e qasshme dhe rekreative për frekuentuesit e kësaj zone.

Grantet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal

Gjatë këtij viti nga Komuna e Ferizajt kanë përfituar mbi 7 biznese nga të cilat janë përkrahur nga DZHET në përgatitjen e aplikacioneve për thirrjen për grante “Zhvillimi Rajonal i Balansuar 2020”, nga fondet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, ku si qëllim kryesor ka qenë përkrahja dhe zhvillimi i sektorit privat, me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Gjatë viti 2020, Qendra Komunale e Regjistrimit të Bizneseve është vendosur në katin përdhes të objektit të Komunës, ku tani më të gjitha shërbimet për biznese kryhen në një vend dhe kjo ka ndikuar në kryerjen e shërbimeve më të mira dhe të shpejta për biznese dhe qytetarët e Komunës sonë.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor në QKRB kanë arritur gjithsej 3428 kërkesa dhe këto janë:

1. Regjistrime të reja 781
2. Ndryshime në biznes 470
3. Ç'regjistrime biznesi 56
4. Informata biznesi 859
5. Vërtëtime 7
6. Ndërrime të Çertifikatave 1248

Në Qendrën e Regjistrimit të Biznesit gjatë periudhës 01.01.2020 deri me 31.12.2020 janë regjistruar gjithsej 781 biznese të reja dhe gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 1478 punëtorë të rinj

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve (QRB) në Ferizaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka kryer aktivitet e saja, sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrim të bizneseve dhe komunitetit të biznesit për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore. Në tabelën më poshtë gjeni të prezantuar raportin e vitit paraprak me vitin aktual, i cili mund të shërbej për të bërë krahasimin e situatës sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara e të ç'regjistruara, përfshirë veprimtaritë si dhe numrin e punëtorëve.

	Bizneset e Regjistruara		
Emërtimet	Viti 2019	Viti 2020	Dif. %
Prodhuese	274	186	-32.11
Tregtare	230	194	-15.65
Shërbyese	107	326	204.67
Ndërtimore	101	75	-25.74
Gjithesej	712	781	9.69
Struktura Gjinore e pronarve	Viti 2019	Viti 2020	Dif. %
Meshkuj	957	716	-25.18
Femra	77	190	146.75
Gjithesej	1034	906	-12.37
Sipas llojit të biznesit	Viti 2019	Viti 2020	Dif. %
SH.P.K.	460	540	17.39
B.I.	251	241	-3.98
SH.A.	1	0	0
Gjithesej	712	781	9.69

	Bizneset e ç'regjistruara		
Emërtimet	Viti 2019	Viti 2020	Dif. %
Prodhuese	3	7	133.33
Tregtare	99	21	-78.78
Shërbyese	21	25	19.04
Ndërtimore	2	3	50.00
Gjithesej	100	56	-44.00
Struktura Gjinore e pronareve	Viti 2019	Viti 2020	Dif. %
Meshkuj	131	42	-67.93
Femra	47	14	-70.2
Gjithesej	178	56	-68.53
Sipas llojit të biznesit	Viti 2019	Viti 2020	Dif. %
SH.P.K.	9	24	166.66
B.I.	88	32	-63.63
SH.A.	3	0	0
Gjithesej	100	53	-47.00

Rregullorja për përcaktimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në territorin e Ferizajt

Kërkesa e shumë bizneseve dhe qytetarëve për një rregullore që përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për shoqëritë tregtare, afariste dhe veprimtaritë tjera biznesore të cilat veprojnë në territorin e Ferizajt, ku shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës aprovuan propozimin e qeverisë komunale.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Afrim Llabjani
Drejtore i Drejtorisë së Arsimit

HYRJA

Drejtoria e Arsimit, përkundër sfidave të mëdha, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, ku për vitin shkollor 2019/20, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor.

Përfundimi i vitit shkollor 2019-2020 është bërë në kushte pandemie dhe si rezultat i pandemisë, mësimi është zhvilluar në distancë/online, sipas vendimit të MASH-it për **procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë** me nr.ref: 25/01B dat: 24.04.2020. Po ashtu viti shkollor 2020-2021, ka filluar në kushte pandemie, por duke u kthyer në objektet shkollore.

Përkundër rrethanave të shkaktuara nga pandemia, Drejtoria e Arsimit ka përcjellur nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar aktivitetet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizatat të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimit dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimit dhe mësimnxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim. Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme të Provimit Shtetëror të Maturës. Ndërsa Testi i Arritshmërisë për klasën IX-ta nuk është mbajtur për shkak të pandemisë.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimit në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënoj progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara, si në mësimit, mësimnxënje dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Organizmi i punëve në Drejtorinë e Arsimit bëhet përmes sektorëve të saj:

- **Sektorit të Administratës**
- **Sektorit të Financave**
- **Sektorit të Arsimit**
- **Sektorit të Shërbimit Teknik**

Qëllimi i raportit vjetor është prezantimi i punës njëvjeçare të të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, gjegjësisht paraqitet suksesi, rezultatet, të arriturat, por edhe sfidat dhe vështirësitë që kanë përcjellur shkollat dhe procesin edukativo-arsimor në edukimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë në Komunën e Ferizajt, për vitin shkollor 2019-2020.

Drejtoria e Arsimit me kohë i ka planifikuar punët që duhet të kryhen dhe u ka kushtuar kujdes të veçantë, sidomos prioriteteve duke bërë përpjekje për shfrytëzim sa më racional të të gjitha resurseve të brendshme dhe të jashtme në shkollat tona.

Në raport janë përfshirë: rrjeti shkollor, lokali mësimor, nxënësit dhe paralelet, organizimi i mësimi, suksesi i nxënësve, mungesat e nxënësve, orët e mbajtura, aktivitetet jashtëkurrikulare etj. Pra, janë përfshirë të gjitha segmentet e punës dhe jetës në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Ferizajt.

Materialet bazë për hartimin e raportit:

- Plani vjetor i punës së DA-it për vitin 2020;
- Raporti vjetor i punës së Sektorëve të Arsimit pranë DA-it për vitin 2020;
- Programet vjetore dhe periodike të punës së njësive pranë DA-it:
- Njësia Administratës;
- Njësia e Financave;
- Njësia e Shërbimeve Teknike;
- Kalendar i për vitin shkollor 2020-2021, me Udhëzim Administrativ nr.85/2020;
- Raportet tekstuale dhe tabelare të shkollave fillore dhe të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm i lartë;
- Raportet e organizimit të seminareve me mësimdhënës për zbatimin e KK-së dhe KB për nivelet e arsimit (0,1,2,3);
- UA nr.151/2020 për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve dhe zv. drejtorëve;
- Informatat rreth organizimit të Provimit të Maturës;
- Bashkëpunimi i zyrtarëve komunal të arsimit DA-së me SIA-në, dhe organe tjera relevante.

Drejtoria e Arsimit dhe stafi i saj në bashkëpunim me MASH-in, drejtoritë e shkollave dhe organet tjera relevante janë angazhuar në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punë në shkollat e komunës sonë. Planifikimi me kohë ka mundësuar një fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor, gjithmonë duke pasur parasysh rrethanat e pandemisë.

Drejtoria e Arsimit në përfundim të vitit mësimor, në të gjitha shkollat e komunës sonë, fillon punët në lidhje me përgatitjet e përgjithshme e të nevojshme për vitin e ri shkollor.

Drejtorët e shkollave me kohë kanë marrë udhëzimet e nevojshme për fillimin e punëve në lidhje me përgatitjet të cilat duhet të bëhen sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria e Arsimit.

Përgatitjet janë kryer sipas punëve me prioritet:

- Në përfundim të vitit mësimor, ka filluar me përgatitjet e objekteve shkollore si renovime, lysterje, gëlqerosje, dezinfektim dhe dezinfektim etj;
- Për të siguruar kuadrin e nevojshëm, Njësia Administrative pranë Drejtorisë sonë, me kohë ka bërë përgatitjen dhe shpalljet e konkurseve;
- Me kohë është bërë edhe planifikimi për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore të cilat gratis i ka siguruar MASH-i, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Këto tekste janë bërë nën përcjelljen e zyrtarëve arsimor për vitin shkollor 2020-2021 të cilat janë shpërndarë nëpër shkollat ashtu siç është paraparë;
- Nga Drejtoria e Arsimit është bërë planifikimi për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse dhe material tjetër të nevojshëm shpenzues;
- Gjithashtu me kohë shkollat janë pajisur me dokumentacion pedagogjik si libra amë, ditar të punës, fletore të punës për mësimdhënës, material shkollor e gjëra të tjera të nevojshme;

- Drejtoria e Arsimit, përmes Aktivit të Drejtorëve të shkollave, kujdes të veçantë i ka kushtuar përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-mësimor. Një kujdes të shtuar kemi pasur për nxënësit me nevoja të veçanta. Këtë kategori të nxënësve e kemi përfshirë në gjitha nivelet e arsimit, kurse një numër i tyre (për shkak të nevojave më specifike) janë të përfshirë edhe në dy shkolla fillore në „Gjon Serreçi” dhe në „Ahmet Hoxha”. Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, organizon mësim plotësues me të gjitha shtresat e nxënësve në tri shkolla të qytetit (“Vezir Jashari”, “Tefik Çanga” dhe “Ahmet Hoxha”);
- Drejtoria e Arsimit ka planifikuar buxhetin për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë. Për shkak të pandemisë dhe rrethanave të shkaktuara nga Covid 19, për vitin shkollor 2019-2020 u ka ndarë bursa të gjithë studentëve që kanë aplikuar si dhe ju kanë vazhduar bursat studentëve vijues. Ndërsa për këtë vit kalendarik, DKA-ja ka shpallë konkursin për bursa ku do të jenë përfitues të gjithë studentët aplikues nga Komuna e Ferizajt, përpos atyre që janë përfitues të bursës së dyfishtë.

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit edukativo- arsimor dhe në përgjithësi të punëve nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit, i ka kushtuar kujdes të duhur edhe:

- Planifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e parë;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;

Gjatë vitit shkollor 2019-2020, kemi vazhduar me zbatimin e KK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e komunës së Ferizajt në të gjitha nivelet e arsimit përveç shkollave profesionale që ende nuk kanë filluar në zbatimin e KK-së;

Drejtoria e Arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës, ka realizuar vizitat të rregullta dhe informative nëpër shkolla;

Sigurisë në shkolla i është kushtuar rëndësi e duhur, është forcuar bashkëpunimi me Policinë, me Këshillin e Prindërve dhe është shtuar kujdestaria e ditës nga nxënësit dhe mësimdhënësit;

Gjelbërimeve në oborret shkollore i është kushtuar rëndësi e duhur. Në këtë drejtim edhe janë shënuar rezultate. Në disa shkolla janë rregulluar parqet shkollore.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulare, si organizimi i kuizeve nga lëndë të ndryshme të diturisë, garave kulturore, sportive etj.

RAPORTI I PUNËS PËR SEKTORIN ADMINISTRATIV TË DA-së

Spektori Administrativ në Drejtorinë e Arsimit gjatë periudhës për vitin 2020 ka udhëhequr procedurat administrative dhe ligjore për pranimin e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë në shkolla për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Gjatë këtij viti shkollor kemi publikuar gjithsej 14 konkurse. Konkursët janë shpallur me kohë duke i respektuar afatet ligjore, janë shpallur edhe në faqen zyrtare të komunës si dhe në tabelën e shpalljeve me sa vijon:

- 1 për sekretar (2 vende)
- 3 për pastrues (7 vende)
- 1 për pedagog (1 vend)

- 8 për mësimdhënës (30 vende)
- 1 për bursa për studentë

Gjithsej 14 konkurse

Janë udhëhequr procedurat e njoftimit të kandidatëve, intervistimit, për pranimin e kandidatëve për plotësimin vendeve të punës, si në zëvendësime, plotësime etj; janë zhvilluar procedurat e pushimeve të lehonisë, pushimeve mjekësore, pushimeve pa pagesë dhe të punëtorëve të pensionuar gjatë kësaj periudhe.

Kemi shqyrtuar kërkesa, ankesa, kemi dhënë përgjigje me shkrim sipas shkresave të palëve.

Kemi bërë kompletimin e lëndëve për zyrën ligjore sipas padive të palëve për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit, për rastet e punësimit.

NJËSIA E FINANCE

Përgatitja për raportimin e borxheve për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.

Përgatitja për raportimin e pasqyrave financiare për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.

Përgatitja e planit të keshit për vitin 2020 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale.

Shpërndarja e mjeteve në kategoritë e pagave për arsimin fillor të mesëm, sipas shkollave dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Shpërndarja e mjeteve përmes Free-Balance për çdo shkollë veç e veç në arsimin fillor të mesëm dhe çerdhen e fëmijëve.

Kemi bërë shpërndarjen e pagave sipas shkollave, pastaj i kemi futur në freebalance pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalit për vitin 2020.

Kemi bërë përgatitjen e zotimeve për investime kapitale, përgatitjen e disponueshmërisë së mjeteve, kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Përgatitjen e raportit tremujor për kategorinë e pagave, mallrave dhe shërbimeve, komunalive.

Rregullimin e retroaktivitetit për mësimdhënësit që nuk kanë hyrë me kohë në listën e pagave.

Raporti i borxheve në të gjitha kategoritë ekonomike për Ministrinë e Financave sipas kërkesës së tyre.

Përgatitja e të dhënave për rishikim të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike në muajin Qershor.

Përgatitja e të gjitha të dhënave për bursat për studentë dhe pagesat e tyre prej subvencioneve.

Futja e të dhënave në BDMS në të gjitha kategoritë ekonomike për çdo shkollë veç e veç;

Përgatitja e investimeve kapitale për ridestitim, sipas programeve të arsimit;

Përgatitja e listave të pagave për zyrën e thesarit;

Raportimin e mjeteve të sindikatës;

Trajnimet e drejtorëve dhe stafit administrativ, sipas nevojave;

Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin, planin e prokurimit, kërkesat për prokurim;

Bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave;

Raportin e faturave të papaguara për vitin kalendarik 2020;

Pasqyrat financiare 2020;

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe përkujdesje, gjatë vitit 2020, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

- **Fillimi i ndërtimit të shkollës "Ahmet Hoxha" ne Ferizaj;**
- **Ndërtimi i shkollës në fshatin Zaskok dhe fshatin Talinoc të Muhaxherëve** – (punimet janë duke vazhduar);
- **Renovimi i shkollës fillore në fshatin Prelez i Jerlive;**
- **Fillimi i ndërtimit të Çerdhes së Fëmijëve në rrugën “Rexhep Bislimi”.**
- **Ndërtimi i shkollës së mesme në Komunën e Ferizajt** – (punimet janë duke vazhduar në këtë projekt);
- **Ndërtimi i shkollës Profesionale në Komunën e Ferizajt** – (punimet janë duke u vazhduar);
- **Në shkollën "Jeronim De Rada"- Ferizaj- është bërë rregullimi dhe gjelbërimi i oborrit;**
- **Shkolla fillore në fshatin Muhoc** - është intervenuar në ngjyrosje brenda dhe jashtë shkollës dhe rregullimi komplet i oborrit të kësaj shkolle;
- **Në shkollën "Ahmet Hoxha" Ferizaj** - (rregullimi i toaleteve);
- **Në shkollën "Astrit Bytyçi"** – Ferizaj - (rregullimi i toaleteve);
- **Në shkollën "Pavarësia"** – Balaj - (rregullimi i toaleteve);
- **Në shkollën "Gjon Serreçi"** (ish gjimnazi) – Ferizaj (rregullimi i toaleteve, rregullimi dhe gjelbërimi i oborrit);
- **Në shkollën "Kuvendi i Arbërit"** – Ferizaj (renovimi i toaleteve);
- **Rregullimi dhe renovimi i brendshëm në shkollën "Naim Frashëri"** në Doganaj;
- **Rregullimi i këndeve të lojërave për fëmijë në shkollat: "Ali Hadri"** në Mirash; **"Enver Topalli"** në Omuraj, në **"Besim Rexhepi"** në PNF si dhe në çerdhen **"Ardhmëria Jonë"**;
- **Rregullimi i oborrit të shkollës “Dëshmorët e Koshares” në Koshare.**

Projektet që janë paraparë të bëhen renovimet e tyre në kuadër të projektit për Eficiencë të Energjisë në komunën tonë janë si më poshtë:

- **SHFMU “Dituria” Dardani.**
- **SHFMU “Bilall Shala” Lloshkobare.**
- **SHFMU “Visar Dodani” Varosh.**

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

Zyrtari për arsimin parafillor dhe fillor
Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët, dhe
Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellur dhe mbikëqyrur përgatitjet e gjithëmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Takimet mujore të Task Focës, të mbajtura në QPS në Ferizaj;
- Është bashkëpunuar me Shoqatën e Biologëve, Matematicientëve, Fizicientëve dhe Kulturës sportive në organizimin e garave në lëmitë përkatëse;
- Në muajin Gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë tjera botuese, nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra;
- Është bërë Vlerësimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, përmes Ekipës Vlerësuese;
- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysmëvjetor janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën etj;
- Zyrtarët arsimor gjatë vitit 2020 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellur respektimi i orarit mësimor, realizimi i planprogrameve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizmin e mbajtjes të testit kombëtar për klasat e IX-ta (nuk është mbajtur) dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor kanë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e testit, si dhe kanë marrë pjesë në mbarëvajtjen e Testit;
- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkursat e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtor administrativ, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASH;

Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASH-in dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori në: DA në bashkëpunim me organizatën “EDUMEN” ka bërë trajnimin e koordinatorëve të cilësisë për realizimin e planprogramit mësimor në kushte pandemie si dhe trajnimin e 35 mësimdhënësve rreth temës: Menaxhimi i stresit të fëmijët pas COVID 19.

DA në bashkëpunim me Caritas Zvicëran përmes projektit “SHPRESA” ka bërë trajnimin e edukatoreve të grupmoshës 5 - 6 vjeçare (dhe është duke vazhduar trajnimin) si dhe në paisjen e disa klasëve me mjete didaktike.

- Trajnimin e stafit udhëheqës të shkollave për menaxhimin e institucioneve shkollore;
- Trajnimin e stafit arsimor për zbatimin e Kurrikulës, kanë filluar nga muaji Prill dhe kanë përfunduar në muajin Korrik. Trajnimet janë realizuar në të gjitha fushat e Kurrikulës.

Këto të dhëna janë të paraqitura në tabelën vijuese:

Nr	Fusha e Kurrikulës	Seminari Faza I	Seminari Faza II	Seminari Faza III	Seminari Faza IV	Gjithsej të trajnuar
1	Gjuhë dhe komunikim	8	10	-	-	18
2	Matematika	8	-	-	-	8
3	Shkencat e natyrës	8	-	-	-	8
4	Shoqëria dhe mjedisi	-	-	13	-	13
5	Artet	-	-	5	-	5
6	Programi fillor dhe kl. Parafillore	42	28	-	-	70
7	Jeta dhe puna - TIK	-	-	-	-	-
8	Ed. fizike dhe sportet	-	-	-	-	-
Gjithsej		66	38	18	-	122

RAPORT MBI ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS - 2020

Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje, dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënie dhe kompetencave të të gjithë fëmijëve.

Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijun dhe vendos përgjegjësinë e adaptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijut. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitet më të gjerë, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t'i siguruar çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë, të mësojë së bashku me shokët dhe shoqet e tij/saj, si dhe të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Arsimi gjithëpërfshirës keqkuptohet si koncept që aplikohet vetëm tek fëmijët me nevoja të veçanta, dhe ky fakt pikërisht na vendos pengesa në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Në Kosovë, koncepti i edukimit gjithëpërfshirës, është kuptuar në formën më të kufizuar të tij, duke ngecur te sigurimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo si sigurimi i kushteve për pjesëmarrje të plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor/mësimdhënës.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me shkollat ka bërë mbledhjen e të dhënave mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për vitin 2020 vazhdimin e mbajtjes me informata të databazës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në nivelin komunal.

Në SHFMU “Ahmet Hoxha” funksionon me sukses Qendra për Mësim Shtesë, ku punohet me nxënësit që kanë ngecje në procesin mësimor e sidomos në shkrim-lexim. Po ashtu kjo qendër punon edhe me grupe të marginalizuara si komunitetet jo shumicë.

Numri i nxënësve përfitues dhe emri i institucionit shpërndarës:

Help Kosovo ka shpërndarë 17 llaptop;

UNMIK, ka dhuruar 40 IPAD;

ETC ka dhuruar 30 llaptop;

ECOLOG ka dhuruar 50 IPAD;

Childproof/CIPOF, kanë shpërndarë 27 Ipad dhe internet falas për një vit për familjet e nxënësve të klasëve të I-ra;

OJQ VoRAE, ka shpërndarë 22 çanta dhe material didaktik për nxënësit e klasëve të I-ra;

UNICEF ka shpërndarë për fëmijët e komunitetit pakicë 20 tabletë, ndërsa për fëmijët e komunitetit shumicë 10 tabletë;

“LS Fondation” - 50 çanta shkollore;

Libraria “RILINDJA” 50 çanta shkollore;

Këshilli i Evropës në bashkëpunim me KK Ferizaj ka shpërndarë **750 çanta** shkollore dhe mjete didaktike për nxënësit e komunitetit joshumicë;

UNICEF dhe USAID kanë shpërndarë mjete hixhienike dhe termometra në dy faza për të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt.

Projekte të realizuara me Save the Children

- Nënshkrimi i marrëveshjes për projektin e qasjes dhe kujdesit në fëmijëri të hershme deri në vitin 2022;
- Hapja e qendrës së bazuar në komunitet për edukim në fëmijërinë e hershme në fshatin Nerodime ku rreth 30 fëmijëve u është mundësuar qasja në edukimin në fëmijërinë e hershme;
- Shpërndarja e mbi 100 pakove higjienike për fëmijë me nevoja të veçanta, nga komunitetet jo shumicë dhe fëmije që jetojnë në kushte të varfëra;
- Shpërndarja e mbi 100 pakove didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta dhe nga komunitetet jo shumicë;
- Shpërndarja e 80 tabletave për fëmijë me nevoja të veçanta dhe fëmijë nga komunitetet jo shumicë;
- Mbështetja e vazhdueshme e Ekipit Vlerësues Komunal me takime të rregullta dhe koordinime.

Zhvillimi i procesit mësimor në kushtet e pandemisë

Sfidë për Drejtorinë e Arsimit këtë vit kalendarik ka qenë pandemia Covid 19. Me vendim të IKSHPK dhe MASH, me 13 mars 2020, është ndërprerë mësimi në të gjitha institucionet arsimore në mbarë vendin. Për të mos rrezikuar gjendjen e nxënësve dhe përhapjen e këtij virusi, në të gjitha shkollat mësimi është zhvilluar në distancë (online), një formë e re që nuk kishim aplikuar ndonjëherë. Me gjithë vështirësitë, arritëm që vitin shkollor 2019-2020, ta përmbyllim me sukses, por jo ashtu siç duhej.

Viti i ri shkollor ka filluar me 14 shtator. Shkollat kanë qenë paraprakisht mirë të përgaditura në aspektin teknik. Të gjitha shkollat janë pajisur me mjete higjienike, është bërë me kohë dezinfektimi dhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore si dhe është bërë vlerësimi higjienik edhe nga Inspektorati Sanitar. Gjetjet e tyre kanë konstatuar se shkollat plotësojnë kushtet teknike për fillimin e vitit të ri shkollor.

Shkollat kanë filluar me sukses vitin e ri shkollor, por mësimim është zhvilluar sipas skenarëve dhe udhëzuesve të cilët kanë arritur nga MASH-i.

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, kanë punuar me orar të rregullt 20-30 minuta, duke ndarë klasët në dy grupe sipas skenarit A, ndërsa shkollat e mesme të larta për shkak të hapësirës së pamjaftueshme, kanë punuar kryesisht sipas skenarëve A dhe C.

Sfidë tjetër ka qenë edhe mungesa e një numri të konsiderueshëm mësimeve dhe staf teknik, për shkak të infektimit me virusin Covid 19, por në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave, kemi arritë që në një masë të madhe të plotësojmë me kuadro të tjera në mënyrë që nxënësit mos të humbin mësim.

Të gjitha shkollat e nivelit 1 dhe 2 kanë filluar me skenarin A, ndërsa shkollat e mesme të larta, mësimin janë duke e zhvilluar, sipas skenarit B.

Për shkak të pandemisë, këtë vit shkollor jemi detyruar që të bëjmë përgatitje sa më të mirë në aspektin higjieno-teknike të shkollave. Të gjitha shkollat janë dezinfektuar me kohë, ndërsa përmes donatorëve të ndryshëm, çerdhet dhe shkollat e nivelit 1 dhe 2 janë furnizuar me sasi të mjaftueshme me dezinfektues dhe material higjienik. Përmes operatorit ekonomik, shkollat e mesme të larta po furnizohen rregullisht me material higjienik. DKA-ja përmes donatorëve ka siguruar një sasi të konsiderueshme të maskave rezervë për nevojat e nxënësve të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë maska mbrojtëse si dhe termometra për matjen e temperaturës në çdo shkollë. Janë dhuruar 40 tabletë për fëmijët me nevojat të veçanta. Për nxënësit e komunitetit jo shumicë, janë shpërndarë 500 çanta shkollore me të gjitha materialin shkollosor të nevojshëm. Gjithashtu janë shpërndarë edhe 100 çanta shkollore për nxënësit me gjendje të rënduar ekonomike.

Gjimnazi “Kuvendi i Arbërit” është furnizuar me makina elektrike për pastrimin e shkollës.

Nga “Save the Children” janë dhuruar 35 pako didaktike për fëmijë me nevojat të veçanta, prej të cilave 16 janë dhuruar për fëmijët në klasët e bashkangjitura në "Gjon Serreçi" dhe 19 të tjera për fëmijët me nevojat të veçanta në fshatra, janë shpërndarë edhe një numër i konsiderueshëm tabletësh.

Gjatë këtij viti, për shkak të pandemisë, kemi arritur që në bashkëpunim me organizatën Help Kosova të bëjmë shpërndarjen e disa lloptëve për këta nxënës, që në rast të ndërprerjes së procesit mësimor për shkak të pandemisë të kenë mundësi që të kyçen në mësimin online. Kriteret e përzgjedhjes për lloptë i ka përcaktuar organizata Help Kosovo, ndërsa ne kemi bërë hulumtimin e familjeve dhe nxënësve që nuk kanë patur mundësi të kyçen në mësimin në distancë me mësimeve të tyre.

Në vazhdim po paraqesim disa të dhëna rreth gjendjes së shkollave si rezultat i pandemisë Covid 19:

Shkollat të cilat kanë kaluar nga skenari A në skenarin C

SHFMU “Besim Rexhepi” në Komogllavë

SHFMU “Tefik Çanga” Ferizaj

SHFMU “Ali Hadri” në Mirash

SHFMU “Astrit Bytyçi” në Ferizaj

SHFMU “Gjon Serreçi” në Ferizaj

SHFMU “Liman Rekaj” në Prelez të Muhaxherëve

SHFMU “Hajriz Muhadini” në Dremjak

2 IP 39 SHFMU 8 SHML	Numri i mësimeve në shkollë	Mësime të:				Personel tjetër të:				Nxënës të:			
		Testuar	Infektuar	Shëruar	Të vdekur	Testuar	Infektuar	Shëruar	Të vdekur	Testuar	Infektuar	Shëruar	Të vdekur
Gjithsej	1562	476	160	139	2	60	27	24	0	340	53	45	0

NJËSIA E ARSIMIT PARAFILLOR

Në Komunën tonë funksionojnë dy çerdhe të fëmijëve, IP “Ardhmëria Jonë”, si çerdhe publike, dhe Çerdhja “Engjujt” në partneritet publiko-privat.

Institucioni edukativo-arsimor “Ardhmëria Jonë”

Viti shkollor 2020-2021

Grup mosha	Numri i grupeve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 1 vjeç	1	4	2	6
1 vjeç – 2 vjeç	1	3	4	7
2 vjeç – 3 vjeç	4	20	23	43
3 vjeç – 4 vjeç	3	25	23	48
4 vjeç – 5 vjeç	2	22	16	38
5 vjeç – 6 vjeç	2	19	15	34
Gjithsej	13	93	83	176

Në IP “Ardhmëria Jonë” gjatë vitit shkollor 2020, janë sistemuar 176 fëmijë të grupuar në 13 grupe.

Institucioni edukativo-arsimor “Engjujt”

Viti shkollor 2020-2021

Grup mosha	Numri i grupeve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 1 vjeç	1	4	6	10
1 vjeç – 2 vjeç	1	6	4	10
2 vjeç – 3 vjeç	1	13	7	20
3 vjeç – 4 vjeç	2	23	23	46
4 vjeç – 5 vjeç	2	19	37	56
5 vjeç – 6 vjeç	2	29	26	55
Gjithsej	9	93	103	197

Në Çerdhen “Engjujt” gjatë vitit shkollor 2020, janë sistemuar 197 fëmijë të grupuar në 9 grupe.

Lista e nxënësve - viti shkollor 2020 – 2021

Nr	SHFMU	Parafillore	Klasa 1 - 5	Klasa 6- 9
1	Pesë Dëshmorët e UÇK	12	97	94
2	4 Prilli	17	78	68
3	Abetarja	25	91	103
4	Afrim Abazi	24	114	88
5	Ahmet Hoxha	66	544	443
6	Ali Hadri	15	118	112
7	Arsim Rexhepi	29	118	46
8	Astrit Bytyçi	68	281	207
9	Besim Rexhepi	49	217	218
0	Bilal Shala	20	116	103
11	Dardania	9	90	71
12	Dëshmorët e Koshares	15	121	135
13	Dëshmoret e Lirisë	19	167	134
14	Dituria	23	158	142
15	Dy Dëshmorët	26	177	83
16	Enver Topalli	18	105	96
17	Ganimete Tërbeshi	60	356	287
18	Gjon Sereçi	161	1110	843
19	Hajriz Muhadini	22	80	83
20	Halit Ibishi	16	90	63
21	Imri Halili	51	212	158
22	Ismajl Qemajli	24	121	90
23	Jeronim De Rada	89	546	610
24	Jeta e Re	55	216	159
25	Kemajl Hetemi	20	76	52
26	Konstantin Kristoforidhi	20	168	121
27	Liman Rekaj	25	102	82
28	Mejdi Xhaferi	21	121	117
29	Mic Sokoli	20	96	73
30	Muharrem Shemsedini	46	196	203
31	Naïm Frashëri	32	406	253
32	Pavarësia	18	75	67
33	Ramadan Rexhepi	17	99	89
34	Riza Matoshi	26	109	86
35	Skënderbeu	0	18	20
36	Tefik Çanga	121	714	561
37	Tërni	28	83	96
38	Vezir Jashari	64	386	301
39	Visar Dodani	14	136	123
Gjithsej		1385	8108	6680

Nr	SHML	Gjithsej
1	Gjimnazi "Kuvendi i Arbërit"	1557
2	SHM Ekonomike "Faik Konica"	1063
3	SHM Mjekësisë "Elena Gjika"	551
4	SHM Teknike "Pjetër Bogdani"	564
5	SHM Bujqësore "Zenel Hajdini"	379
6	SHM Muzikës "Çesk Zadeja"	163
7	Gjimnazi "Dr.Shaban Hashani"	1358
8	Qendra e Kompetencës	425
Gjithsej		6313

Në dy institucione parashkollore janë regjistruar 372 fëmijë;

Shkolla Fillore 1 - 5		
Numri i nxënësve	Gjithsej	%
<i>Të regjistruar</i>	8108	/
<i>Kanë vijuar</i>	8093	/
<i>Shkelqyeshëm</i>	4941	61.06
<i>Shumë mirë</i>	1641	20.27
<i>Mirë</i>	995	12.29
<i>Mjafueshëm</i>	490	5.30
<i>Gjithsej pozitiv</i>	8093	100
<i>Gjithsej negativ</i>	0	0.00
<i>Të panotuar</i>	15	0.18
<i>Nota mesatare</i>	4.21	

Arsimi fillor	
Orët:	Mungesat:
Të planifikuara132844	Të arsyeshme 29325
Të mbajtura129464	Të paarsyeshme.....5032
Të pambajtura.....3380	Gjithsej.....34357
	Mesatarja për një nxënës4.24

Shkolla e Mesme e Ulët 6 - 9		
Numri i nxënësve	Gjithsej	%
<i>Të regjistruar</i>	6680	/
<i>Kanë vijuar</i>	6661	/
<i>Shkelqyeshëm</i>	2663	39.97
<i>Shumë mirë</i>	1762	26.45
<i>Mirë</i>	1754	26.33
<i>Mjafueshëm</i>	482	7.23
<i>Gjithsej pozitiv</i>	661	100
<i>Gjithsej negativ</i>	0	0.00
<i>Të panotuar</i>	19	0.28
<i>Nota mesatare</i>	3.51	

Arsimi i mesëm i ulët	
Orët:	Mungesat:
Të planifikuara127875	Të arsyeshme45951
Të mbajtura120314	Të paarsyeshme.....11186
Të pambajtura.....1899	Gjithsej.....58513
	Mesatarja për një nxënës8.78

Shkolla e Mesme e Lartë 10 - 12		
Numri i nxënësve	Gjithsej	%
<i>Të regjistruar</i>	6313	/
<i>Kanë vijuar</i>	6060	/
<i>Shkelqyeshëm</i>	1451	23.9
<i>Shumë mirë</i>	1419	23.4
<i>Mirë</i>	1952	32.2
<i>Mjafueshëm</i>	1237	20.4
<i>Gjithsej pozitiv</i>	6059	99.98
<i>Gjithsej negativ</i>	1	0.02
<i>Të panotuar</i>	253	4.01
<i>Nota mesatare</i>	3.50	

Arsimi i mesëm i lartë	
Orët:	Mungesat:
Të planifikuara88111	Të arsyeshme43476
Të mbajtura85153	Të paarsyeshme.....34885
Të pambajtura.....2958	Gjithsej.....76645
	Mesatarja për një nxënës12.64

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë Klasa IX-të
Viti shkollor 2019 – 2020

Për shkak të pandemisë, Testi i Arritshmërisë për klasët e 9-ta, nuk është mbajtur këtë vit.

PROVIMI I MATURËS - 2019-2020
Afati i Qershorit

Nr	Shkolla	Numri i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
1	“Kuvendi i Arbërit”	45	39	86.67	6	13.3
2	“Faik Konica”	261	131	50.19	130	49.8
3	“Zenel Hajdini”	39	26	66.67	13	33.3
4	“Pjetër Bogdani”	58	44	75.86	14	24.1
5	“Elena Gjika”	23	22	95.65	1	4.35
6	“Çesk Zadeja”	13	9	69.23	4	30.8
7	“Dr. Shaban Hashani”	96	83	86.46	13	13.5
8	“Qendra e Kompetencës”	18	14	77.78	4	22.2
9	Aga Xite	9	5	55.56	4	44.44
Gjithsej		1963	1357	69.13	606	30.87

Afat i Gushtit

Nr	Shkolla	Numri i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
1	“Kuvendi i Arbërit”	45	39	86.67	6	13.3
2	“Faik Konica”	261	131	50.19	130	49.8
3	“Zenel Hajdini”	39	26	66.67	13	33.3
4	“Pjetër Bogdani”	58	44	75.86	14	24.1
5	“Elena Gjika”	23	22	95.65	1	4.35
6	“Çesk Zadeja”	13	9	69.23	4	30.8
7	“Dr. Shaban Hashani”	96	83	86.46	13	13.5
8	“Qendra e Kompetencës”	18	14	77.78	4	22.2
9	“Aga Xhite”	4	3	75.0	1	25.0
Gjithsej		557	371	66.61	186	33.4

REZULTATET E TESTIT TË MATURËS (Qershor-Gusht)

Testi i Maturës	Viti shkollor 2019-2020				
	Afati I dhe II				
	Numri i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
Gjithsej	1963	1728	88.02	186	9.47

49 nxënës për arsye të ndryshme nuk i janë nënshtruar Testit të Maturës. Shprehur në përqindje është 2.49%.

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të mëdha në shumë dimensionë që është duke u ballafaquar arsimit në Republikën e Kosovës, ku ende nuk po mund të arrijmë një standard të dëshiruar që garanton zhvillim, përparim dhe stabilitet të qëndrueshëm, Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2019/2020, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor, konstatojmë se në këtë vit shkollor ka zhvillime dhe përmirësime të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën tonë, përkundër situatës pandemike që kemi kaluar.

Kjo është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensione në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin maksimal, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit, që në komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale që në shkollat tona, të ngritet cilësia në arsim.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Xhemile Murati Shabani
Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Hyrje

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të instucioneve të Komunës së Ferizajt, e cila kryen punët dhe detyrat sipas rregullave dhe dispozitave shtetërore dhe sipas organogramit komunal.

Nga sektorët e DKRS-së; Sektori i kulturës, rinisë, sportit, bibliotekave dhe arkivit historik u punuan dhe dorëzuan raportet e punës në formë vizuele dhe tekstuale. Ky është versioni i raportit tekstual. Në arkivin e DKRS-së e gjeni një kopje të raportit vizuel (i shoqëruar me fotografi).

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këta sektorë dhe njësi:

- **Sektori i Kulturës**
Njësia e Kulturës
Galeria e Arteve
Njësia e Muzeut
Teatri
- **Sektori i Sportit**
- **Sektori i Rinisë dhe**
- **Sektori i Bibliotekave**

Projektet e përfunduara

1. Përfundimi i punimeve në projektin “Kompleksi i Fushave të Tenisit”
2. Përfundimi i punimeve në projektin “Ndërtimi i fushave të Pingpongut” (Tabelat e Pingpongut)

Projektet e filluara

3. Fillimi i punimeve në projektin “Pallati i Kulturës”
4. Fillimi i punimeve në projektin “Ndërtimi i fushave sportive në fshatrat e Ferizajt”

Infrastruktura ligjore

1. Statuti i Galerisë së Arteve “Ismail Rama” në Ferizaj
2. Formohet Këshilli Drejtues i Galerisë së Arteve “Ismail Rama” në Ferizaj
3. Formohet Këshilli Drejtues i Muzeut të Kujtesës në Ferizaj

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave dhe normave të tjera, publikon thirrjen publike, ku fton të gjitha organizatat me karakter kulturor, sportive e rinor që të aplikojnë në këtë thirrje, si mundësi për financim të projekteve kulturore, sportive e rinore.

Nga rezultatet e thirrjes publike janë përkrahur me subvencione 51 OJQ, kryesisht shoqata kulturore, klube sportive dhe organizata rinore. Gjithashtu janë përkrahur 21 artistë e sportistë të pavarur.

Librat e financuara për botim në vitin 2020 janë gjithsej 21 (njëzetë e një), libra monografik dhe letrar.

Viti 2020 ishte një vit shumë i vështirë për gjithë botën, por edhe për ne, kalendari i aktiviteve të DKRS-së, i përpiluar që në fillim vit, u çrregullua gjithëçka, shumë aktivitete u anuluan, disa u shtynë më vonë, disa u mbajtën në formatin online, e disa u mbajtën duke respektuar masat strikte të IKSHPK-së.

SEKTORI I KULTURËS

Zakonisht muaji Janar konsiderohet si muaj i rishikimeve, analizave, raporteve dhe planeve të punës, takimeve punuese dhe ndarjeve të detyrave sipas llojit të aktivitetit. Por gjithsesi nuk mungojnë edhe aktivitetet e kohëpaskohshme.

NJËSIA E KULTURËS

Takim me grupet dhe shoqatat kulturore që veprojnë në Ferizaj. Ky takim me grupet dhe shoqatat kulturore që veprojnë në Ferizaj, ku u ndanë mirënjohje e falënderime për bashkëpunimet gjatë vitit 2019, si dhe u diskutuan plane dhe ide për vitin 2020.

Promovim i librit “Korça sipas një kosovari” të autorit Agron Shala. Ky promovim u organizua nga Klubit Letrar “De Rada”- Ferizaj, në kuadër të aktivitetit “Oda e Librit”.

Akademi Përkujtimore për Dëshmorin e Kombit, Rexhep Aliu. - Me rastin e 30 vjetorit të rënies së Dëshmorit të Kombit, Rexhep Aliu, u organizua një Akademi Përkujtimore kushtuar të ndjerit. Kujtojmë se Rexhep Aliu ishte vrarë nga forcat serbe në demonstratat e vitit 1990 për liri dhe pavarësi të Kosovës. Veç pjesës foljore, në pjesën artistike prezantuan: Arbëresha Ademi-çelo, Arjeta Krosa- flautë dhe Nazmi Hajdari- lahutë.

Akademi Përkujtimore për Dëshmorin e Kombit, Bekim Sejdiu- Me rastin e 30 vjetorit të rënies së Dëshmorit të Kombit, Bekim Sejdiu, i vrarë në demonstratat e vitit 1990 nga forcat serbe para 30 vitesh, në sallën e teatrit “Adriana”, u organizua një akademi përkujtimore. Veç pjesës foljore, u dha edhe një program kulturo-artistik nga shkolla fillore e fshatit Slivovë, në oborrin e të cilës ishte vrarë edhe dëshmori.

AKV "Kastriotët" shkëlqejnë në manifestimin "Flaka e Janarit" 2020 në Gjilan. Në kuadër të këtij manifestimi tradicional, i ftuar ishte edhe AKV “Kastriotët” me orkestrën dhe dhe solistët e saj. Përveç se shkëlqyen në Gjilan me prezantim dinjitoz, ata edhe u shpërblyen nga organizatorët këngëtari Liridon Sadriu dhe vet orkestra e “Kastriotëve”.

Mbledhje komemorative për atdhetarin Ramadan Emini. Me rastin e ndarjes nga jeta të atdhetarit Ramadan Emini, Komuna e Ferizajt, në bashkëpunim me Shoqatën e të Burgosurëve dhe familjarët e të ndjerit, organizuan një mbledhje komemorative. Në këtë mbledhje morën pjesë miq, dashamirë dhe krerë të institucioneve. Kujtojmë se Ramadan Emini ishte nga një familje atdhetare dhe i vëllai i Dëshmores së Kombit, heroinës Hyrë Emini.

Gjithçka gati për shënimin e 12 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. -Komuna e Ferizajt, konkretisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka bërë të gjitha përgatitjet për shënimin sa më dinjitoz të 12 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Aktivitetet janë përgaditur në bashkëpunim me shoqata të ndryshme kulturore dhe artistike, por edhe me klubet sportive.

MANIFESTIM KULTURO-SPORTIV 17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës			
Dita	Aktiviteti	Koha	Vendi
E PREMTE 14 SHKURT	AKTIVITET SPORTIV Turnir në volejboll - institucionet (f)	10:00	Palestra e Sporteve
	AKTIVITET NË BIBLIOTEKË Ligjeratë për pavarësi/ shpallja e lexuesit 2019	14:00	Biblioteka e Qytetit
	AKTIVITET ME TË RINJ “Kosova 12 vjet shtet”- KNF	17:00	Galeri
E SHTUNË 15 SHKURT	KONCERT – FLAUTË & ÇELO Arbëresha Ademi & Arjeta Krosa Piano: Rinor Aliu	18:00	Kisha Katolike
E HËNË 17 SHKURT	HOMAZHE	10:00	Varrezat e Dëshmorëve
	AKADEMI SOLEMNE Pjesë foljore; Pjesë artistike: Kori dhe Orkestra e Qytetit	11:00	Teatër
	KONCERT PËR FËMIJË Grupet muzikore për fëmijë	13:00	Teatër
	AKTIVITET ME TË RINJ Ekspozitë me fotografi nga Kuvendi i të Rinjëve	15:00	Sheshi i Qytetit
	EKSPOZITË KOLEKTIVE GALERIA & SHAF “Zef Kolombi” Çmimi “Gursel Sylejmani”	18:00	Galeria e Arteve
	SHFAQJE TEATRORE “Deri sa vdekja nuk na ndanë” Teatri “Adriana”-Ferizaj	20:00	Teatër

Iu dha lamtumira e fundit Prof.Dr. Safet Beqiri. Në praninë e qindra miqve dhe mysafirëve anë e kënd Kosovës, si dhe nga diaspora e miq ndërkombëtarë, iu dha lamtumira e fundit doktor Safet Beqirit.

Promovimi i librit "Kangë popullore erotike" nga autorja Vlora Nikçi.

Në skenën e Teatrit “Adriana”, në bashkëpunim me Klubin Letrar “De Rada” dhe Sektorin e Rinisë, u bë promovimi i librit "Kangë popullore erotike" nga autorja Vlora Nikçi. Në promovim ishte e pranishme edhe autorja e librit, e cila bashkë me panelistë të tjerë shtruan debatin mbi librin dhe këtë tabu temë. Poashtu edhe u lexuan fragmente poetike nga Kushtrim Hajrullahu.

Përgaditje e shfaqjes teatrore nga shoqata BRAN.

Në kuadër të projektit “Ndryshimbërësit e rinjë përmes teatrit”, grupi i aktorëve të OJQ BRAN është duke vazhduar me provat për përgatitjen e shfaqjes teatrale e cila trajton çështjen e barazisë gjinore.

Shënim i rëndësishëm:

Në fillim të vitit 2020 në botë u shfaq një virus vdekjeprurës dhe shumë i rrezikshëm në përhapje. Shpërndarja e këtij virusi mori hov sidomos gjatë muajit Mars e tutje. Kjo ndikoi në vend dhe kudo në botë që të penalizohen shumë aktivitete, sidomos ato masive. Natyrisht kjo ndikoi edhe tek ne në Kosovë e Ferizaj. Shumë aktivitete kulturore të planifikuara u anuluan, disa u shtynë në kohë të pa caktuar dhe disa aktivitete filluan të mbahen në formatin e ri online. Natyrisht asgjë nuk ishte si më parë.

Dita e Poezisë - 21 marsi - Dita e parë e pranverës, është ditë e shumëfishtë ku manifestohen edhe aktivitete tjera me karakter ndërkombëtar. Në një ditë normale, do të duhej të festohej si zakonisht në Ferizaj. E vetmja gjë që u bë për këtë manifestim, u shpërndanë disa fotografi të aktivitetit të njejtë të vitit të kaluar, me moton: "Rri n'shpi".

Përkujtohet në 21 vjetorin e vrasjes, “Engjëlli Mbrojtës i Teatrit” - Adriana Abdullahu.

Skena e Teatrit “Adriana” në Ferizaj, sonte u ndriçua nga 20 qirinjë që ishin vendosur në përkujtim të 20 vjetorit të ikjes në amshim të aktores ferizajase Adriana Abdullahu e cila u vra më 22 mars 1999 nga forcat serbe në Prishtinë.

Mesazhe nga artistët “Rri n’shpi”.- Me moton “Rri në shpi”, përmes rrjeteve sociale ishin organizuar prononcime nga artistët ferizajas, të cilët inkurajonin qytetarët që të jenë të kujdesshëm gjatë kësaj kohe të vështirë të pandemisë. Mesazhe u publikuan nga artistët dhe personalitete ferizajase: Besim Ugzmajli, Mevlan Saraçi, Gresa Gashi, Agon Qosa, Afrim Demiri, Lebibe Topalli, Gramoz Aliu, Veli Sahiti, Astrit Mustafa, Sadije Çarkaxhiu, Lindita Isufi, Mentor Haziri, Simoneta Bajrami, Vanesë Sadriu etj.

Rihapja e Muzeut dhe Galerisë - Në vazhden e masave lehtësuese kundër Covid 19, të rekomanduara nga IKSHPK dhe MSH, në listën e mundësisë së funksionimit të pjesshëm ishin galeritë, muzetë etj. Në kuadër të kësaj, Galeria e Arteve- Ferizaj dhe Muzeu i Qytetit, iu kthyen punës në pritje të mysafirëve dhe aktiviteteve të kufizuara.

Rock koncert Erëza Çerkini& Friends.- Me rastin e 21 Majit - Ditës Ndërkombëtare të Kulturës, në sallën e Bibliotekës së Qytetit, u organizua një rock koncert me këngëtarën ferizajase Erëza Çerkini. Në këtë gjendje të pa përshtatshme për aktivite kulturore, Drejtoria e Kulturës-Ferizaj, në bashkëpunim me RTV TEMA kanë organizuar një koncert të vogël, më pastaj për t’u prezantuar në Radio Televizionin TEMA.

Festivali i Recitatorëve- Online - Në kuadër të kalendarit të aktiviteteve kulturore, Sektori i Kulturës organizoi manifestimin “Festivali i Recitatorëve”. Fillimisht u hap një konkurs online dhe një platformë ku kishin mundësinë që të gjithë kandidatët të dërgojnë video interpretimet e tyre në adresën e festivalit. Juria e përbërë nga: Arben Marevci - aktor\ dramaturg, Ali Krasniqi – aktor dhe Shkëndije Azemi – aktiviste, vlerësuan të gjitha interpretimet, dhe pastaj dolën rezultate.

Koncert live- Veli Sahiti TRIX në Klan Kosova - Me transmetim nga TV Klan Kosova, në përkrahje dhe organizim të DKRS-së, u xhirua dhe transmetua live në kohë reale koncerti me këngëtarin e njohur ferizajas Veli Sahiti- Trix. Realizimi u bë në sallën e Teatrit Adriana - Ferizaj, pa prani të publikut, vetëm me stafin realizuas.

Anulohen të gjitha aktivitetet kulturore deri në një kohë të pacaktuar.- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Ferizaj, në koordinim me instancat e sigurisë dhe rekomandimet e IKSHPK-së, njofton të gjithë dashamirët e kulturës dhe njerëzit e artit, se anulohen të gjitha aktivitetet kulturore të parapara në muajin Qershor, si: "Ditët e Kulturës", "Dita e Çlirimit", aktivitete tjera rinore etj. Ndonëse stafi i Sektorit të Kulturës dhe komuniteti artistik, ishin të përgaditur për një varg aktivitete, por u vlerësua se shëndeti ynë është më parësor.

Festivali "Play Fest" - Gjatë tre ditëve të muajit Gusht, në hapësirën e e Parkut "Liria", u mbajt festivali i muzikës elektronike "Play Fest", festival i cili prezantoi grupe të njohura të muzikës elektronike, xhezit etj. Por u dhanë edhe disa aktivitete paralele në kuadër të festivalit. Festivali ishte i formatit online, pa prani të publikut.

Klubi Letrar "De Rada" Riboton Librin "Katërmbëdhjetë Autorë" - "Katërmbëdhjetë autorët" është antologji me poezi të autorëve ferizajas e botuar nga Klubi Letrar "De Rada" në vitin 1985. Menjëherë pas botimit, ky libër, me vendimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt të asaj kohe, ishte djegur publikisht në oborrin e kësaj gjykate. Pas 35 vjetësh Klubi letrar "De Rada", në pesëdhjetëvjetorin e themelimit të tij, me mbështetjen e Komunës së Ferizajt, e riboton këtë antologji, duke ruajtur formën dhe përmbajtjen e botimit që atëbotë nuk arriti deri te lexuesit.

Ferizaj me bashkëpunim kulturor me Bashkinë e Pogradecit - Një delegacion i Komunës së Ferizajt, i përbërë nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, vizituan Bashkinë e Pogradecit, ku u pritën nga Kryetari i Bashkisë së Pogradecit, Ilir Xhakoli dhe përfaqësues të institucioneve kulturore. Në këtë takim, të dy palët shprehën gatishmërinë e këmbimit të aktiviteteve dhe përvojave kulturore dy qyteteve.

Aktiviteti letrar Çka është poezia? - Edhe një aktivitet letrar online, por të një natyre tjetër u realizua me fëmijë dhe të rinj nga autorja Shkëndijë Azemi. Aktiviteti ishte treditore, ku u këmbyen ide dhe informata për poezinë dhe vullnetarizmin. Çka është poezia? Si duhet interpretuar poezinë? Vlera e poezisë? Çka na sjellë interpretimi i poezive, etj.

Aktiviteti tradicional letrar "Ora e Astritit" - Klubi Letrar "De Rada"- Ferizaj, tashmë disa vite organizon aktivitetin tradicional me karakter garues të poezisë "Ora e Astritit". Paraprakisht klubi kishte hapur një konkurs, ku kishin aplikuar poetë nga Kosova, Maqedonia, Shqipëria, diaspora etj. Rikujtojmë se aktiviteti mbahet në përkujtim të poetit dëshmorë Astrit Bytyçi. Pasi u prezantaun të gjithë autorët me interpretim të poezive të tyre, prej afro 60 poezi, juria profesionale kishte përzgjedhur 30 prej tyre si më të realizuara, të cilat edhe u përfshinë në broshurën e klubit. Poezitë e tyre u përcjellën nën tingujt e kitarës së Milot Bytyçit.

Festivali Ndërkombëtar i Filmit FERFILM - Ndonëse Festivali Ndërkombëtar i Filmit FERFILM, ishte paraparë të mbahej në muajin Prill, për shkak të rrethanave pandemike, sikur edhe shumë aktivitete të tjera, u desh të ndërrojmë disa herë datë të mbajtjes. Gjithsesi në përputhshmëri të plotë me rrethanat aktuale, festivali u mbajt gjatë periudhës 02- 06 tetor. Nata e parë solemne u hap në sheshin e qytetit, para Komunës, ku u shfaq filmi "Shpija e Agës", ndërsa netëve të tjera u dhanë filmat e shkurtër garues në sallën e Teatrit "Adriana" dhe një pjesë në Galerinë e Arteve. Prezantuan mysafirë nga Maqedonia, Shqipëria, Polonia e Kosova. Fitues i vendit të parë ishte filmi "Tightness" i regjisorit Alexandre Estevanato nga Brazili. Mirënjohje u nda për autoren nga Polonia që ishte prezente në festival Natalia Bombala.

“Panairi i Librit”, realizuar nga Klubi Letrar “De Rada”- Ferizaj - Klubi letrar "De Rada" nga Ferizaj organizon edicionin e dytë të Panairit të librit "Ferizaj 2020". Hapja solemne e panairit u bë më 8 tetor, për të vazhduar më pastaj tri ditë radhazi. Morën pjesë shumë shtëpi botuese nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia etj. Shumë dashamirë ferizajas të librit u panë në vizitë panairit dhe në blerjen e librave. Krahas panairit, u realizuan edhe disa aktivitete paralele me karakter letrar, promovime, orë letrare etj.

Koncert i muzikës klasike me artistë nga Kumanova - Në Galerinë e Arteve-Ferizaj performoi tenori i talentuar nga Kumanova Ismet Vejseli, i përcjellur në piano nga Kolos Curri. Ky koncert u organizua nga Shoqata për Edukatë Rinore nga Kumanova, ndërsa nikoqir ishte Drejtoria e Kulturës në Ferizaj.

Manifestimi tradicional letrar "Muzat e Jezercit"- nga Klubi Letrar "De Rada" Ferizaj.

Në Jezerc, nisi edicioni i IV-të i Kolonisë Letrare “Muzat e Jezercit”, organizuar nga KL “De Rada”, ku u mbajt orë letrare, promovim libri, aktivitete me të rinjtë etj. Dita e dytë iu kushtua krijuesit të ndjerë ferizajas Musli Berisha, që vdiq më 2 gusht të këtij viti. Folën miq e dashamirë të të ndjerit, si dhe u shpalos opusi i veprave letrare të tij. Rikujtojmë se të gjitha aktivitetet letrare që po shënon Klubi “De Rada” sivjet, janë në vigjilje të shënimit të 50 vjetorit të themelimit. Kolonia Letrare “Muzat e Jezercit” mbyll më 25 tetor, me një aktivitet të rinj.

Kino Klubi “Ismail Rama” filloi me shfaqje të filmave. - Ditëve të fundit është themeluar Kino Klubi i ri me emrin e artistit ferizajas “Ismail Rama”. Klubi ka filluar që çdo të shtunë të shfaq filma artistik të kinematografisë botërore.

Promovimi i librit "Mendimet tona na shpëtojnë, mendimet tona na vrasin" Olza Sejdiu.

Në sallën e Teatrit “Adriana”, në organizim të Klubit Letrar “De Rada” dhe Sektorit të Kulturës, u promovua libri i autorës së re 16 vjeçare Olza Sejdiu, me titull: "Mendimet tona na shpëtojnë, mendimet tona na vrasin".

“Fëmijët e Gëzuar”, edicioni i 32-të - Në masa dhe përkujdesje rigoroze, pa praninë e publikut, u mbajt Festivali i këngës për fëmijë: Fëmijët e Gëzuar". Në festival prezantuan këngëtarë fëmijë nga Kosova, Maqedonia etj. Transmetoi drejtpërdrejt RTV Festina. Vendin e parë e fitoi Lis Demiri nga Gostivari, me këngën: “Borzilok ne festival”. Poashtu u ndanë edhe vendet e tjera, si dhe u shpërblyen edhe shumë këngëtarë të tjerë.

Festivali i muzikës popullore “Kosovarja Këndon”, edicioni i 48-të - Në sallën e Teatrit “Adriana”, u mbajt edicioni i 48-të i Festivalit “Kosovarja Këndon”, ku 13 kandidate nga vende të ndryshme të Kosovës (Prishtina, Gjiçani, Fushë Kosova, Obiliqi, Artana, Hani i Elezit etj) Ndonëse një sallë publiku, e pa publik, artistët u përpoqën që përmes ekranit televiziv t'i përcjellin interpretimet e tyre. Festivalin e hapi kënga fituese e vitit të kaluar: "Kno bylbyl me t'madhin za" nga Alma Haxhiu" nën përcjellje të orkestrës profesioniste AKV “Kastriotët” me formacion të zgjeruar, nën udhëheqjen artistike të Fitim Bytyçit, i cili ishte edhe orkestrues i të gjitha këngëve pjesëmarrëse. Pas përfundimit të të pikave garuese, Rreze Kryeziu-kryetare e jurisë publikoi emrat e fituesëve: të cilët ishin:

VENDI I PARË - Aurela Krasniqi nga Obiliqi, me këngën: “Valse i lumturisë”

VENDI I DYTË - Naile Halili nga Ferizaj, me këngën “Një lule”

VENDI I TRETË (dy vende të treta) Anisa Shabani nga Ferizaj, me këngën: “Zambaku i Prizrenit”

Diellëza Dedushi nga Prishtina, me këngën “Nënë moj do pres gërshetin”

ÇMIMI SPECIAL “NEXHMIJE PAGARUSHA”

Diana Mehmeti nga Ferizaj, me këngën: “Kur bjen fyelli çiftelia”

ÇMIMI I GAZETARËVE NGA KLUBI I GAZETARËVE “HAKI BRAHA”

Anes Bunjaku nga Artana, me këngën “Kroi i fshatit tonë”

Në pjesën speciale prezantuan Kori i Vajzave, Liridon Sadriu e Mentor Haziri. Në këtë edicion Kosovarja u bë zë i kampanjës të mbijetuarave të dhunën seksuale nga koha e luftës.

Program kulturo-artistik për fundvit - Zakonisht muaji Dhjetor konsiderohet si muaj i përmbledhje të raporteve, programeve përmblyëse, festave të fundvitit, rifillimit të planeve për vitin në prag etj. Si dhe organizohet një program kulturo-artistik për fundvit. Por natyrisht sivjet, si thuajse gjatë gjithë vitit, u mbajt një program tejet i reduktuar. Artisti i vitit 2020 u shpall **këngëtari ferizajas, Mentor Haziri**.

TEATRI I QYTETIT “ADRIANA”

Teatri Profesional “Adriana Abdullahu”, në bashkëpunim të mirë me strukturat komunale, gjeëjësist D.K.R.S-në, dhe Këshillin Drejtues të Teatrit, arriti që ti realizojë dy (2) premiera teatrore. Premierat në vitin 2020:

1. “Kontrolli dhe makina e dashurisë”, autor dhe regjisor: Besim Ugzmajli
2. “Vizita e zonjës Plakë”, Friderih Durremnm, regjia: Sulejman Rushiti

Për shkak të pandemisë së Coronaviruesit Covod 19, shfaqja tjetër e planifikuar për këtë vitë është shtyrë për vitin tjetër. Gjithashtu me konsulta me këshillin drejtues të teatrit, është shtyrë edhe mbajtja e Festivali i Teatrove.

1. Teatri DODONA, me shfaqjen “MAT”
2. Teatri ADRIANA, me shfaqjen “Hanibali i nëntokës”
3. Teatri ADRIANA, me shfaqjen “Derisa vdekja nuk na ndanë”
4. Teatri ADRIANA, me shfaqjen “Kopraci”
5. Teatri ADIANA, me shfaqjen “UN Inspektori”

Fillimi i provave të shfaqjes “Kontrolli dhe makina e dashurisë” Nga Besim Ugzmajli. Teatri Adriana gjatë këtij muaji, ju bashkanigjitë thirrjes për ndihmë financiare të riut Ardit Gashi, me të hyrat nga shfaqjet e repertorit. Shuma e mbledhur ishte: 304 €

1. Teatri Dodona me shfaqjen “Unë jam vetë grua”
2. Teatri Gjilanit “Ofsham”
3. Teatri AAB “Bretkosat”
4. Teatri i Vushtrisë” Nuk do të paguajmë”
5. Teatri Adrian me shfaqjen “Derisa vdekja nuk na ndanë”
6. Teatri Adriana në Gjilan me shfaqjen “Derisa vdekja nuk na ndanë”
7. Teatri Adrina me shfaqjen “UN Inspektori”
8. Teatri Dodona me shfaqjen “Harroje Hollivudin”
9. Teatri Adriana me shfaqjen “Kopraci”

Edhe në këtë muaj teatri Adriana ju bashkangjitë thirrjes për ndihmë financiare për Jetmir Vehbiun, nga të hyrat e repertorit të Teatrit për muajin Shkurt me shumën: **424 €**

Pas mbajtjes së shfaqjes “Shfaqja e fundit e Maria Gjoni” nga Teatri Kombëtar, ndërpriten të gjitha aktivitetet teatrore dhe provat e shfaqjes në proces “Kontrolli dhe makina e dashurisë”.

Në muajin Maj dhe Qershor në bashkëpunim me Teatrot e Kosovës dhe teatrot private, mbahet repertori online për këta dy muaj.

Më 3 qershor, fillojnë përgatitjet për shfaqjen “Kontrolli dhe makina e dashurisë”.

Më 17 qershor, mbahet premierë e mbyllur e shfaqjes “Kontrolli dhe makina e dashurisë”

Më 8 dhe 9 korrik, mbahet shfaqja “Kontrolli dhe makina e dashurisë” në ora 18:00

Me 6,8,9, 15 tetor, kthehet repriza e shfaqjes “Kontrolli dhe makina e dashurisë”

Me 13 tetor, Stand Up Komedia me Avni Shkodrën

Me 7 tetor fillon provat e shfaqjes: “Vizita e Zonjës plakë” Durrenmat, regjia:Sulejman Rushiti

Me 24 tetor, fillon punën Kino Klubi “Ismajl Rama” Me filmin”Persona” Bergman

Më 28 tetor në kuadër të Shou Case 2020 shfaqet shfaqja “Balava” nga Beogradi

Me 29 tetor, në kuadër të Shou Case 2020 shfaqja” Kontrolli dhe makina e dashurisë

Me 31 tetor, shfaqet filmi “House Nga Obayashi” Nobuhiko Obayashi

Përsëri ndërpritet repertori dhe provat e shfaqjes në teatër nga gjendja e pandemisë.

Shfaqja “Vizita e Zonjes plakë” pritët ta këtë premierën në mes datave 22-24 dhjetor, 2020.

Me rëndësi

Në këtë vit, pas një pune dhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet përgjegjëse, Teatri “Adriana” shpalli Konkursin për pranimin në punë të stafit Artistik dhe stafit administrativ e teknik. Nga ky konkurs u pranuan në punë tetë aktorë/e; udhëheqësi artistik; dramaturgu; inspicienti; si staf artistik, kurse si staf administrativ teknik u pranuan në punë: Mjeshtri i ndriçimit; Tonist/biletashitës; Punëtor skene; Financier; Administratore; Grimer/e; Mjeshter skenografie. Gjithsejt të punësuar në Teatër me kontrata të rregullta janë 22 të punësuar.

Furnizimet në Teatër

Me angazhimin e DKRS-së, janë bërë shumë furnizime në paisje dhe gjëra të nevojshme/domosdoshme për Teatrin:

1. Të gjitha perdet/Kulisat e Teatrit duke përfshirë edhe balloren
2. Lavatriçe
3. Tharëse për rroba
4. Makinë për qepje dy copa
5. Makinë dore për qepje
6. Kositëse për bari
7. Mbajtëse/varëse për rroba
8. Të gjitha llojet e penjëve
9. Thithëse elektrike

Në proces janë edhe "Karriga për grim si dhe grimi.

Në proces janë edhe rregullimi i disa qesmeve me ujë të ngrohtë.

Në proces është edhe miratimi i Rregullores së Brendshme të Teatrit.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe shumë aktivitete tjera në Teatër, jo vetëm kulturore.

GALERIA E ARTEVE

Galeria e Arteve është institucion qeveritar i kulturës në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Ferizajt. Galeria e Arteve zhvillon aktivitete kulturore që kanë të bëjnë me artet pamore, si: pikturë, skulpturë, grafikë, dizajn, fotografi, arte bashkëkohore etj.

Ndonëse një vit i vështirë për komunitetin artistik dhe për gjithkënd, megjithëatë Galeria e Arteve arriti jo vetëm të zhvillojë shumë aktivitete, por u bë portë edhe për aktivitete tjera artistike e jo artistike.

Hapja e konkursit mbarëkombëtar - Çmimi “Gursel Sylejmani”. -Organizuar nga Galeria e Arteve në Ferizaj dhe SHAF “Zef Kolombi”. Pranini i punimeve të artisëve nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, etj.

Ekspozita tradicionale kushtuar 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Kosovës - Hapja solemne e ekspozitës kolektive tradicionale çmimi “Gursel Sylejmani”, organizuar nga Galeria e Arteve dhe SHAF ”Z. Kolombi”– Ferizaj në edicionin e saj XII-të. Në ekspozitë morën pjesë 48 artistë nga Kosova, Maqedonia dhe Kosova lindore të cilët prezantuan veprat e tyre multidisiplinare të artit pamor. Juria profesionale, fituese e shpalli artisten **znj. Laureta Vogliqi** dhe ndau çmimin “Gursel Sylejmani”.

8 mars- Ekspozitë me moton "RRUGA E BARAZISË, organizuar nga Mural Fest dhe nga IpMK. Në kuadër të aktiviteteve të DKRS për shënimin e 8 Marsit- Dites së Gruas, në Galerinë e Arteve - Ferizaj, u hap ekspozita "RRUGA E BARAZISË, organizuar nga Mural Fest dhe nga IpMK. Në ekspozitë me punimet e tyre morën pjesë nxënës nga shkollat fillore: Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit.

Festivali i Karikaturës nga SHK “HiTHi” (Edicioni i 6-të) - Në një atmosferë simbolike, në një kohë pandemie, Galerinë e Arteve- Ferizaj, u bë hapja e Festivalit Ndërkombëtar të Karikaturës, edicioni i 6-të, organizuar nga SHK "HITHI". Festivali i Karikaturës është ndër të vetmit në rajon që ka karakter ndërkombëtar, andaj DKRS i kushton rëndësi të veçantë. Ekspozita u vizitua nga më shumë se 950 vizitorë. Por vizitorë pati edhe pas përmbylljes së periudhës së ekspozitës.

Paraprakisht, dy ditë ka punuar juria seleksionuese duke i përzgjedhur nga 1650 karikatura, vetëm 99. Pastaj janë përzgjedhur vetëm 32 sosh dhe i janë dërguar jurisë vlerësuese.

Fituesit e garës ishin:

Diego Feld nga Argentina

Aleksei Kivokurtcev nga Russia

Seyran Caferli nga Azarbayjan.

SHK “HiTHi” punëtori me nxënës. - Në Galerinë e Arteve, SHKA “HiTHi” organizoi një puntori me nxënës me qëllim të njohjes dhe praktikës së artit të karikaturës.

Festivali i Muraleve MuralFest.

Afro 15 ditë në Ferizaj qëndruan një numër i madh i artistëve ndërkombëtarë (piktorë, skulptorë etj) të ardhur nga SHBA, Polonia, Spanja, Maqedonia, Franca, Italia etj. Ky numër prej afro 20 artistëve ishin mysafirë të Festivalit të Muraleve “Mural Fest”, i cili po e realizon edicionin e V-të me radhë. Gjatë kësaj kohe nga këta artistë dhe ata vendorë, u realizuan disa murale në Ferizaj, stripe, grafite, skulptura e vepra të tjera artistike. Mural Fest, si festival ndërkombëtarë ka tejkalur kufijtë kohor, duke qenë aktiv gjatë gjithë vitit me projekte të ndryshme, punëtori, ligjërata, aktivitete rinore etj.

Ekspozitë virtuale organizuar nga: Galeria e Arteve dhe SHAF ”Zef Kolombi” në Ferizaj

30 tetor - Ekspozitë personale e piktores Laureta Vogliqi

Në sallën e Galerisë së Arteve u hap ekspozita personale e piktores Laureta Vogliqi me titullin “Puntoria e Babit”. Kujtojmë se Laureta me punimin e saj, ishte fituese e çmimit “Gursel Sylejmani” në Ekspozitën e Pavarësisë. Ekspozita u organizua nga Galeria e Arteve, në përkrahje të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ferizaj. Laureta prezantoi me 27 piktura dhe 2 instalime (art konceptual); Ekspozita kishte rreth 400 – 500 vizitorë gjatë afro një muaji.

Galeria e Arteve gjatë këtij fundviti veçse pret vizitorë kohë pas kohe, poashtu vazhdon të jetë në rrjetet kulturore të artit pamor etj, si dhe në organizimet e tjera që organizon Sektori i Kulturës. Duhet theksuar se në Galerinë e Arteve janë bërë një mori aktivitete që kanë qenë jashtë plan-programit të Galerisë, por Galeria Arteve e ka përkrahur, si dhe aktivite kulturore por jo nga fusha e artit pamor.

Vizitat në Galeri - Galeria e Arteve tash e sa vite është pikë e shumë vizitorëve, qoftë vendas por edhe ndërkombëtarë. Natyrisht ata që më së shumti e frekuentojnë Galerinë janë komuniteti i artistëve, pastaj dashamirët e kulturës, nxënës të shkollave që vijnë në mënyrë të organizuar në grupe, pastaj student etj.

MUZEU I QYTETIT

Thua jse gjatë gjithë vitit vazhdon fushata sensibilizuese e promovimit të Muzeut, ku hyjnë mediat e shtypura dhe elektronike, po ashtu përmes katalogjeve dhe posterëve dhe broshurave e cila ka për qëllim të bëjë promovimin e trashëgimisë kulturore;

Vizitë nga disa studentë të cilët iu ofruam informacioneve që kishin për synim që në punimet e tyre të paraqesin elemente të trashëgimisë kulturore nga aspekti i fushës së etnologjisë; pastaj vizitë nga artistë dhe aktivistë nga qyteti, pastaj nga mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të Komunës së Ferizajt. Të gjithë vizitorët patën rastin të njihen me trashëgiminë kulturore në Ferizaj dhe eksponatet e Muzeut të Qytetit.

Në kuadër të bashkëpunimit në mes shkollave të Komunës së Ferizajt dhe Njesisë për Trashëgimi dhe Muze, kemi filluar me ligjërata për Trashëgiminë Kulturore të trevës së Ferizajt, duke i informuar nxënësit, për vlerat që posedon Trashëgimia Kulturore dhe njëkohësisht, edukimi i brezit të ri me trashëgiminë e luajtshme dhe të paluajtshme që posedon rrethina e Ferizajt. Shkolla që filluam ishte Gjimnazi "Shaban Hashani" Ferizaj!

Në kuadër të 30 vjetorit të "Pajtimt të Gjaqeve" në ambientet e Universitetit të Ferizajt u mbajt Tribunë Shkencore me temën "Rëndësia historike e Pajtimt të Gjaqeve në trevën e Ferizajt", ku me këtë rast me kumtesa u paraqiten shumë profesorë, duke na sjellë të dhëna historike për njërën ndër ngjarjet me rëndësi në historinë më të re të Kosovës. Në kuadër të këtij manifestimi, u bë edhe promovimi i librit "Kronikë Pajtimesh" të autorit Raif Musa.

Poashtu Njësia për Trashëgimi dhe Muze, ka organizuar një ekspozitë me fotografi që kanë të bëjnë me "Lëvizjen e Pajtimt të Gjaqeve" ekspozita është hapur më (26.02.2020) dhe mbeti e hapur disa ditë të jetë e hapur në hollin e Universitetit të Ferizajt!

Njësia për trashëgimi e muze e organizoi një vizitë pune të mullinjtë ujit që gjenden në fshatin Nerodime kemi të bëjmë me mullirin e Babushit, vizitë përnjohëse për të parë nga afër mullinjtë ujit që gjenden në fshatin Pleshinë etj. Gjatë kësaj kohe, Muzeut ju dhuruan eksponate me vlera historike nga dhurues prej fshatit Loshkobare.

Gjatë rrethanave të reja të situatës së pandemisë, u promovua Trashëgimia Kulturore nga shtëpia përmes rrjeteve sociale, komunikimeve tj.

Prezantimi i pamjeve vizuale të njëres prej ngjarjeve me rëndësi historike për trevën e Ferizajt.

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Lokaliteteve (18 prilli). Kemi vendosur të prezatojmë një shtëpi tradicionale shqiptare e tipit dy katësh me kulm piramidale e ndërtuar në vitet 80-ta, të shek.XIX-të, nga një familje shqiptare e dëbuar nga dhuna serbe e viteve 1877-1878 dhe e vendosur në vendin e quajtur Fusha e Madhe, vend shumë afër fshatit Rahovicë. Andaj ajo që bëmë thirrje në kuadrin e kësaj dite është ruajtja dhe rritja e kujdesit për trashëgiminë kulturore të trevës së Ferizajt!

Në vazhdim të masave lehtësuese kundër Covid 19, të rekomanduara nga IKSHPK dhe MSH nga 18 Maji 2020, hapen Muzetë, duke i respektuar masat e mbrojtjes). Aranzhimi dhe sistemi i artefakteve të muzeut për të krijuar një ambient më të mirë për prezantimin e Trashëgimisë Kulturore të Ferizajt.

Ekspozitë virtuale - Prezantimi i Katalogut i Muzeut të Qytetit në Ferizaj, në këtë prezantim kemi përfshirë pjesën e parë. Prezantimi i Katalogut i Muzeut të Qytetit në Ferizaj, në këtë prezantim kemi përfshirë pjesën e dytë!

Vizita në terren - për t'u njohur nga afër me vlerat e Trashëgimisë Kulturore që posedon treva e Ferizajt, u organizuan disa vizita në terren duke nisur nga Xhamia e cila gjendet në lagjen e Berishëve në Greme; Shkolla (Mejtepi i dikurshëm) i fshatit Pleshinë dhe Mulliri i Babushit në Nerodime të Epërme, shkolla e

Nerodimes, mulliri i Babushit, Selman Begut etj. Vizitë në Nerodime te Mulliri i Ramadan Rekës; Vizita në Talinoc të Muhaxherëve për tu njohur me Xhaminë mbi një shekull që gjendet në këtë fshat; në fshatin Mirosalë, për të parë gjendjen e një thesari të rëndësishëm trashëgimor në aspektin religjioz, Teqja e Mirosalës e cila gjendet në lagjen e Bytyqve dhe ajo që ka rëndësi ende vizitohet dhe ruan shumë nga eksponatet që gjenden në të; Vizitë në fshatin Koshare për të parë nga afër një shtëpinë e pronarit Hasan Fazlisë më shumë se një shekull që ruan vlerat e saj arkitekturore dhe trashëgimore duke plotësuar mozaikun e kulturës materiale që posedon treva e Ferizajt; Vizita në Nerodime të Poshtme lokaliteti i kishës ku gjendej Mozaiku i periudhës së vonë të antikitetit që na pasqyron për një jetë pasur religjioze qysh në shekujt IV-V e.s.; mësimdhënësit e SHFMU “Ahmet Hoxha” të cilët u njohën me trashëgiminë kulturore që posedon Ferizaj, etj.

Dhurimi eksponateve etnologjike nga një dhurues i fshatit Zaskok. Edhe në këtë periudhë vazhduam me disa vizita studimore të disa lokaliteteve, si: në lokalitetet arkeologjike në fshatin Nerodime; vendin e quajtur ura të fshatit Nikadin; në fshatin Gaçkë për të parë vendin e shkollës së hershme në atë trevë dhe për të parë nga afër koleksionistët privat; në fshatin Talinoc, xhamia e vitit 1908; Jezerc te Mulliri i Selman Begut; në Komogllavë përkatësisht në vendin e quajtur lokaliteti Kroi ku me atë rast muzeut ju dhuruan tubacione të atij lokaliteti të periudhës së vonë të antikitetit; në Jezerc në shtëpinë tradicionale Emrush B. Jasharit e shek. XIX-të; pastaj vizitë Qendrën e Mjekësisë Familjare në maternitetin e Ferizajt si një ndër objektet më të vjetra; në monumentin e periudhës osmane, mejtepi i Shek. XIX-të; Sojevë lokalitetit arkeologjik; në Kishën “Ëngjulli i Rojës” në Ferizaj, etj.

Ofrimi i informacioneve për studentë arkitekturës, historisë, antropologjisë, etnologjisë dhe arkeologjisë mbi trashëgiminë kulturore e trevës së Ferizajt dhe për Muzeun e qytetit.

Vizitë në fshatin Zaskok për të parë nga afër gjendjen e monumenteve ku ishte tuma ilire. Fotografime në terren e trashëgimisë kulturore. Vizitë në fshatin Rahovicë në lokalitetin fusha e madhe për të parë nga afër gjendjen e shtëpive;

Një dhurues nga Ferizaj, ka ndihmuar muzeun me artefakte nga zejet tradicionale;

SEKTORI I RINISË

Spektori i Rinisë është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, e që merret me aktivitete rinore, takime edukative, kreative dhe prosperuese.

Viti 2020 ishte vit i vështirë për Spektorin e Rinisë për dy arsye. Fillimisht për shkak ndërrimit të udhëheqjes së këtij sektori, që shkaktoi një vakum deri në një konsolidim të ri, si dhe gjendja pandemike që paralizoi jetën kulturore dhe gjallërinë e të rinjëve.

Sidoqoftë Spektori i Rinisë, krahas ngjarjeve të tjera të organzuara nga DKRS, organizoi dhe udhëhoqi shumë aktivitete rinore me iniciativë të ndryshme.

Takim me Klubin Janova

Nga ky takim mësuam se si shkon procesi i fazave të projektit të vullnetarizmit edukativ. Fazat që duhen kaluar janë konceptimi, planifikimi, zbatimi, monitorimi, vlerësimi, dhe festimi. Pra, ky proces do të na ndjek në çdo projekt të vullnetarizmit edukativ.

Themelimi i grupit të vullnetarëve nga Spektori i Rinisë

Ky grup i të rinjëve do të zhvillojë aktivitete me Spektorin e Rinisë. Këtë grup do ta udhëheqë aktivistja Vanesë Sadriu, fituese e shumë çmimeve për vullnetarizëm, humanizëm dhe e dalluar në studimet e saja.

Rinia ferizajase nderon të kaluarën

Sektori i Rinisë dhe grupi i vullnetarëve tanë të udhëhequr nga Vanesë Sadriu, vizituan vendet historike në përkujtim të lavdisë sonë. Fillimisht në vendin më të vlefshëm për shqiptarët Prekazi tek memoriali i Familjes Jashari, tek memoriali i Dëshmorëve të Kombit në Gillogjan, në Gjakovë tek Nëna Ferdonije Qerkezi dhe së fundmi u ndalëm në Reçak në memorialin e masakrës së 44 civilëve gjatë luftës sonë të fundit.

Grupi i vullnetarëve, aktivitet në pediatri

Ne, vullnetaret e Sektorit të Rinisë sot i dhamë një pamje ndryshe repartit të Pediatrisë në Spitalin e Ferizajt. Tani për fëmijet, ky ambient do jetë me i ngrohtë dhe do lehtësoj frikën e tyre për të kryer shërbimet e tyre shëndetësore.

Ekspozitë me fotografi "Pandemia në syrin e të rinjve"

Organizuar nga Sektori i Rinisë në kuadër të "Ditët e Kulturës"-Ferizaj 2020.

Krijimi i Bibliotekës në Qendrën e Shëndetit Mendor

Krijimi i Bibliotekës ka qenë një gjest me vullnetarët e sektorit që ka patur për synim që pacientët e sëmurë mendor të krijojnë aktivitete të leximit.

Sektori i të rinjve begaton me lule e pemë hapësirat tek Varrezat e Dëshmorëve

Me iniciativën e vullnetares së Sektorit të Rinisë Alda Haxhisalihu sot ne mbollëm 62 lule shumëvjeçare që simbolizojnë 62 dëshmorët e lirisë të komunës sonë, nga një lule e freskët për secilin dëshmor. Poashtu, ne kemi mbjellur 7 drunjtë dekorativ shumëvjeçar në formën e hartës së Kosovës që simbolizojnë 7 zonat operative të luftës së UÇK-së dhe një pemë të ullirit që jeton gjatë ndër ne.

Ekspozitë me këpucë kushtuar të pagjeturve

1641 palë këpucë për 1641 njerëz të zhdukur gjatë luftës së fundit në kuadër të ditës së të zhdukurve. Aktiviteti është zhvilluar nga Vullnetarët e Sektorit Rinor të cilët kanë ekspozuar më sheshin Regjep Bislimi këpucët në shenjë mungese ndaj atyre që po kërkohen sot e 20 vite.

Dita Botërore kundër abuzimit dhe trafikimit të drogave.

Sot u bë përrurimi i reportazhit dhe muralit të parë në Komunën e Ferizajt nga Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt. “I riu ëndërron dhe përpiqet të jetë një zog i lirë. Por varësia nga droga ia pret krahët” andaj aktivitete të tilla ndërgjegjësuese duhet të ketë në vazhdimësi për të kontribuar që të rinjve mos t’iu priten krahët por të jenë të lirë, kreativ dhe kontribues në ndërtimin e shtetit tonë.

Me moton "Shkolla është ardhmëria jonë" - U mbajt fushata vetëdijësuese për regjistrimin e fëmijëve për klasën e parë dhe klasën parafillor.

Klubi NOVA sjell revistën e saj në shkollat fillore të Ferizajt- Revista në vete është pasqyrim i ditarit të super-vullnetarëve gjatë ditëve të karantinës. Secili vullnetar ka ilustruar aktivitetet që i bëjnë gjatë gjithë ditës.

Mbroje veten dhe familjen tënde!

Ky aktivitet sensibilizues për masat mbrojtëse nga Covid-19, u organizua nga Kuvendi i të Rinjve është përkrahur financiarisht nga Sektori i Rinisë-DKRS.

Dita Ndërkombëtare e Rinisë

- Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt

Organizoi ekspozitën "Frymë Aktivistësh" për nder të kësaj date, me të cilën promovuar punën e aktivistëve dhe organizatave joqeveritare rinore që kanë mbajtur gjallë shpirtin e qytetit tonë.

Hiking me të rinj

Me të rinjtë ferizajas kaluam një të Dielë tek Liqeni i Jazhincës ku të rinjtë shijuan bukuritë e maleve të Sharrit. Me ftesën e vullnetarëve të Sektorit të Rinisë ju kam bashkangjitur kësaj ecje dhe shijimit të bukurive që I ofron natyra.

Shkrimtarja e re ferizajase Blerina Murtezi promovoi librin e saj të dytë "Ëndrrat e mia" Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt duke u bazuar në qëllimin tonë, përkrah Blerinën e cila është inspirim për të gjithë pavarësisht sfidave të jetës vazhdon t'i ndjekë ëndrrat e saj.

Kuvendi i të Rinjve në bamirësi

Gjatë ditës së sotme Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt shënoi Ditën Ndërkombëtare të Bamirësisë.

Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt ka shpërndarë dhjetëra familjeve në nevojë çanta me mjete shkollore dhe gjëra të tjera ushqimore.

Dita Ndërkombëtare të Solidarizimit me Gazetarë

Sot në Ditën Ndërkombëtare të Solidarizimit me Gazetarë, Kuvendi i të Rinjve të Ferizajt shpreh solidarizimin e plotë me komunitetin e gazetarëve.

Pastrimi i parkut të pishave nga vullnetarët

Vullnetarët e Sektorit të Rinisë sot e filluan të parët të pastrojnë Parkun e Pishave në Rahovicë, për të nisur kështu një vetëdijësim të secilit nga ne.

Çertifikimi i të rinjve nga AVONET

Rrjeti i OJQ-ve AVONET trajnime në kuadër të projektit: "Rinia e gatshme për punë", e mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamenti i Rinisë dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Gjatë trajnimit u çertifikuan 105 të rinj kryesisht nga fusha e Ndërmarrësisë dhe Shkathtësive të buta. Poashtu nga Avoneti u realizua edhe trajnimi "Gratë në ndërmarrësi" ku u çertifikuan 15 gra.

Java e KFOR-it

Sektori i Rinisë, në bashkëpunim me grupet e të rinjve dhe njësitin KFOR - LMT, organizuan aktivitetin tradicional "Java e KFOR-it", e cila u shënuar me disa aktivitete sportive si futsal, basketball, si dhe shfaqje filmi. Aktivitetin e përfunduan me nga një kafe sëbashku me të rinjve dhe pjestarëve të KFOR-it për t'i shkëmbyer më shumë shkathtësitë e tyre në Gjuhën Angleze.

Dita pa Makina

Sektori i Rinisë bashkë me grupin e të rinjve shënoi aktivitetin "Dita pa Makina", aktivitet i cili kishte për qëllim sensibilizimin e të qytetarëve të ngasin më shumë biçikleta. Çiklistët sëbashku u nisën nga sheshi "Adem Jashari" dhe vazhduan sëbashku deri tek Restaurant "California" me që rast pushuan sëbashku për kafe çasti dhe u rikthyem në qytet.

Turnir në Futsall

Me pjesëmarrje të njëmbëdhjetë ekipeve organizohet turnir në futsall. Në një atmosferë sportive në Palestrën e Sporteve "Bill Clinton", u mbajt turnir në futsal nga të rinjtë e qytetit, organizuar nga DKRS dhe vullnetarët e Sektorit të Rinisë. Ky turnir do të jetë tradicional dhe pritet të mbahet edhe në vitet e ardhshme, duke patur në vazhdimësi përkrahjen e DKRS-së.

Aktivitet me thënie poetike

Vullnetarët e Sektorit të Rinisë përkahën idenë e vullnetares Elsa Aliut, një aktivitet tjetër me thënie të autorëve shqiptar dhe të huaj të ekspozuara në sheshin e qytetit. Thëniet u ngjitën në shtyllat elektrike dhe u ekspozuan për qytetarët e rëndomt që kalonin andej.

Aktivitet bamirës i vullnetarëve

Vullnetarët e Sektorit Rinor ekspozuan rrobat e tyre për t'i dhuruar personave të cilët kanë nevojë në këto kushte të vështira pandemie dhe ftohti që po mbizotëron këto ditë. Megjithatë se ishte kohë e ftoht, deri në fund të ditës vigu i ekspozuar në sheshin e qytetit ishte i zbrazët për shkak të interesimit të shumtë të qytetarëve për veshjet e ekspozuara.

Shpallja e vullnetarit të vitit 2020 – Alma Topalli

Komisioni i përbërë nga pesë anëtarë nga Shoqëria Civile dhe Sektori i Rinisë në tre takimet e saj të mbajtura dhe nga shqyrtimet e aplikantëve me votat e shumicës shpalli Alma Topalli "Vullnetare të vitit 2020". Çmimi u dha në Galerinë e Arteve në praninë e të gjithë aplikantëve, të rinjve të pranishëm dhe mediave.

SEKTORI I SPORTIT

Sektori i Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, e që merret me aktivitete sportive.

Viti 2020 ishte vit i vështirë për Sektorin e Sportit. Ky vit ka solli vështërsi të mëdha për shkak të pandemisë dhe në masë të madhe ka dëmtuar klubet sportive si në procesin stërvitor ashtu edhe në zhvillimin e lojërave kampionale, por megjithatë DKRS dhe klubet sportive janë përpjekur që mos t'i ndërpresin aktivitetin sportiv.

Në raportin vjetor, fillimisht po japim gjeneralet e klubeve sportive të vitit 2020 ku janë të përfshirë 51 klube sportive dhe 4 shoqata të organizuar deri diku mirë në zhvillimin e sportit në Ferizaj.

Në të gjitha klubet sportive janë të përshira në të dy gjinitë me të gjitha grupmoshat duke u përfshirë nga grupmosha U 7 deri tek senoret, çka do të thotë se në komunën tonë kemi diku rreth 3150 sportistë aktiv, dhe diku rreth 6500 sportistë rekreativ.

Muaji Mars, Prill dhe Qershor - Pallati i Sporteve është shfrytëzuar për shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë. Një numër i punëtorëve ishte liruar nga puna kurse pjesa tjetër ishin aktiv gjatë gjithë kohës.

Në këtë periudhë, shumica e klubeve sportive aktivitetet stërvitore i kanë mbajtur në natyrë duke i respektuar masat anti-covid, por vetëm ndeshjet e parapara janë zhvilluar në Pallat dhe Stadium të Futbollit, kurse pas lehtësimit të masave stërvitjet dhe lojërat janë zhvilluar normalisht.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria është munduar që t'i riorganizoj kryesitë e klubeve aty ku kishte nevojë dhe t'i mbaj aktiv deri në fillimin e stinorit vjeshtor dhe ka krijuar 5 klube të reja sipas nevojave dhe kërkesave.

REKAPITULIM

Në Komunën tonë kemi 51 klube sportive, 4-shoqata sportive të cilat aktivitetin e vetë e zhvillojnë në një hapësirë sportive prej 43,421 m².

Stërvitjet e realizuar gjatë vitit 2020

Pallati i Sporteve “Bill Clinton” – në Pallatin e Sporteve në Ferizaj gjatë vitit 2020 janë realizuar gjithsej 865 orë ekonomike, stërvitje. Shfrytëzues të Palestrës, kryesisht janë klubet sportive ferizajase.

Lojë Kampionale - Në **Pallati i Sporteve “Bill Clinton”** janë realizuar gjithsej 69 lojë kampionale.

Stadiumi i Qytetit “Dardania” - Në Stadiumin e Qytetit në Ferizaj janë realizuar 513 orë ekonomike, stërvitje, 28 lojë kampionale dhe 5 lojë miqësore.

AKTIVITETE SPORTIVE

Turneu në Volejboll, Institucionet e Komunës së Ferizaj (femrat). Komuna e Ferizajt gjegjësisht DKRS për nder të 17 Shkurtit organizoi turneun e institucioneve në volejboll (femrat), pjesëmarrëse ishin 6 ekiye

të organizatave punuese ku vendi i parë i takoi Polica Rajonale, 2 Spitali rajonal dhe vendi i tretë QKMF-së. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe mirënjohje nga organizatori.

Vendosja e Pemës Olimpike të Ferizajt - Nën organizimin e KOK-ut dhe DKRS-së u bë vendosja e Pemës Olimpike të Ferizajt në hapësirat e Qendrës Universitare në Prishtinë.

Debat mbi ligjin për sponsorizime. Në praninë e një numri të përfaqësuesve të shoqatave kulturore e sportive, DKRS organizoi debat lidhur me mundësinë e shfrytëzimit të ligjit për sponsorizime. Në këtë temë sollën informacione më të hollësishme, Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe zëvendësudrejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Nait Sharku.

Garave virtual për fëmijët e lindur në Ditën e Pavarësisë - Nën organizimin e DKRS dhe KOK-ut u mbajt garave virtual për fëmijët e lindur në Ditën e Pavarësisë, ku nga 27 komuna pjesëmarrëse, Komuna e Ferizajt zuri vendin e pestë në plasmanin e përgjithshëm.

Organizimi i Kuvendeve - DKRS organizoi kuvende themeluese për katër klube të reja të themeluara këtë vit, dhe në tri klube ekzistuese riorganizoi kuvendet zgjedhore me qëllim të zhvillimit të punës sa më efikase në klube sportive, si dhe bëri përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm sipas ligjit në fuqi.

Demonstrimi sportive me grupmoshat e reja - Nën organizimin e DKRS-së dhe KOK-ut u mbajt gara virtual në demonstrimin e sporteve të ndryshme me grupmoshat e reja e që nga Komuna e Ferizajt u paraqitën 120 sportistë të cilët prezantuan vlerat e sportit ferizajas dhe u rreshtuan në vendin e katërt në nivel vendi.

Gara miqësore në Basketbollit me KFOR-in Amerikan -Nën organizimin të DKRS-së u organizua gara në Basketboll me KFOR-in amerikan dhe ekipet e qytetit ku morën pjesë ekipet e basketbollit nga qyteti dhe ushtarët nga Kampi “Bonsteel” ku finalistët u shpërblyen me mirënjohje.

Dita Botërore e Ecjes- DKRS dhe KOK organizoi garën në ecje për Ditën Botërore të Ecjes e cila ishte e organizuar në gjitha Komunat e Kosovës, ku nga 32 komuna pjesëmarrëse në garë, Komuna e Ferizajt zuri vendin e dytë dhe u shpërblye me 150 euro.

DKRS përfundoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin e **Pishinës së mbuluar Gjysmë Olimpike në Ferizaj**,

Turneu memorial në Volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” - Nën organizimin e DKRS dhe KVF “Ferizaj” u mbajt turneu memorial në Volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” ku ishin pjesëmarrës 4 ekipe nga Kosova të cilat treguan një cilësi të lartë të lojës së volejbollit. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa nga organizatori.

Garat shkollore lokale dhe regjionale - Në Pallatin e Sporteve u organizuan garat shkollore lokale dhe regjionale në dy gjinitë ku morën pjesë të gjitha ekipet nga shkollat e Komunes sonë , si dhe ekipet nga Komuna e Shtimes, Lipjanit, Kaçanikut , Shtërpces dhe Hanit të Elezit. Edhe në këtë garë tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa si dhe dy vendet e para fituan të drejtë të marrin pjesë në garën finale që mbahet në Prishtinë.

Turneun memorial ne Pingpong “Ahmet Hoxha” - Klubi i Pingpongut “Ahmet Hoxha” dhe DKRS organizuan turneun memorial ne Pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës dhe shpërbleu tri vendet e para me kupa dhe medalje.

Gara në Automobilizëm - Nën organizimi Federatës së Automobilizmit dhe DKRS-së u mbajt kampionati në Automobilizëm ku morën pjesë një numër i madh i garuesve nga gjitha klubet e Kosovës të cilat zhvilluan garat në disa kategori të ndryshme në të dy gjinitë. Organizatori tri vendet e para i shpërbleu me kupa dhe mirënjohje.

TË ARRITURAT NË SPORT PËR VITIN 2020

KV “Ferizaj” M është Kampion i Kosovës për Seniorë dhe fitues i Kupës së Republikës së Kosovës, edhe në arenën ndërkombëtare kishte një prezantim të denjë në Turqi në Ballkan Cup” i cili tregoi një kualitet të volejbollit kosovar në garat evropiane. Ky klub ka të organizuara mjaft mirë edhe grupmoshat e reja.

KH “Ferizaj” F, është Kampion i Kosovës për seniorë ku gjatë gjithë kohës në të dy stinorët ishte i pakonkurrent dhe me plotë të drejtë është shpallur Kampion, i ka të organizuar mjaft mirë edhe grupmoshat tjera.

K SH. “Ferizaj” është fitues i Kupës së Kosovës dhe pjesëmarrës i shumë garave tjera në nivel të Kosovës.

KPP “Ahmet Hoxha” është fitues i kupave dhe medaleve në kategori të ndryshme, sidomos me grupmosha të reja është edhe fitues i Kupës së Kosovës për kadetë dhe juniorë.

SEKTORI I BIBLIOTEKAVE

Biblioteka punën e filloi në fund të Janarit të vitit 2020, pasi që biblioteka kishte filluar të renovohej në fund të vitit 2019.

Pas përfundimit të punëve në katin e dytë, punën filluam vetëm tek sektori për të rritur dhe sallat e leximit, pasi që në katin e parë pritej renovimi. Biblioteka ndërpreu punën me 13 mars, për shkak të pandemisë të virusit Covid-19, numri i lexuesve dhe puna profesionale në përgjithësi dhe mbajtja e aktiviteteve nuk është si në vitet e kaluara.

Numri i lexuesve deri në Dhjetor është

- Sektori për fëmijë 359 lexues me 2753 libra të lexuara
- Sektori për të rritur 581 lexues e 3224 libra të lexuara

Gjatë kësaj kohe kanë hyrë 708 libra dhe është bërë inventarizimi i tyre.

Natyrisht Sektori i Bibliotekës ishte njëri prej pozitave më të vështira të ndërmarra nga instancat e sigurisë lidhur për mbrojtjen nga virusi Covid 19. Për këtë shkak, Bibliotekat ishin të mbylluara për një kohë të gjatë, sidomos sallat e leximit.

Aktivitetet

U mbajtë promovimi e librit "Shtatë fletore" të autorit martir Havzi Nela. Për veprën dhe jetën e autorit Havzi Nela folën: z. Rexhep Shahu, z. Izet Duraku, z. Skënder Zogaj dhe z. Afrim Demiri. Aktiviteti u mbajt në bashkëpunim me Klubin e poezisë së Tiranës. U shpalosën mijëra vargje të shkruara nga autori Havzi Nela për Ferizajn dhe për Kosovën.

Në kuadër të projektit “Qytetari Digjital”, Biblioteka "Sadik Tafarshiku", ka marr donacion printerin 3D.

Në Ditën e Pavarësisë u mbajtën dy ligjërata nga historianët Majlinda Misini dhe Fatlum Ibrahim. Kumtesat shtjelluan rrugëtimin drejt Pavarësisë Po ashtu, biblioteka i ndau mirënjohje miqve të Bibliotekës znj. Sanie Tahiri, z. Bajram Maloku, z.Amir Rexhepi dhe z.Milaim Tahiri që pasuruan fondin librar të bibliotekës duke

dhuruar librat që kanë poseduar. Po ashtu, në shenjë mirënjohje për bashkëpunim, mirënjohje morën shkollat: Shkolla e Mesme Teknike "Pjetër Bogdani" dhe Shkolla e Mesme e Ulët "Ahmet Hoxha".

U shpallën lexuesit më të mirë për vitin 2019: Dion Durmishi, Artina Siriniqui, Adea Aliu-sektori për fëmijë, Floriana Nuhiu, Donjeta Sylja, Nexhmedin Haxhiu-sektori për të rritur dhe Dibran Osmani, Edon Jakupi, Albina Behluli, lexues të dalluar në sallë të leximit.

Aktiviteti pesë ditor, projekt i përkrahur nga Ministria e Kulturës. Aktiviteti kishte për synim inkuadrimin e fëmijëve-nxënësve minoritar, në jetën kulturore.

Dita e parë: Vizatime; Dita e dytë: Poezi; Dita e tretë: Këshilla shëndetësore nga mjeku Kemajl Emmini; Dita e katërt: Rëndësia e arsimimit dhe emancipimit, nga profesoresha Vita Gashi- Halili; Dita e pestë: Këshilla psikologjike nga psikologjia Habibe Llabjani.

Sistemimi i librave të sektori për fëmijë, pas renovimit të sektorit. Sistemimi u bë me një punë të palodhur nga Fahrije Jashari, Avni Sadiku, Nehat Raçi.

U promovua në Bibliotekë libri i autorit, Jusuf Buxhovi "DARDANIA - ANTIKA, MESJETA"

Në fund të promovimit autori Jusuf Buxhovi i dhuroi bibliotekës librat e botuara nga opusi i tij krijues. Promovimi i mbajtë në bashkëpunim me Klubin e Intelektualëve të qytetit.

10 Nëntor: Poetja Blerina Murtezi, i dhuroi bibliotekës librin e saj të ri "Ëndrrat e mia".

11 Dhjetor - Bibliotekën e vizitoi z. Uran Haziri, vëllai i Heroit të Kosovës, Xhavit Haziri, dhe ia dhuroi Bibliotekës monografinë "Atdhetari i shtigjeve të lirisë Xhavit Haziri" të autorit, Mustafë Krasniqi. Falënderojmë z. Uran Haziri, për dhurimin e librit.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik përfshinë territorin e Komunës së Ferizajt me rrethinë dhe vepron si njësi në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjatë vitit 2020, kjo njësi ka vazhduar punët e mbetura nga viti paraprak, duke i grumbulluar, evidentuar dhe vendosur nëpër rafte dokumentacionin arkivor. Dokumentacioni arkivor që gjendet në arkiv është përpunuar detajisht dhe profesionalisht dhe është vendosur në vendin adekuat sipas numrit dhe llojit të lëndës.

Gjatë vitit 2020 në Arkivin Historik kemi pasur gjithsej 31 qytetarë që i kemi shërbyer me material arkivor dhe dokumentacione personale që ata kanë kërkuar nga ne.

Gjatë këtij viti kemi bërë ndarjen e materialit arkivor në Drejtorinë përkatëse, sipas shenjave dhe numrit të lëndëve, gjithashtu ne jemi në pritje të formimit të komisionit nga Drejtoria e Administratës pasi që edhe me ligj kësaj Drejtorie i takon të formoj një ekip profesional nga sektorët e drejtorive të KKF-së.

Edhe pse në vitin 2015 dhe vitin 2018 është formuar komisioni për asgjësimin e lëndëve, deri më tani nuk është marrë asnjë veprim për asgjësimin e këtyre lëndëve.

Mendojmë që me asgjësimin e këtyre lëndëve të cilat janë për asgjësim, krijojmë një hapësirë më të madhe për sistematizimin e lëndëve tjera, të cilat duhen të vendosen në një vend më të mirë, sepse momentalisht Arkivi Historik është jashtëzakonisht i ngarkuar me lëndë që u ka skaduar afati i ruajtjes dhe duhet të asgjësohen pa humbur kohë.

Gjatë vitit 2020 në kryerjen e punës në Arkivin Historik jemi përcaktuar sipas kësaj veprimtarie:

1. Ndarja dhe përcaktimi i dokumentacionit arkivor dhe lëndës arkivore
2. Klasifikimi i lëndës arkivore në fonde
3. Formimi dhe kompletimi i dosjeve në fonde
4. Sistematizimi i lëndëve arkivore në fonde
5. Mbrojtja teknike

Në tremujorin e parë të vitit 2020 (Janar, Shkurt, Mars)

Ndarja dhe klasifikimi i materialit arkivor në Drejtoritë përkatëse si dhe mbrojtja teknike e këtij materiali.

Në tremujorin e dytë të vitit 2020 (Prill, Maj, Qershor) kompletimi i dosjeve:

1. Përpunimi i fondit, dëmet e shkaktuara nga okupatori serb gjatë luftës 1998-99
2. Përpunim i fondit të pasaportave YU

Në tremujorin e tretë të vitit 2020 (Korrik, Gusht, Shtator) kompletimi i dosjeve:

1. Përpunim i fondit, lista e pagave të bashkësisë lokale të KKF

Në tremujorin e katërt të vitit 2020 (Tetor, Nëntor, Dhjetor) kompletimi i dosjeve:

1. Fondi për mbrojtje dhe siguri viti 1971-1979.

PËRFUNDIM

Në raport nuk janë të përfshira shumë aktivitete të pavarura, ose punë të rëndomta të artistëve, sportistëve dhe të rinjve (prova, aktivitete të lira), si dhe shumë aktivitete që kanë shfrytëzuar objektet publike të DKRS-së.

Një version i këtij raporti, me një format më të zgjeruar dhe ilustrim me fotografi, për referenca të mëtutjeshme, gjendet në arkivat e DKRS-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2020

Bekim Ademi
Drejt看 i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit 2020 është angazhuar që të punojë duke u mbështetur në infrastrukturën ligjore në fuqi respektivisht në kuadër të Konceptit të Mjekësisë Familjare, me qëllim që qytetarëve tanë t’iu mundësojmë një shërbim sa më të mirë të tyre në të dy sektorët, në Sektorin e Shëndetësisë si dhe Sektorin e Mirëqenies Sociale për një mirëqenie sa më të mirë të tyre.

SEKTORI I SHËNDETËSISË

DSHMS respektivisht Sektori i Shëndetësisë ka mbajtur takime zyrtare konsultuese me strukturat udhëheqëse të QMF-së, Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional duke bërë një analizë të përgjithshme të aktiviteteve dhe punëve të vitit paraprak, ku u vlerësua se bazë për përcaktimin e objektivave për vitin 2020 do të jetë buxheti që kemi respektivisht në investimet kapitale duke u fokusuar në objektiva më të domosdoshme në Kujdesin Parësor Shëndetësor në ngritjen e standardeve teknike dhe infrastrukture për punë në rrjetin institucional të QKMF-së me theks të veçantë në institucionet në pjesën rurale, me qëllim ngritjen e performancës në punë, cilësisë së shërbimeve shëndetësore që do të reflektojnë në mirëqenien e qytetarëve tanë.

Objektivat e Sektorit të Shëndetësisë për vitin 2020

- Ngirtja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë (permanente),
- Ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm që do të reflekton në ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe llogaridhënëse,
- Angazhim për realizimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes Komunës së Ferizajt dhe "Caritas Kosova" për rritjen e stafit shëndetësor për ofrim të shërbimeve shëndetësore në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor,
- Implementimi i projekteve kapitale për vitin 2020,
- Ngritja e aktiviteteve dhe e cilësisë së shërbimeve shëndetësore,
- Sensibilizimi për specializime për mjekë familjar për Kujdesin Parësor Shëndetësor,
- Avancimi profesional specifik për mjekët familjar ekzistues,
- Ngritja e aktiviteteve të Njesisë së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor,
- Intensifikimi i aktiviteteve të ZHVP-së,
- Furnizimi me pajisje mjekësore dhe material shpenzues,
- Renovimi, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore,
- Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me bazë në komunitet,
- Promovimi i shëndetit të gruas, fëmijëve dhe grupeve vulnerable,
- Vazhdimi i vizitave sistematike në shkolla dhe çerdhe, analiza e rezultateve dhe marrja e veprimeve për përmirësim,
- Edukimi i stafit për trajtimin e diabetit dhe të shputës diabetike, mbështetja përmes të hyrave vetanake nga participimi për sigurim të insulinës në kontinuitet për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (ngase sipas praktikave të deritanishme jo çdo herë kemi pasur furnizim të rregullt),
- Angazhim në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, qofshin qeveritare apo jo qeveritare, rritja e bashkëpunimit edhe me OJQ-të vendore.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, Sektori i Shëndetësisë vlerëson se nga viti paraprak 2019, bartën shumë sfida dhe jo çdoherë të tejkalueshme edhe përkundër angazhimeve tona permanente.

Një ndër sfidat nga viti paraprak është numri i pakët i personelit shëndetësor karshi nevojave në kujdesin Parësor Shëndetësor dhe me rastin e hapjes së institucioneve të reja shëndetësore, edhe përkundër kërkesave tona të vazhdueshme që të lejohet rritja e numrit të punëtorëve nga Ministria e Shëndetësisë, por fatkeqësisht deri më tani nuk është trajtuar nga niveli qendror, gjë që domosdoshmërisht jemi detyruar të gjejmë alternativa tjera përmes Marrëveshjes së Mirëkuptimit me “Caritas Kosova”, ku me datë 10.09.2020 me angazhimin e kreut komunal arrihet Marrëveshja “Kontratë Publike Kornizë” me kohëzgjatje prej 24 muaj. Kjo marrëveshje është e një rëndësie të veçantë ngase mundëson funksionalizimin e Qendrave Mjekësore dhe AMF-ve në plotësimin e stafit shëndetësor.

Gjatë muajit Mars 2020 me shfaqjen e pandemisë Covid 19, DSHMS është ballafaquar me një situatë mjaft të rëndë duke u ndeshur me shumë sfida dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet për një koordinim të mirëfilltë ndër-institucional, si në nivelin lokal edhe në atë qendror, respektivisht me Qendrën e Mjekësisë Familjare me të gjitha institucionet vartëse të saj, QPS-në, Shtëpinë me Bazë në Komunitet për Personat me Ngecje Mendore, Spitalin Rajonal në Ferizaj, Institutin Kombëtar të Shëndetësisë, ku kemi koordinuar punët për të menaxhuar dhe për të marrë masa preventive në parandalimin e kësaj pandemie.

DSHMS në vazhdimësi është koordinuar edhe me Shtabin Emergjent në nivel komunal për menaxhimin e pandemisë duke marrë veprime konkrete konform institucioneve relevante respektivisht nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Ministria e Shëndetësisë me qëllim që të ndërmerren veprime që do të jenë në interes të qytetarëve tanë.

Gjatë kësaj kohe, shpeshherë jemi ballafaquar edhe me mungesë të barnave esenciale, materialit shpenzues, si dhe mjeteve mbrojtëse kundër pandemisë.

Më pas kemi pasur mbështetje nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga donatorë të ndryshëm ku në mënyrë të detajuar i keni të paraqitura në raportin e Qendrës së Mjekësisë Familjare.

Edhe përkundër rënies së numrit të kohëpaskohshëm të të infektuarve gjatë muajve të verës fatkeqësisht ballafaqohemi me valën e dytë të pandemisë, sikurse në gjithë globin edhe tek ne ka të infektuar, ku i tërë potenciali kadrovik shëndetësor është i angazhuar në ndërmarrjen e të gjitha veprimeve qoftë parandaluese, qoftë në trajtimin e drejtpërdrejt të pacientëve, gjë që ka pamundësuar zhvillimin e shumë aktiviteteve sidomos nga njësia e edukimit dhe promovimit shëndetësor, në realizimin e vizitave sistematike në shkolla dhe çerdhe.

Ne me kohë jemi munduar të marrim veprime për realizimin e investimeve kapitale gjatë muajit Mars dhe Prill pranë Zyrës së Prokurimit, por për shkak të pandemisë nga niveli qendror është marrë vendim për prolongimin e procedimit pranë Zyrës së Prokurimit e të gjitha aktiviteteve procedurale, gjë që na ka pamundësuar në realizimin e disa prej tyre.

- DSHMS çdo herë ka qenë e angazhuar për përfitimin e donacioneve nga donatorët ku falë angazhimit të kreut komunal dhe DSHMS-së është arritur Marrëveshja e Mirëkuptimit mes Komunës së Ferizajt dhe “Qatar Charity” me datë 29.10.2020, ku jemi përfitues të ndërtimit të një Qendre të Mjekësisë Familjare në Softaj, ku kostoja e përgjithshme kap vlerën prej 182,000.00 €, ku 132,000.00 € jepen nga ana e “Qatarit Charity” ndërsa 50,000.00 € nga ana e Komunës së Ferizajt.
- Funksionalizimi i QMF-së Dardani me datë 10.11.2020 si dhe rregullimi i hapësirës së oborrit. Kjo Qendër ofron shërbime shëndetësore për 10.000 banorë që momentalisht kryen shërbime të mjekësisë primare, infermierike dhe asaj stomatologjike dhe jemi duke u angazhuar të bëjmë hapjen e shërbimeve laboratorike.
- Si objektiv kryesor i DSHMS-së gjatë këtij viti ishte edhe fillimi i ndërtimit të Shtëpisë së Pensionistëve, ku me vendim të Kuvendit Komunal 01 nr. 109 i datës 30.09.2019 është bërë

përcaktimi i parcelës për ndërtimin e kësaj shtëpie të pensionistëve, dhe do të jetë angazhimi ynë që ndërtimi i kësaj qendre të jetë me prioritet.

- Sa i përket ndërtimit të QMF-së në Prelez të Muhaxherëve, DSHMS me kohë ka marrë të gjitha vendimet procedurale për implementim të këtij projekti ku dhe nga ana e operatorit kontraktues është bërë hartimi i projektit për këtë qendër, ku pas kërkesës sonë të parashtruar nga DSHMS pranë Kuvendit Komunal, me datën 30.06.2020 01. Nr. 66 është ndarë parcela në ngastrën kadastrale 228-1 Z.K.

Por, megjithatë me datën 29.09.2020 pranuar informatën nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit se ngastra kadastrale 228-1 ZK Prelez i Muhaxherëve është përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025 dhe është destinuar për Afarizëm Tregti-Industri, dhe pas kësaj ne kemi kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të ndërprehen procedurat e prokurimit, dhe vlerësojmë se duhet të ndërmerren veprimet e mëtejme nga organet komunale kompetente në trajtimin e kësaj çështje.

DSHMS në kryerjen e obligimeve dhe detyrave të punës çdo herë është transparente karshi institucioneve relevante lokale dhe qendrore, si dhe ndaj qytetarëve.

Jemi të vetëdijshëm se viti 2020 ishte një vit me shumë sfida sidomos me rastin e shfaqjes së pandemisë që negativisht ndikoi në shumë segmente të jetës shoqërore, gjë që reflektuan drejtpërsëdrejti tek mirëqenia e qytetarëve dhe jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër angazhimeve tona në vazhdimësi në ngritjen e shërbimeve shëndetësore, asnjëherë nuk mund të arrihet e dëshirueshmja, por vlerësojmë se niveli i kënaqshmërisë së pacientëve në ofrim të shërbimeve shëndetësore është i mirë, por asnjëherë nuk do të ketë një performancë të mirëfilltë deri sa na pamundësohet rritja kadrovike e personelit shëndetësor karshi nevojave në institucionet tona të nivelit parësor shëndetësor si dhe mosfurnizimi i mjaftueshëm me barna nga Ministria e Shëndetësisë.

DSHMS çdoherë ka mirëpritur nxjerrjen e ligjit për sigurime shëndetësore që do të jetë në interes shumë të madh të qytetarëve, por fatkeqësisht kjo deri më tani nga niveli qendror çdoherë ka qenë si opsion por asnjëherë i realizueshëm. Shpresojmë se ky ligj do të trajtohet me prioritet për interes të qytetarëve tanë.

DSHMS për punët dhe aktivitete e veta është e përgjegjshme, llogaridhënëse dhe transparente pranë institucioneve në hierarki institucionale në nivel lokal dhe qendror dhe kundrejt qytetarëve tanë.

Në vazhdim të këtij raporti po paraqesim raportin Janar - Dhjetor nga Qendra e Mjekësisë Familjare, ku vlerësojmë se në mënyrë të detajuar janë të paraqitura të gjitha aktivitetet dhe punët që janë kryer në QKMF, QMF dhe AMF.

RAPORT PUNE - QKMF

PËRMBAJTJA

HYRJE	
Aktivitetet dhe takimet.....	
TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së.....	
KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT	
Menaxhimi i situatës së pandemisë me COVID-19.....	
Furnizimi me pajisje mjekësore mbrojtëse nga MSH dhe donacionet	
KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE	
Zyra e Kryeinfermierit	
KOMITETI PËR NGRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE	
Zyra për sigurimin e cilësisë në punë	
I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE.....	
1. SHËRBIMET MJEKËSORE.....	
2. SHËRBIMET DIAGNOSTIKE.....	
2.1. Njësia e laboratorit	
2.2. Njësia e radiologjisë.....	
3. DISPANZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE.....	
4. SHËRBIMET PREVENTIVE	
4.1. Edukimi shëndetësor	
4.2. Shërbimi i vaksinimit.....	
4.3. Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas	
4.4. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	
5. SHËRBIMET EMERGJENTE	
Shërbimet gjatë pandemisë	
6. KUJDESI SHTËPIAK	
7. KUJDESI SHËNDETËSOR ANTENATAL (KAN)	
8. AMBULANCAT E MJEKËSISË FAMILJARE.....	
9. NJËSIA E FARMACISË	
II. QENDRA TRAJNUESE E MJEKËSISË FAMILJARE	

2.1. Aktivitetet në QTMF.....	
2.2. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional	
2.3. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional Infermieror	
III. SEKTORI I STOMATOLOGJISË	
IV. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	
4.1. ZYRA PËR SHËRBIME JURIDIKE	
4.1.1. Shërbimi i autoambulancave dhe servisimit	
4.1.2. Shërbimi teknik dhe i mirëmbajtjes	
4.2. ZYRA PËR BUXHET DHE FINANCA	
TË ARRITURAT	
SFIDAT	
OBJEKTIVAT	

Shkurtesat

AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare

AMFK - Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës

DAT - Dispanseri Antituberkular

DSHMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

DMF – Departamenti i Mjekësisë Familjare

EVP - Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

KAN – Kujdesi Antenatal

KD – Këshilli Drejtues

KP – Këshilli Profesional

KPSH – Kujdesi Primar Shëndetësor

MSH - Ministria e Shëndetësisë

OBSh - Organizata Botërore e Shëndetësisë

OIK - Oda e Infermierëve të Kosovës

QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2020 me angazhimet e nevojshme për përmbushjen e obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të vitit, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të, për të vazhduar më tej me synim të intensifikimit. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së rekomandimeve të paracaktuara për vitin 2020, të cilat janë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në Kujdesin Primar Shëndetësor (KPSH)
3. Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH
4. Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)
5. Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve
6. Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) të Komunës sonë.

Mirëpo, me shpalljen e pandemisë COVID-19 në nivel global edhe për menaxhmentin dhe personelin e QKMF-së u bë prioritet parandalimi i përhapjes së virusit duke i respektuar masat mbrojtëse dhe rekomandimet e Qeverisë dhe IKSHPK-së, si dhe ofrimi i ndihmës profesionale për personat e infektuar.

Aktivitetet dhe takimet

- **Më 24.01.2020** - organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, në QZHEMF u mbajt takimi i drejtorëve të QKMF-ve të të gjitha Komunave të Kosovës, ku veç tjerash janë dhënë udhëzime rreth plotësimit të tabelave për grantin specifik të vitit 2020. Personeli i Departamentit të Administratës në QKMF është angazhuar në grumbullimin e të dhënave dhe plotësimin e tabelave sipas kriterëve të kërkuara.

- Sipas propozimeve nga Komiteti për Monitorimin e sëmundjeve ngjitëse (IKSHP) në QKMF në muajin Shkurt janë marrë masat e duhura që pacientët me grip sezonal të ndahen nga të tjerët, sidomos në dhomat e infuzioneve.

- **Më 14.03.2020** - në QKMF u mbajt takimi në të cilin u formua Shtabi Emergjent, si dhe Ekipi Profesional me profesionistë nga të gjitha institucionet shëndetësore publike të Ferizajt. Shtabi Emergjent mbajti takim më 16.03.2020 dhe u vendos që:

- Objekti i SHEP dhe tenda e vendosur në oborr, të dedikohen për rastet e dyshuara me COVID-19.
- Të formohet Ekipi Mobil Emergjent për rastet e dyshimta me COVID-19, për të kryer vizitat mjekësore nëpër shtëpia dhe referimin ose transportin e tyre në Klinikën Infektive.
- Ekipet nga QKMF të vazhdojnë të dërgohen në pikën kufitare të Hanit të Elezit.
- Të bëhet riorganizimi i punës në QKMF në bashkërendim me rekomandimet e MSH dhe IKSHPK.
- Të rekomandohen masa të tjera mbrojtëse për ndërmarrjet publike dhe private.
- Nga MSH ka arritur vendimi që prej 16.03.2020 të ndërpriten vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë, si dhe të ndërpritet vaksinimi i fëmijëve. Ky vendim ka qenë në fuqi deri në fillim të

muajit Qershor, kur MSH ka marrë vendimin tjetër për lehtësimin e masave mbrojtëse, meqë situata epidemiologjike është përmirësuar.

- Në QKMF janë zbatuar edhe një sërë rekomandimesh nga MSH siç është *Qarkorja për informim për institucionet publike dhe private 04/2020*.

- **Më 19.03.2020** - inspektorët nga MSH kanë bërë inspektimin në QKMF dhe SHEP për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna përmes Qarkores Informative me nr. 04/2020, rekomandime këto të cilat janë zbatuar. Nga inspektorët u dha rekomandim që përpos ekipeve në vijë të parë të kujdesit edhe stafi tjetër të përdorë kapela higjienike dhe kalaqe (ose zëvendësim të tyre). Të vendosen para hyrjes shtroja me dezinfektues të lëngshëm për dezinfektimin e këpucëve, gjë që është zbatuar në të gjitha institucionet tona.

- Gjatë kësaj periudhe në QKMF janë zbatuar edhe një sërë rekomandimesh nga Ministria e Shëndetësisë, të dala nga *Qarkorja për informim për institucionet publike dhe private 04/2020* dhe *Vendimi* i datës 20.03.2020 (nr. 05-1519), në mbështetje të të cilave është urdhëruar që në Shërbimin e Shëndetit Oral të punohet vetëm për raste urgjente (për menaxhimin e dhimbjeve) dhe janë ndërmarrë masa të reja të sigurisë si në vazhdim:

- Dezinfektimi i hapësirave të punës në QKMF
- Dezinfektimi i autoambulancave
- Sigurimi i pajisjeve mbrojtëse për personelin
- Reduktimi i referimit të pacientëve në Shërbimin Diagnostik
- Angazhimi i ekipit të dytë në Han të Elezit,
- Dezinfektimi i autoambulancave dhe veturave të tjera të QKMF-së.

Duke u mbështetur në vendimet e Shtabit Emergjent në QKMF është vendosur që:

- Të ndërpritet kujdestaria e natës në QMF 2
- Ekipet në SHEP të pajisen me mjete mbrojtëse
- Nëpër çdo njësi në hyrje të jetë një infermiere që të bëjë triazhimin e pacientëve
- Infermieret në hyrje të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse
- Nëpër njësi të bëhet riorganizimi i stafit
- Të formohen ekipe mobile për vizita në shtëpi.

Gjatë gjithë pandemisë, QKMF e vizituan Kryetari i Komunës, lider politik dhe institucional të nivelit qendror dhe lokal si dhe drejtues të forcave politike në vend, për të përgëzuar dhe inkurajuar stafin shëndetësor në betejën e tyre të përditshme me të panjohurat e këtij virusi.

- **Më 12.05.2020** - në QKMF u shënuar Dita Botërore e Infermierisë, manifestim ky i organizuar jashtëzakonisht mirë, edhe pse në kohë pandemie. Përveç personelit të QKMF-së, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës z. Agim Aliu, Drejtori i DSHMS-së z. Bekim Ademi dhe anëtarët e tjerë të Shtabit Emergjent Lokal.

- **Më 14.05.2020** nga Inspektorët e Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës u bë inspektimi në QKMF, në katin e parë (Departamentin e Mjekësisë Familjare) dhe në katin e dytë, në Sektorin e Stomatologjisë. U inspektua në lidhje me zbatimin e Qarkores Informative me numër 04/20 dhe asaj me numër 05/1419 të datës 16.03.2020, u dhanë rekomandimet për të vazhduar me zbatimin e qarkoreve të lartpërmendura. Të njëjtën

ditë kanë inspektuar edhe QMF 7 në fshatin Neredime, ku si rekomandim kanë dhënë ndarjen e dhomave të izoluar për raste të dyshimta, e që është caktuar pastaj nga personeli i kësaj qendre.

- **Më 20.05.2020** një takim është mbajtur në sallën e Komunës dhe aty janë pritur në takim zëvendësministrat e tri ministrave: z. Izet Sadiku zëvendësministër i MSH, znj. Fatbardha Emini - zëvendësministre në Ministrinë e Administratës Publike dhe z. Bajram Gecaj - zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Kryetari i komunës, z. Agim Aliu, si kryesues i Shtabit Emergjent Lokal i njoftoi mysafirët për menaxhimin e situatës dhe masat që janë në ndërmarrë në Komunën tonë me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit me COVID 19.

- **Më 06.07.2020** - Për shkak të rritjes së numrit të rasteve të dyshuara me Covid-19, me kërkesën tonë, është sjellë dhe është montuar tenda nga FSK, në oborrin e QKMF-së me qëllim që të pengohet kontakti i rasteve të dyshuara me pacientët e tjerë.

- **Më 22.07.2020** - u aktivizua edhe Qendra e Thirrjeve (monitorimit) të personave të dyshuar dhe të infektuar me COVID-19, përmes së cilës këta persona në mënyrë të vazhdueshme do të jenë nën përkujdesjen e mjekëve dhe infermierëve e QKMF-së. Nga qendra e thirrjeve do të monitorohet gjendja e pacientëve në terren (shtëpi), do të jepen këshilla mjekësore, ndërsa në rastet kur gjendja shëndetësore e pacientëve është e përkeqësuar do të bëhen vizita në shtëpi nga ekipi mjekësor për Covid.

- **Më 24.07.2020** – Menaxhmenti i QKMF-së bashkë me Drejtorin e DSHMS-së vizituan personat me prapambetje mendore të Shtëpisë Integruese në Komunitet, si kategori e rrezikuar nga infeksioni me ç'rast nga ekipi mjekësor atyre iu bënë edhe vizita mjekësore.

- **Më 12.08.2020** - përfaqësuesit e KFOR-it Amerikan, rreshterët Francesco Herrera dhe Shelby Donivin me ekipin e tyre ushtarak kanë vizituar QKMF-në për t'u njohur me situatën aktuale. Përfaqësuesit e KFOR-it u interesuan detajisht rreth kapaciteteve tona në përballimin e kësaj shtate, numrin e të infektuarve, furnizimin me pajisje mbrojtëse dhe barna etj. Ne i njoftuam përfaqësuesit e KFOR-it rreth menaxhimit të situatës dhe sfidave me të cilat po përballen punëtorët shëndetësor dhe pacientët gjatë kësaj periudhe.

- **Më 15.09.2020** - Drejtues të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj dhe Drejtorisë së Arsimit, kanë shpërndarë nëpër shkolla pajisje mbrojtëse dhe preparate dezinfektimi, me qëllim të mbrojtjes së personelit dhe nxënësve nga përhapja e virusit COVID-19. Kontingjenti i pajisjeve dhe preparateve të shpërndara është siguruar nga niveli qendror, Zyra e zëvendës-kryeministrit, z. Besnik Tahiri, nga donacioni i ardhur prej Jordanisë.

- **Më 02.10.2020** - janë njoftuar qytetarët e Ferizajt se gjatë muajit Tetor, muaj i ndërgjegjësimit kundër sëmundjes së kancerit të gjirit, QKMF ofron falas shërbimet për ekzaminimin e gjirit me aparatën e mamografisë dhe janë ftuar gratë mbi moshën 40 vjeçare, të paraqiten për të marrë këtë shërbim në QKMF.

- **Më 13.10.2020** - u përurua shërbimi për testimin tremujor të hemoglobinës së glikogjenizuar për fëmijët me diabet (insulinëmarrës).

- **Më 05.10.2020** - Shërbimi i vaksinimit të QKMF-së me dy ekipe të terrenit, ka filluar vaksinimin e nxënësve të klasave të VI-ta dhe të I-ra në shkollat fillore të qytetit (9 shkolla) dhe të fshatrave (42 shkolla), me vaksina të rregullta dhe obligative për këto grupmosha, sipas kalendarit të OBSH-së.

- **Prej 05 deri më 06.11.202** - Për shkak të situatës epidemiologjike përmes platformës online u mbajtën ligjëratat të cilat ishin paraparë të mbaheshin me planprogramin e Qendrës së Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional për vitin 2020. Të organizuara nga kryeinfemieri i QKMF-së në bashkëpunim me koordinatoren e QZHVP-së dhe një grup infermierësh u mbajtën 10 ligjëratat me tema të ndryshme që u ndoqën nga 103 infermierë të QKMF-së të profileve të ndryshme.

- **Më 10.11.2020** - U hap QMF në Dardani të Ferizajt ku përveç shërbimeve të mjekut familjar, do të ofrohen edhe shërbime stomatologjike dhe së shpejti, me sigurimin e aparaturave, do të ofrohen edhe shërbime laboratorike për afro 10 mijë banorë të Dardanisë dhe fshatrave përreth.

- **Më 13.11.2020** - është mbajtur trajnimi virtual i organizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së, z. Adrian Mehmetaj, me temën: Trajnimi i stafit shëndetësor në parandalimin dhe kontrollin e infeksionit sipas protokolleve të aprovuara nga MSH. Ky trajnimi është mbajtur në kuadër të komponentit katër - Reagimi emergjent ndaj COVID-19 të projektit të shëndetësisë kosovare të financuar nga huamarrja e Bankës Botërore dhe i është dedikuar stafit mbështetës mjekësor dhe operacional, për ofrimin e përkrahjes për luftimin e pandemisë COVID-19 në institucionet e Kosovës, si dhe për stafin administrativ, përgjegjësit e resurseve njerëzore të institucioneve shëndetësore, qeverisëse dhe rregullatore.

- **Më 14.11.2020** - Shtabi Emergjent Lokal, mblodhi drejtuesit e institucioneve shëndetësore, komunale e të sigurisë me qëllim të shqyrtimit të situatës së krijuar pas rritjes së numrit të rasteve me COVID-19 në Ferizaj. Në këtë takim u vendos për zgjerimin e hapësirave të reja spitalore me qëllim të përballimit të fluksit të të infektuarve që kanë nevojë për trajtim shëndetësor. Në këto rrethana Shtabi Emergjent Lokal mori vendim që: QMF në Neredime të shërbej si hapësirë spitalore për pacientët e infektuar dhe të dyshuar me COVID-19, duke shtuar kapacitetin edhe të 50 shtretërve për trajtimin e pacientëve;

- **Më 16.11.2020** - Në të gjitha QMF-të e qytetit u shënua 14 Nëntori, Dita Botërore e Diabetit, me ç'rast pacientët që frekuentuan këto qendra patën mundësi të bëjnë matjen e glikemisë. Po atë ditë filloi furnizimi i fëmijëve me diabet të Komunës së Ferizajt me shirita për matjen e glikemisë, çdonjëri prej tyre do të marrë nga 50 shirita për një muaj.

- **Më 20.11.2020** - për nder të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve u mbajt konferenca, ku ka marrë pjesë drejtoresha e QKMF-së, konferencë kjo që për shkak të rrethanave të pandemisë u organizua në mënyrë virtuale. Qëllimi i kësaj konference të organizuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ishte prezantimi i rezultateve të Anketës së Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2020. Anketa MICS ka bërë një përmbledhje të situatës së fëmijëve që jetojnë në Kosovë, duke përfshirë të dhënat kryesore për shëndetin, arsimimin, mbrojtjen dhe mirëqenien e tyre. Si një nga anketat më të mëdha ekonomike në mbarë botën, anketa MICS mbështetet nga UNICEF-i që nga viti 1990 dhe është hartuar për të siguruar vlerësime statistikisht të sakta dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht të rreth 200 treguesve kryesore që përdoren për të vlerësuar dhe monitoruar situatën e fëmijëve, të rinjve, grave dhe burrave.

- **Më 30.11.2020** - Shërbimi i Vaksinit në Ferizaj është furnizuar fillimisht me 6000 doza të vaksinës kundër gripit sezonal, ndërsa pas disa ditësh edhe me 1700 të tjera, pra gjithsej 7700 vakcina. Kjo sasi e vaksinave është shpërndarë në të gjitha qendrat dhe ambulancat (QMF 1, QMF 2, QMF 4, QMF 3-Greme, QMF-Dardani, AMF-Softaj, AMF-Drajkovc, AMF-Gaçkë). Me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksionit me Coronavirus dhe për të mos shkaktuar grumbullim të madh të qytetarëve, javën e parë u është dhënë prioritet të moshuarve, mbi 65 vjet, për t'u vaksinuar, ndërsa gjatë javës së dytë janë vaksinuar qytetarët me sëmundjet kronike. Për t'u shmangur kontakteve me pacientë të tjerë, vaksinimi kundër gripit sezonal është bërë në Qendrën e Shëndetit Mendor.

- **Prej 16 deri më 18.12.2020** - është bërë vaksinimi i fëmijëve të komunitetit RAE që kanë mbetur pa u vaksinuar, për shkak të mospërgjigjes ndaj thirrjeve të Shërbimit të Vaksinit të QKMF-së. Kjo fushatë e vaksinimit u organizua nga Kompania "Ballkan Sunflowers Kosova" dhe personeli i Shërbimit të Vaksinit në QKMF.

- **Më 24.12.2020** - me ftesën nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtoresha e QKMF-së bashkë me Drejtorin e DSHMS-së, u takuan me Shefen e Divizionit të KPSH-së, Dr. Albana Morina dhe me këshilltaren e Ministrit Armend Zemaj. Qëllimi i këtij takimi ishte sigurimi i hapësirave të përkohshme në KPSH (Ferizaj) për të funksionalizuar Poliklinikën Stomatologjike, e cila do të jetë në kuadër të kujdesit dytësor. Nga QKMF janë dy specialistë të stomatologjisë, kirurgu oral dhe specialistja e sëmundjeve të gojës, të cilët pastaj do të kalojnë në poliklinikën stomatologjike.

- **Më 30.12.2020** - u mbajt takimi përmbyllës i vitit 2020 në formë virtuale, i cili u ndoq nga rreth 100 pjesëmarrës. Përveç fjalëve përshëndetëse, gjatë takimit u dha një raport i përmbledhur i punës në QKMF

gjatë periudhës Janar-Nëntor dhe aktivitetet e shërbimit infermieror. Në pjesën e dytë takimit u ndanë mirënjohje për ekipet që kanë qenë të mobilizuara në luftën kundër pandemisë COVID 19. Dorëzimi i mirënjohjeve për të gjitha këto ekipe u përcoll përmes linjës së drejtpërdrejtë, ndërsa në fund të takimit nga Koordinatorja e ZHVP-së, ndau certifikatat për trajnimet e mbajtura për mjekë gjatë muajve Tetor dhe Nëntor, ndërsa Koordinator i ZHVP-së për infermierë i ndau mirënjohjet për trajnimet e mbajtura gjatë muajve Tetor dhe Nëntor për stafin infermieror.

- **Më 31.12.2020** - Kryetari i Komunës dhe Drejtori i DSHMS-së vizituan QKMF-në me qëllim të falënderimit të mantelbardhëve për angazhimin dhe përpjekjet që kanë bërë gjatë tërë vitit, në luftë me pandeminë Covid-19. Kryetari nderoi me mirënjohje personelin e QKMF-së dhe shpërndau kartolina për punëtorët. Ndërsa menaxhmenti i QKMF-së, në shenjë nderimi për gatishmërinë që tregoi qeverisja lokale në përmbushjen e nevojave të shëndetësisë gjatë këtij viti, u dhuroi kryetarit Aliu dhe drejtorit Ademi nga një mirënjohje.

Gjatë *periudhës Janar-Dhjetor* numri i përgjithshëm i shërbimeve mjekësore dhe infermierike në QKMF është **666 209**, nga të cilat **169 238** janë vizita mjekësore, **464 145** shërbime infermierike dhe shërbime të tjera, **32 826** janë shërbime stomatologjike.

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë **vitet 2020** ka mbajtur 27 mbledhje, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, të cilat pas aprovimit janë protokolluar dhe ruhen në arkiv. Në këto mbledhje u shqyrtuan çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e procesit të punës në QKMF:

- Në momentin që nga OBSH-ja, infektimi me koronavirus është shpallur gjendje globale, në QKMF janë ndërmarrë rekomandimet nga IKSHPK dhe MSH, janë shpërndarë fletushkat dhe posterët me qëllim të informimit të qytetarëve lidhur me masat për mbrojtje nga infeksioni me COVID-19. Hapat e tjerë, të paraqitur më lartë, janë ndërmarrë në përputhje me *Qarkoret* dhe *Vendimet* e Ministrisë së Shëndetësisë. Edhe pse gjatë kësaj periudhe, si për të gjitha institucionet shëndetësore në vend edhe për QKMF-në në Ferizaj, çështja e pandemisë ka qenë prioritare megjithatë, ndërkohë janë zhvilluar edhe disa procese të inicuar më herët. Disa nga vendimet dhe angazhimet tjera të Këshillit Drejtues do të paraqiten në vazhdim:

- Me iniciativën e Drejtorit të DSHMS-së, Këshilli Drejtues ka marrë vendim që të përshpejtohen procedurat e evidentimit të pacientëve insulinmarrës nën moshën 18 vjeçare dhe të sigurohen reagensët për analizën e hemoglobinës së glikogjenizuar, në mënyrë që t'u mundësohet pacientëve të kësaj kategorie të bëjnë çdo tre muaj këtë analizë. Ky projekt ka arritur të jetësohet në tremujorin e fundit të vitit dhe përveç analizës së përmendur fëmijëve me diabet u janë siguruar edhe shiritat për matjen e glikemisë.

- Është bërë iniciimi i tenderëve për furnizim me material shpenzues, higjienik, pajisje mjekësore, servisim të pajisjeve të RTG-së dhe pajisjeve të stomatologjisë, për plotësimin e nevojave për kuadro profesionale, për ndërtimin e objekteve të QMF në Softaj dhe Prelez, për kamera dhe kartela digjitale, për material mjekësor, uniforma, terapi ampulare dhe për furnizim me pajisje mbrojtëse anticovid.

- Për shkak të pensionimit, pushimit pa pagesë dhe pushimit të lehonisë së disa punëtorëve, janë shpallur konkurse për plotësimin e vendeve të punës.

Në konkursin e shpallur më 05.06.2020 janë kërkuar:

- a) 4 (katër) mjekë familjarë, specializantë të MF ose mjekë të përgjithshëm
- b) 1 (një) laborant të biokimisë dhe

c) 1 (një) shtëpiak

Në konkursin e shpallur më 07.08.2020 janë kërkuar:

a) 3 (tre) mjekë familjarë, specializantë të MF ose mjekë të përgjithshëm

- Këshilli Drejtues ka shqyrtuar edhe kërkesat e ndryshme që kanë arritur në emër të tij, nga të cilat do të përmenden disa kërkesa të Spitalit të Përgjithshëm, pas shfaqjes së pandemisë, përmes të cilave është kërkuar lirim i hapësirave të punës (QMF 1 dhe SHEP), është kërkuar ndihmë me infermierë për shkak të infektimit dhe vetizolimit të një numri të madh të punëtorëve të tyre, mbështetje me terapi dhe oksigjen etj. Kërkesat e tyre që kemi pasur mundësi i kemi plotësuar. Në muajin Korrik u kemi liruar objektin e Shërbimit Emergjent Primar dhe katin përdhës të QMF 1 (me përjashtim të barnatores, dhomës së injeksioneve, infuzioneve dhe lidhtores) për ta vendosur Repartin e Gjinekologjisë. Megjithatë, pas reduktimit të numrit të rasteve këto hapësira na janë liruar, me shfaqjen e valës së dytë në fillim të muajit Nëntor, sërish objekti i SHEP-së i është liruar Spitalit.

- Kërkesë tjetër e shqyrtuar në Këshillin Drejtues që duhet përmendur është edhe kërkesa e personelit të Shërbimit Emergjent Primar, kërkesë kjo me nënshkrimet e tyre për rritjen e koeficientit për 0.6. Shërbimet Emergjente Primare në komunat e tjera e kanë rregulluar këtë koeficient sipas Kontratës Kolektive Sektoriale me të cilën është paraparë ky koeficient në bazë të rrezikshmërisë në punë në emergjencë, urgjencë, kujdesin intensiv (neni 9 pika 1.1). Duke u mbështetur në këto fakte dhe në shtatë arsyetimet mbi rrezikshmërinë në punë të këtyre punëtorëve, të përfshira në kërkesë, Këshilli Drejtues vendosi që kërkesa e tyre të plotësohet dhe 13 infermierëve të SHEP t'u rritet koeficienti nga 4.8 në 5.4.

- Në Këshillin Drejtues është diskutuar për menaxhimin e situatës epidemike me COVID-19 nga 25 Qershori kur ka filluar zbatimi i konkluzës, Nr.1 e dalë nga takimi i Komitetit të SHSKUK-së për menaxhim e situatës si dhe mbrojtjes nga infeksioni.

- Raporti i inspektimit i datës 20.07.2020 nga Inspektoratit Shëndetësor u shqyrtua gjithashtu nga Këshilli Drejtues. Në këtë raport janë paraqitur gjetjet gjatë inspektimit në QKMF lidhur me zbatimin e manualit për mbrojtje nga COVID-19 dhe zbatimin e kornizës nr.1 nga takimi i Komitetit të SHSKUK-së për menaxhimin e situatës me COVID-19. Janë dhënë rekomandime që të vazhdohet me zbatimin e tyre.

- Pas arritjes së raporteve tematike nga vizita e Inspektoratit Shëndetësor më 11.08.2020 në QKMF dhe më 04.09.20 në QMF 4, ato janë shqyrtuar në Këshillin Drejtues. Raportet nuk kanë pasur vërejtje, por janë dhënë rekomandime që të vazhdohet të punohet duke zbatuar manualin për sëmundjet e ngjashme me COVID-19, respektivisht udhëzuesi dhe procedurat standarde të operimit, rekomandimet për diagnostikim të rasteve me COVID-19 nga mjekët familjarë në QKMF.

- Raporti tematik i inspektimit i datës 23.10.2020, u shqyrtua në mbledhjen e Këshillit Drejtues më 05.11.2020, me ç'rast janë paraqitur gjetjet gjatë inspektimit në QKMF të bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L125, Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor Nr. 02/L-38, Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës Nr. 07/L-006 dhe Vendimin për masat e përgjithshme për mbrojtjen nga pandemia Covid-19 Nr. 661/IX/2020 të datës 25/09/2020. Në rekomandimet e këtij raporti udhëzohet vazhdimi i respektimit të ligjit dhe vendimeve të lartpërmendura.

- Në mbledhjen e datës 11 Dhjetor është vendosur që të njoftohen shefat e njësive për vlerësimin e performancës së punëtorëve dhe formularët të përcillen në secilën njësi. Evaluimi do të bëhet për performancën e punëtorëve gjatë tërë vitit 2020, duke filluar nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor.

- Në mbledhjen e datës 23.12.2020 është diskutuar vendimi 01/51 i Qeverisë së Kosovës për masat e përgjithshme dhe specifike mbrojtëse nga pandemia Covid - 19.

- *Plani për sigurimin dhe mbrojtjen e objekteve të QKMF-së* u bë në mbledhjen e mbajtur më 31.12.2020.

- Që nga shfaqja e rasteve me Covid-19 brenda personelit të QKMF - së, në mbledhjet e Këshillit Drejtues është diskutuar edhe lidhur me gjendjen shëndetësore të punëtorëve të prekur.

Menaxhimi i situatës së pandemisë me COVID-19

Nga fillimi i Pandemisë Covid-19, që nga muaji Mars në mbledhjet e Këshillit Drejtues, Këshillit Profesional, si dhe në takimet me stafin mjekësor nëpër njësi, temë kryesore ka qenë menaxhimi i situatës së krijuar me Corona-virus duke u bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, rekomandimet e MSH, Qarkoret Informativë, si dhe vendimet e Shtabit Emergjent Lokal.

Menaxhimin e situatës epidemiologjike nga menaxhmenti dhe personeli i QKMF-së mund ta cilësojmë të mirë menaxhueshme, falë angazhimit të madh të të gjithëve e në veçanti të ekipeve mjekësore të cilët u kanë ofruar shërbime mjekësore rasteve të dyshuara me Corona-virus në QKMF, në vizita shtëpiake dhe në pikën kufitare në Han të Elezit.

Nga 26 Qershori kemi filluar me zbatimin e konkluzës nr.1 nga takimi i Komitetit të SHSKUK-së për menaxhimin e situatës si dhe manualit për mbrojtje nga infeksioni. Ndërsa nga data 8 Gusht nga Ministria e Shëndetësisë kemi pranuar Udhërrëfyesin Klinik Nr. 9 për Menaxhimin dhe Trajtimin e COVID-19, sipas të cilit secili mjek është i obliguar t'i trajtojë rastet me simptoma të dyshuara dhe ato pozitive.

Në fillim të muajit Korrik në KPSH ka pasur numër të shtuar të rasteve të dyshuara dhe ato pozitive, me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të tyre, nga Ministria Shëndetësisë është siguruar tenda pas kërkesës sonë, ndërsa gjatë muajit Shtator kemi pasur rënie të rasteve të tilla.

Me shfaqjen e valës së dytë të pandemisë, në fillim të muajit Nëntor, sërish janë marrë të gjitha masat për menaxhimin e situatës në mbështetje të vendimeve të dala nga Shtabi Emergjent Lokal, duke respektuar Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës Nr. 07/L-006, vendimet e Qeverisë për masat e përgjithshme për mbrojtjen nga pandemia dhe rekomandimet e IKSHPK.

Pandemia Covid-19 ka prekur edhe personelin e QKMF-së; nga stafi i rregullt 44 punëtorë janë diagnostifikuar me testin PCR dhe 12 me testin serologjik, ndërsa nga stafi i angazhuar përmes Caritasit me Covid-19 janë diagnostifikuar 21 punëtorë. Nga gjithsej 77 punëtorë të diagnostifikuar me Covid -19, në fund të vitit 4 prej tyre kanë qenë aktiv, por në gjendje stabile. Fatmirësisht, asnjë nga punëtorët e infektuar nuk kanë pasur ndonjë komplikim dhe e kanë tejkaluar pa pasoja.

Furnizimi me pajisje mjekësore mbrojtëse nga MSH dhe donacionet

QKMF gjatë këtij viti është furnizuar në vazhdimësi me pajisje personale mbrojtëse mjekësore dhe mjete higjienike për dezinfektim nga Ministria e Shëndetësisë. Këto furnizime përfshijnë: maska FFP2, maska kirurgjike, dorëza sterile dhe jo sterile, rroba mbrojtëse, mburoja për fytyrë, syza mbrojtëse etj. Vlen të theksohet se edhe në periudhën pasuese nga Depoja Qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë kemi pasur

furnizim të kënaqshëm me pajisje mbrojtëse mjekësore dhe dezinfektues për duar. Këto furnizime, që janë paraqitur më gjerësisht në raportin e Njesisë së Farmacisë, e kanë zbutur situatën dhe nevojat për mjete dezinfektuese dhe pajisje mbrojtëse.

Mirëpo, krahas furnizimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe donatorëve që kanë sjellë materiale dhe pajisje mbrojtëse në Barnatoren Qendrore të QKMF-së, në këtë drejtim kanë kontribuar edhe donatorë të tjerë:

- Më 03.04.2020 - Asambleisti Lulzim Grainca 85 racione për punëtorë
- Prej 27.03.2020 Pronari i Plus Market ka filluar ofrimin e shujtave për punëtorët e QMF 4 çdo ditë dhe është duke vazhduar ende.
- Më 10.04.2020 - Kompania e ujit "Miro" dhuroi 1000 shishe të vogla ujë
- Më 24.08.2020 - ka përfunduar projekti i hapjes së puseve për furnizim me ujë, donacion nga Organizata "Qatar Charity" nga Katari, me seli në Prishtinë ka ofruar dhuratë për QKMF-në, hapjen e puseve për furnizim me ujë. Hapja e puseve është bërë në QKMF dhe QMF 7 – Neredime, ndërsa është premtuar që një pus do të hapet edhe në QMF 1; qendra këto që herë pas here janë përballur me mungesën e ujit.
- Më 16.12.2020 - në QKMF arriti një kontigjent me material higjienik, donacion nga UNICEF-i, me qëllim të plotësimit të nevojave të shtuara gjatë pandemisë COVID-19. Ky material ishte i destinuar për katër QMF-të e qytetit dhe QMF-të në Greme, Komogllavë dhe Pleshinë.

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE

Detyrat dhe aktivitetet e Këshilli Profesional gjatë kësaj periudhe kanë qenë të lidhura ngushtë me situatën epidemiologjike dhe pandeminë COVID-19. Përkundër situatës së rënduar Këshilli Profesional gjatë **vitet 2020** ka mbajtur 7 takime, në të cilat ka raportuar secili përgjegjës për njësinë e vet dhe janë diskutuar edhe çështje të ndryshme profesionale si:

- Menaxhimi i situatës epidemiologjike me COVID-19
- Formimi i ekipeve për vizita shtëpiake për pacientët e dyshuar dhe COVID-19 pozitiv
- Përmbledhje e menaxhimit të situatës epidemiologjike gjatë muajve Korrik-Gusht 2020
- Diskutimi rreth projektit të objektit të ri të QKMF-së
- Përdorimi i Udhërrëfyesve Klinik për menaxhimin dhe trajtimin e COVID-19 nga ana e mjekëve familjar
- Njoftimi për Qarkoren Informative 01/2020 nga M.SH.
- Përpilimi i orarit për kujdestaritë e të dielave dhe festave
- Sistemimi i mjekëve të rinj nëpër njësi për përfundimin e praktikës profesionale që parashihet nga Ministria e Shëndetësisë.
- Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së,
- Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me përgjegjësit e njësive
- Vazhdimi i trajnimeve në QZHVP dhe online për stafin mjekësor,

Nga pikat e lartcekura mund të ndalemi pak më gjerësisht te menaxhimi i situatës epidemiologjike me COVID-19. Duhet të theksohet se i gjithë kapaciteti gjatë kësaj periudhe ka qenë i orientuar në organizimin e punës në mënyrë sa ma të mirë dhe sa ma funksionale, në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për popullatën, si për ata që kanë qenë të dyshuar apo me COVID-19, po ashtu edhe për të tjerët me sëmundje akute dhe kronike. Për këtë qëllim janë formuar ekipet mobile për vizita në shtëpi për personat e dyshuar apo COVID-19 pozitiv, është formuar Qendra e Thirrjeve e cila ka bërë një punë të jashtëzakonshme me telefonatat, interesimin për gjendjen e këtyre pacientëve, duke u dhënë këshilla si dhe, në rast përkeqësimit të gjendjes, duke u dërguar ekipin për vizitë në shtëpi.

Zyra e Kryeinfermierit

Shërbimet Infermierike në QKMF përbëjnë mbi 70% të volumit të përgjithshëm të punës në këtë institucion, prandaj edhe kërkojnë një menaxhim dhe përkushtim të veçantë. Qysh në fillim të vitit është bërë plani i punës për vitin 2020 në të cilin janë evidentuar ngecjet dhe janë vënë prioritetet në infermieri për vitin 2020, prej të cilave po i paraqesim disa në vazhdim:

- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional dhe trajnimet e stafit infermieror me qëllim të përdorimit të metodave të reja të punës që aplikohen nëpër vende të zhvilluara, që është objektiv edhe gjatë këtij viti.
- Një trajnim një javor të certifikuar dhe të akredituar për stafin e kujdesit shtëpiak për persona të palëvizshëm dhe me sëmundje kronike, si dhe për stafin infermieror të Emergjencës Primare pasi që nga viti 2010 nuk kanë pasur një trajnim të certifikuar.
- Fuqizimi dhe avancimi edhe më tej i shërbimit të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë duke shtuar numrin e ekipeve edhe nga një ekip për secilën qendër.
- Kujdesi shtëpiak për persona të palëvizshëm dhe të moshuar- aktivizimi i shërbimeve edhe në orarin e pasdites.
- Aktivizimi i një triazhe të avancuar me tri ngjyrat ndërkombëtare të triazhës (të kuqe-emergjente, të verdhë-urgjente dhe të blertë-jo urgjente), ku pacientët do të marrin shërbimet varësisht nga shkalla e rëndë e rastit. Në kujdestarinë e natës në emergjencë kjo është përgatitur më herët, por për mungesë të stafit dhe tash së fundi për shkak të meremetimeve pikërisht në atë pjesë ku mendohet të zbatohet triazhimi, është pamundësuar implementimi, edhe pse parashihej të filloj nga 3 Janari 2020.
- Përmirësimi i furnizimit me barna dhe material shëndetësor. Sivjet për ndryshim nga vitet tjera kemi bërë planifikimin me kryeinfermieret dhe farmacistët nëpër njësi, me qëllim që të dihen nevojat reale për barna dhe material shpenzues dhe pastaj të vendoset në bazë të prioritetëve dhe mundësive buxhetore për llojet dhe sasi të furnizimeve.
- Organizimi i Emergjencës Primare në dy ekipe emergjente – të cilat paradite i kemi dhe pasdite e kemi një, kështu do të mund t'i mbulonim “pikat e zeza” me ekip mobil emergjent në qytet ose akset rrugore me rrezikshmëri të lartë gjatë sezonit të verës ku edhe ndodhin shumë aksidente, përvojë kjo e marrë gjatë trajnimit në Turqi.
- Objektiv i yni është edhe rritja e kënaqshmërisë së qytetarëve (satisfaksioni i pacientëve) me shërbimet e ofruara nga QKMF, si dhe objektivat afatgjatë (të cekura në planin e punës për vitin 2020).

Aktivitetet

- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsej 10 mbledhje me kryeinfermierë të njësive, në të cilat janë diskutuar probleme, janë dhënë rekomandime për Këshillin Drejtues të QKMF-së, si dhe janë dhënë shumë detyra dhe obligime për kryeinfermieret e njësive.
- Shërbimi i vizitave shtëpiake për persona të moshuar dhe të palëvizshëm (nga 13.01.2020) është zgjeruar edhe në ndërrimin e pasdites në QKMF dhe QMF II, që do t'i mbulojnë të gjitha pjesët e territorit të komunës sonë (deri në këtë kohë kanë funksionuar vetëm paradite).
- Kemi përforcuar ekipet e "Vizitave për nëna dhe fëmijë" me nga dy ekipe në 4 QMF në qytet.
- Kemi përforcuar stafin nëpër QMF 5, QMF 6 dhe QMF 7 me nga tre infermierë, kurse QMF 3 me 5 infermierë, me qëllim të funksionalizimit të vaksinimit në këto qendra. Nga një infermiere e rregullt nga këto qendra do të trajnohet për punën në vaksinim për dy javë rresht secila qendër me radhë (i kanë kryer QMF 2, 3 dhe 7, por këto trajnime janë pezulluar përkohësisht në periudhën e pandemisë).
- Është bërë edhe planifikimi i kryerjes së stazhit për studentë dhe nxënës që kanë kryer shkollimin e paraparë për infermierë. Deri në fund të Tetorit janë regjistruar 163 praktikantë në stazh, por me fillimin e pandemisë e kemi ndërprerë praktikën dhe stazhin për të rifilluar më 14 Shtator. Për studentë dhe nxënës praktikantë në QKMF deri më 31.12.2020 janë lëshuar 91 certifikata nga Kryeinfermieri i QKMF-së.
- Më 27.02.2020 me vendim të MSH është dërguar ekipi i parë mobil në pikën kufitare në Hanin e Elezit, për kontrollim të udhëtarëve për simptoma eventuale të COVID -19, atje kemi pasur 4 ekipe me 4 mjekë dhe 4 infermierë deri më 04.08.2020, (kur me vendim të MSH janë ndërprerë) për të vazhduar më tutje nga data 07.11.2020 me 3 ekipe kujdestare me nga 2 infermierë dhe 1 vozitës, që janë duke i kryer shërbimet edhe më tutje në këtë pikë kufitare.
- Nga 13.03.2020 kur kemi pasur rastin e parë në Kosovë me Coronavirus kemi hyrë në një situatë të jashtëzakonshme dhe nga ajo datë kemi pezulluar aktivitetet trajnuese, ligjëratat dhe shumë aktivitete nga QZHVP u orientuan në këshillimin e qytetarëve dhe filluan me një riorganizim të stafit, komfort gjendjes së pandemisë. Vlen të theksohet se nga ajo datë kemi punuar ditë dhe natë me qëllim të organizimit të stafit dhe punës në pandemi.
- Në muajin Mars është kryer një trajnim ditor me stafin lidhur me përdorimin e drejtë të mjeteve dhe masave mbrojtëse, stafin e kemi ndarë në dy grupe që të ruhet stafi nga infektimi eventual, si dhe me qëllim të shfrytëzimit racional të mjeteve mbrojtëse.
- Organizimi i punës në tendë - gjatë kësaj kohe kemi organizuar dy ekipe me një mjek dhe dy infermierë në dy ndërrime, ku janë bërë triazhime, kontrole dhe këshilla dhe intervenime me pacientë të dyshuar dhe të infektuar me Covid 19.
- Ekipet e Emergjencës Primare të tendës dhe vizitave shtëpiake kanë trajtuar, këshilluar, kanë përcjellë në Klinikën Infektive pacientë, kanë sjellë pacientët e izoluar nga karantina (konviktet e studentëve) nëpër shtëpi të tyre, kanë vizituar dhe trajtuar pacientë me Covid 19 pozitiv në shtëpi etj. Vlen të theksohet se këto shërbime shtesë në kohën e pandemisë u kryen pa cenuar shërbimet tjera bazike për qytetarët tanë.
- Më 12 Maj është shënuar në mënyrë të veçantë *Dita e Infermierisë*, e cila u shënuar duke respektuar të gjitha masat kundër pandemisë, ditë kjo që përkonte me mundin dhe guximin e madh të infermierëve gjatë kësaj kohe dhe duke përçuar mesazhe motivuese dhe këshillues për qytetarët. Shënimi i kësaj dite u vlerësua lartë nga mediet lokale dhe qendrore.

- Më 31 Maj MSH largoi masat kundër pandemisë në tri nivele dhe nga 1 Qershori kemi filluar punën me staf komplet, por vazhdimisht duke vrojtuar situatën.
- Ka filluar vaksinimi i nxënësve në grupe, duke organizuar vaksinimin në QTMF.
- Edhe pse ishim bërë gati për fillimin e trajnimeve aty ku kishim mbetur me 13 Mars, me fillimin e shtimit të rasteve me Covid-19 këto trajnime dhe ligjërata u detyruam t'i shtyjme për më vonë, pasi që situata epidemiologjike në tërë Kosovën eskaloi në javën e fundit të Qershorit.

Muaji Korrik solli një valë të re të rasteve me Covid-19 që ka qenë shumë më serioze se muajt e kaluar. Pas një sërë masash të ndërmarra nga menaxhmenti i QKMF-së situata është mbajtur nën kontroll dhe infermierët kanë qenë në nivelin e detyrave të tyre, direkt të angazhuar në përballje me gjendjen e krijuar.

Më 1 Korrik - në kabinetin e RTG-së kemi angazhuar teknikët e rëntgenit në orar 12 orësh të shtunën dhe të dielën, ndërsa më vonë 24 bashkë me teknikët e spitalit.

Më 8 Korrik – kemi dërguar një ekip infermierësh në ndihmë Spitalit të Përgjithshëm pas kërkesës së Shtabit Emergjent Lokal, ky ekip ka vazhduar punën në Spital deri në muajin Shtator.

Më 9 Korrik – kemi angazhuar ekipin shëndetësor për vizita në shtëpi personave covid pozitiv.

Më 24 Korrik - kemi aktivizuar *Qendrën e thirrjeve* të përbërë nga infermierët të cilët i kanë thirrur pacientët e dyshuar dhe ata të infektuar, kanë monitoruar gjendjen e tyre, i kanë këshilluar, u janë përgjigjur pyetjeve dhe dilemave të këtyre personave në izolim si dhe kur kanë vlerësuar se është përkeqësuar gjendja e tyre kanë dërguar ekipin për vizitë.

Më 2 Shtator - nga kryeinfermieri i QKMF-së është organizuar një takim me kryeinfermierët e QKMF-ve të Rajonit (Shtime, Viti, Kaçanik, Han i Elezit) me qëllim të shkëmbimit të përvojave menaxheriale dhe organizative.

Nga 14 Shtatori, në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë, kemi filluar t'i pranojmë praktikantët në stazh me orë të reduktuara të punës dhe me numër të reduktuar të praktikantëve (nga tri orë në ditë nga dy praktikantë në ndërrim përkatës). Deri më tash janë sistemuar 163 praktikantë të profileve të ndryshme, të shpërndarë nëpër të gjitha QMF-të e Komunës sonë.

Në përgjithësi, ekipet e infermierëve gjatë këtij viti janë treguar shumë efikase dhe kanë kryer një numër të madh të rasteve, duke përmbushur kështu kërkesat e qytetarëve. Vlen të theksohet se krahas masave shtesë, në QKMF nuk është ndërprerë asnjë shërbim edhe pse gjendja epidemiologjike me Covid 19 ka qenë serioze. Shërbimet e kryera infermiore gjatë kësaj periudhe janë paraqitur në raportin e secilës njësi dhe në raportin e përgjithshëm të QKMF-së, ku shërbimet infermiore përfshijnë rreth 70% të shërbimeve në QKMF (nga **666209** shërbime **464 145** kanë qenë shërbime infermiore).

Me fillimin e muajit Shtator, në bashkëpunim me koordinatorin e ZHVP-së për infermierë kanë nisur edhe trajnimet dhe ligjëratat e stafit infermior, të ndërprera në muajin Mars, për shkak të pandemisë. Mirëpo, nga data 25 Tetor i kemi ndërprerë trajnimet direkte në Qendrën Trajnuese dhe kemi kaluar në platformën online deri në përmirësimin e situatës epidemiologjike. Më shumë të dhëna për trajnimet dhe ligjëratat që janë mbajtur për personelin infermior, kemi ofruar te raporti i Qendrës Trajnuese të Mjekësisë Familjare.

Gjatë muajit Nëntor dhe Dhjetor ka vazhduar përballja me fazën e tretë të pandemisë e cila është më e madhe se e dyta për nga numri i pacientëve dhe kohëzgjatja. Infermierët kanë dhënë gjithçka nga vetja e tyre në shërbim të popullatës. Sfidë serioze gjatë këtyre muajve ka qenë edhe ruajtja e stafit mjekësor nga infeksioni dhe shtimi i madh i rasteve me Covid-19. Gjatë tërë vitit gjithsej 60 infermierë janë infektuar me Covid-19, por fatmirësisht të gjithë e kanë kaluar pa pasoja.

Disa prej objektivave dhe synimeve të Zyrës së Kryeinfermierit, për shkak të gjendjes së pandemisë, janë shtyrë për vitin 2021, por pjesa dërmuese e tyre është realizuar. Nga situata e krijuar prej pandemisë kanë dalë shumë detyra dhe obligime të tjera, të cilat gjithashtu janë realizuar gjatë këtij viti.

Objektivat e infermierisë për vitin 2021

- Vazhdimi i trajnimeve për stafin infermieror në Emergjencën Primare, trajnimi i profileve specifike në QKMF si: stomatologjia, rëntgeni, farmacia, laborator etj.

- Pajisja me defibrilator automatik i katër QMF-ve dhe trajnimi i stafit infermieror për reanimimin kardiopulmonar bazik dhe përdorimin e defibrilatorit.

- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional.

- Prefeksionimi i shërbimeve infermiore nëpër njësi dhe ekipeve të vizitave në terren (kujdesit shtëpiak, vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë etj).


Këto objektiva do të realizohen në bashkëpunim me drejtorinë e QKMF-së dhe në koordinim me të gjithë sektorët e QKMF-së.

KOMITETI PËR NGRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE

Zyra për sigurimin e cilësisë në punë


Raporti nga Zyra për Cilësi të Shërbimeve përfshin periudhën Gusht - Dhjetor prej kur është ndërruar Koordinatori për Cilësinë e Shërbimeve. Gjatë këtyre muajve janë realizuar vizita në Qendrat e Mjekësisë Familjare për të mbikëqyrur punën e stafit mjekësor lidhur me menaxhimin e COVID-19, plotësimin e drejtë i kodeve të sëmundjeve në protokollin mjekësor dhe punën me programin e SISH-it. Me përpunimin dhe analizën e të dhënave të grumbulluara gjatë vizitave është realizuar audit klini: Menaxhimi dhe trajtimi i pacientëve me COVID-19 në periudhën Korrik-Gusht 2020. Qëllimi i këtij auditi ishte krijimi i një pasqyre mbi menaxhimin dhe trajtimin e pacientët e dyshuar dhe të konfirmuar me COVID-19 në QKMF-Ferizaj, mbështetur në dëshmitë dhe rekomandimet e OBSH-së, ECDC-së, udhërrëfyesve klinike, me theks të veçantë në Udhërrëfyesin klini "*Menaxhimi dhe trajtimi i COVID-19- Nr.9, Prishtinë 2020- version 1*".

Të dhënat për auditin, përmes metodës retrospektive, janë nxjerrë nga protokollet e mjekëve familjar dhe të përgjithshëm në QKMF, QMF1, QMF2 dhe QMF4 dhe nga tenda e vendosur në oborrin e QKMF-së, në periudhën kohore 01.07-31.08-2020.




Grafikoni 1. Përqindja e pacientëve të dyshuar në Covid 19 në QKMF (Korrik-Gusht)

Në këtë periudhë shërbime mjekësore kanë kërkuar: **13 199** pacientë, prej tyre të dyshuar në COVID-19 ishin **1 089 (8.25 %)** pacientë.




Grafikoni 2. Përqindja e pacientëve sipas trajtimit

Nga **1089** pacientë të dyshuar në Covid-19, **154 (14.10%)** janë referuar në SR-Ferizaj, **570 (52.30%)** pacientë janë trajtuar me terapi dhe **365 (33.50%)** kanë marrë vetëm këshilla.



Grafikoni 3. Përqindja e pacientëve sipas trajtimit nga mjeku familjar

Nga **570** pacientët e trajtuar me terapi në KPSH: **95 (16.60%)** kanë marrë *infuzione*, (antibiotikë, kortikosteroidë dhe vitamina); **99 (17.30%)** antibiotikë oralë; **328 (57.50%)** vitamina dhe minerale peroral dhe **48 (8.40%)** terapi intramuskulare.



Grafikoni 4. Përqindja e pacientëve të trajtuar sipas Udhërrëfyesit për KPSH

Nga **570 pacientët** e trajtuar nga ana e mjekëve familjarë **427 (75%)** pacientë janë trajtuar në bazë të Udhërrëfyesit, ndërsa **143 (25%) pacientë** nuk janë trajtuar në bazë të këtij Udhërrëfyesi.

Zyra për sigurimin e cilësisë në punë këtë vit ka përgatitur edhe auditin për referimet e pacientëve nga Kujdesi primar në atë sekondar dhe terciar, si problem i shprehur në institucionet tona shëndetësore. Përmes këtij auditi është bërë edhe vlerësimi i punës së specialistëve të mjekësisë familjare dhe performanca e tyre në zgjedhjen e problemeve shëndetësore, bazuar në konceptin e mjekësisë familjare.

Sipas standardeve, nga numri i përgjithshëm i pacientëve që kërkojnë shërbime shëndetësore në KPSH, 75% duhet të marrin shërbime shëndetësore në këtë nivel, ndërsa 25% të referohen për shërbime shëndetësore në nivelin sekondar dhe terciar. Të dhënat janë nxjerrë nga protokollet në: QKMF, QMF-1, 2 dhe 4 në periudhën kohore Janar - Qershor 2020 dhe janë përfshirë të gjithë mjekët që kanë punuar në këto qendra. Nga hulumtimi dhe përpunimi i rezultateve të marra, del se në këtë periudhë kohore kanë kërkuar ndihmë mjekësore **59 057** pacientë, prej të cilëve për konsultime apo trajtim në nivelin sekondar dhe terciar janë referuar 9742 pacientë apo shprehur në përqindje 16,49 %.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri dhe përqindja e referimeve në kujdesin sekondar dhe terciar sipas qendrave me radhë, ku vërehet se: në QKMF përqindja e referimeve për periudhën e përmendur është 21,56%; në QMF 1 përqindja është 14,31%; në QMF 2 është 15,11% dhe QMF 4 përqindja e referimeve është 10,86%.

Tabela 1. Përqindja e referimeve sipas qendrave

KPSH	PËRQINDJA E REFERIMEVE		
NJËSIA	Totali	Nga MF në KDSH dhe KTSH	Vizita të caktuara nga KDSH dhe KTSH
QKMF	21.56 %	14.02 %	7.54 %
QMF 1	14.30%	7.52 %	6.78 %
QMF 2	15.10 %	10.31 %	4.79 %
QMF 4	10.86%	6.77 %	4.09 %

Ndërsa numri i pacientëve për secilën qendër dhe të dhënat e referimeve janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 2. Numri i referimeve dhe përqindja

KPSH		NUMRI I REFERIMEVE DHE PËRQINDJA				
Njësia	Numri i pacientëve	Totali i referimeve	në KDSH	në KTSH	nga vizitat e caktuara në KDSH	nga vizitat e caktuara në KTSH
QKMF	19778	4266	2596	178	1172	320
QMF 1	11495	1645	740	125	568	212
QMF 2	19132	2891	1870	103	613	305
QMF 4	8652	940	534	52	255	99
TOTALI	59057	9742	5740	458	2608	936
Përqindja	100%	16.49%	9.71%	0.77%	4.41%	1.58%

Në bazë të rezultateve të auditit numri i pacientëve që referohen në kujdesin sekondar dhe terciar është në përputhje të plotë me konceptet e Mjekësisë Familjare dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, sipas të cilave deri 20 % e pacientëve që kërkojnë ndihmë mjekësore në KPSH, mund të referohen për trajtim në nivelet e tjera, nëse e kërkon gjendja shëndetësore e pacientit. Numri i referimeve do të ishte edhe më i vogël sikur mos të kishim vizita të caktuara nga specialistët e nivelit sekondar dhe terciar.

I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Departamenti i Mjekësisë Familjare, me shtrirjen e aktivitetit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha nivelet, ka vazhduar angazhimet drejt realizimit të objektivave të veta mbi shëndetin, për të gjithë banorët e Komunës sonë, aktivitete këto që bëhen duke respektuar gjithnjë politikat lokale për shëndetësi të referuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Sktori i Shëndetësisë) dhe Ministria e Shëndetësisë, të bazuara në ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.

Departamenti i Mjekësisë Familjare gjatë *këtij viti*, funksionimin e vet e ka përqendruar në kryerjen e shërbimeve të përhershme:

1. Shërbimet konsultative nga mjeku familjar dhe i përgjithshëm
2. Shërbimet konsultative nga specialistët e profileve të tjera (fiziatri, radiologu, psikiatri, psikologu, oftalmologu)
3. Shërbimet e shëndetit oral

4. Shërbime infermierike
5. Shërbimet preventive (edukimi, vaksinimi, KAN-i, vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë, Qendra informuese për shëndetin e gruas)
6. Shërbimet emergjente
7. Kujdesi shtëpiak
8. Kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën
9. Shërbime diagnostike (EKG, ECHO, shërbimet laboratorike, shërbimet rentgenologjike)

Mirëpo, që nga muaji Mars angazhimi për t'u përballur me pandeminë COVID-19 ka qenë prioritet i çdo shërbimi. Raporti në vazhdim jep një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të personelit shëndetësor në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

1. SHËRBIMET MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes mjekëve dhe infermierëve, krahas përgjegjësisë dhe shkallës së lartë të përgatitjes profesionale. Gjatë punës dhe aktivitetit të përditshëm të mjekëve dhe infermierëve bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët e Komunës sonë dhe më gjerë.

Numri i shërbimeve dhe mbarëvajtja – Rezultatet e punës për *vitin 2020*, në Departamentin e Mjekësisë Familjare të QKMF – së, mund të radhiten sipas qendrave dhe sektorëve, me sa vijon:

- Në **QKMF**: janë ofruar **166 356** shërbime shëndetësore, prej tyre **33 893** janë vizita mjekësore kurse **132 466** shërbime infermierike.
- Në **QMF 1**: janë kryer **87 650** shërbime shëndetësore, prej tyre **21 519** janë vizita mjekësore, kurse **66 131** shërbime infermierike.
- **QMF 2**: janë kryer **137 841** shërbime shëndetësore, prej tyre **38 918** janë vizita mjekësore kurse **98 923** janë shërbime infermierike dhe të tjera.
- **QMF 4**: janë kryer **61 411** shërbime shëndetësore, prej tyre **17 734** janë vizita mjekësore kurse **43 677** shërbime infermierike.
- **QMF 3 - Greme**: janë kryer **11 207** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 740** janë vizita mjekësore kurse **7 467** shërbime infermierike.
- **QMF 5 - Komogllavë**: janë kryer **9 204** shërbime shëndetësore, prej tyre **2 702** janë vizita mjekësore kurse **6 502** shërbime infermierike.
- **QMF 6 - Pleshinë**: janë kryer **10 030** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 282** vizita mjekësore dhe **6 748** shërbime infermierike.
- **QMF 7 - Neredime**: janë kryer **4 290** shërbime shëndetësore, prej tyre **1 789** vizita mjekësore dhe **2 501** shërbime infermierike.
- **AMF – të** – janë kryer **18 665** shërbime shëndetësore, prej tyre **4 746** vizita mjekësore kurse **13 919** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E NATËS** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar dhe QMF II, ka kryer **39 285** shërbime shëndetësore, nga të cilat **22416** vizita mjekësore kurse **16 869** shërbime infermierike. Prej tyre **31 161** shërbime janë kryer në QKMF (SHEP) dhe **8 124** shërbime në QMF 2.
- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE** – ka kryer gjithsej **21 868** shërbime, nga të cilat **10702** vizita mjekësore dhe **11 166** shërbime infermierike. Prej tyre **11 426** shërbime janë ofruar në QKMF (SHEP) dhe **10 442** në QMF 2.

Tabela 3. Numri i shërbimeve sipas qendrave

Qendra	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve infermierike	Numri i përgjithshëm shërbimeve
QKMF	33 893	132 466	166 359
QMF 1	21 519	66 131	87 650
QMF 2	38 918	98 923	137 841
QMF 4	17 734	43 677	61 411
QMF Greme	3 740	7 467	11 207
QMF Komogllavë	2 702	6 502	9 204
QMF Pleshinë	3 282	6 748	10 030
QMF Neredime	1 789	2 501	4 290
AMF - të	4 746	13 919	18 665
Kujdestaria e natës	22 416	16 869	39 285
Kujdestaria e të dielave	10 702	11 166	21 868

2. SHËRBIMET DIAGNOSTIKE

2.1. Njësia e laboratorit

Personeli i laboratorëve në pesë qendrat ka ofruar shërbime të vazhdueshme, në këta laboratorë janë kryer shumica e analizave të nevojshme për diagnostifikim, numri i përgjithshëm i të cilave gjatë *këtij viti* arrin në **81 072** analiza, prej të cilave **72 705** janë analiza gjaku dhe **8 367** analiza urine.

Tabela 4. Shërbimet e ofruara në laboratorët e qendrave

Laboratorët në qendra	Analiza urine	Analiza gjaku	Gjithsejtë
QKMF	5 906	55 116	61 022
QMF 1	593	4 718	5 311
QMF 2	1 387	10 471	11 858
QMF 4	233	1 965	2 198
QMF Greme	248	435	683
Totali	8 367	72 705	81 072

2.2. Njësia e radiologjisë

Njësia e Radiologjisë në kuadër të QKMF-së është e ndarë në gjashtë kabinete: RTG në DAT, RTG digjital në SHEP, RTG dental, Mamografia dhe kabinetet e dy radiologeve të pajisura me aparate të ultrazërit. Gjatë *vitet 2020* në këtë njësi janë kryer këto shërbime:

Tabela 5. Shërbimet në Kabinetin e RTG-së

Shërbimet	Numri i shërbimeve
Vizita specialitike radiologjike	3 532
Radiografia të extremiteteve	7 361
Radiografi të mushkërive	3 408
Radiografi e dhëmbit	711
Radiografi e gjirit	2 260
Echo e abdomenit	282
Echo e gjirit	481
Echo e qafës	68
Lexim i radiografive	1 613
Mamografi lexim	356
Gjithsej	20 072

3. DISPANZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE

Në DAT gjatë periudhës *njëvjeçare* për raste të dyshuara (supozuara) për TB janë punuar 650 baciloskopi, prej të cilave 59 pacientë kanë rezultuar pozitiv.

Tabela 6. Shërbimet në DAT

Shërbimet	Numri
Vizita specialistike	1 981
Edukim shëndetësor	1 519
Përpunim i kontaktit	296
TBC pulmonare	38
Raste të reja me TB	57
Raste recidive	2
TBC Extrapulmonare	19
Baciloskopi	650
BK+	56
Laborator (Se)	70
PPD	388
Vizita shtëpiake	94
Inhalime	13
Testi i HIV-it	7

Në këtë periudhë janë regjistruar gjithsej 50 raste të reja me tuberkuloz, prej tyre 45 janë me tuberkuloz pulmonar 38 dhe 19 me tuberkuloz ekstrapulmonar, ndërsa dy prej tyre janë raste recidive.

4. SHËRBIMET PREVENTIVE

Në shërbimet preventive, që nënkuptojnë promovimin e shëndetit në komunitet, bëjnë pjesë dy njësi të QKMF – së:

- a) Edukimi shëndetësor dhe
- b) Vaksinimi.

Të dyja këto njësi ofrojnë shërbime nëpër shkolla dhe në komunitet dhe organizojnë punën nëpërmjet ekipeve përkatëse.

4.1. Edukimi shëndetësor

Promovimi dhe edukimi shëndetësor, si një lëvizje për përmirësimin e shëndetit individual dhe të popullatës në mbarë botën, konsiderohet si ombrellë e shprehjes së një sërë aktiviteteve të cilat përpiqen të

rrisin mirëqenien fizike, mentale dhe sociale, parandalojnë sëmundjet dhe njëkohësisht të ndikojnë në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit.

Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor qysh në fillim të vitit ka dorëzuar planin vjetor të punës, mirëpo, për shkak të ndërrimit të koordinatorit të mëparshëm dhe situatës së krijuar gjatë pandemisë COVID 19, këto aktivitete nuk kanë mundur të përmbushen.

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2020

- Fuqizimi i grupit të Promovimit dhe Edukimit Shëndetësor;
- *Vazhdimi i Projektit - Realizimi i vizitave sistematike të përgjithshme dhe vizitat sistematike për shëndet oral në shkollat fillore të Komunës së Ferizajt;*
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese të shëndetit për nder të Ditëve ndërkombëtare sipas kalendarit të OBSH-së;
- Të hapen dhoma për promovim dhe edukim shëndetësor nëpër të gjitha QMF-të në Ferizaj;
- Vazhdimi i seancave këshilluese gjatë vizitave për nëna dhe fëmijë, me theks të posaçëm këshillimi për planifikim familjar;
- Vazhdimi i seancave këshilluese për vetë -ekzaminimin e gjirit, të ushqyerit me qumësht gjiri etj.
- Vazhdimi i projektit “Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë për kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë”;
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe bashkëpunimit me OM, OIK, SR, OJQ;
- Përfshirja e bashkësisë në kujdesin për shëndetin;
- Edukimi shëndetësor për pacientë dhe familje;
- Hartimi, distribuimi i materialeve të promovimit dhe edukimit shëndetësor, bashkëpunimi me media;
- Prevenimi i sëmundjeve ngjitëse, jo ngjitëse; dhe kronike (s. respiratore, SKV, STG);
- Trajnimi i personelit shëndetësor dhe jo shëndetësor për promovim dhe edukim shëndetësor;

Nëse gjatë vitit të ardhshëm do të përmirësohet situata epidemiologjike me COVID-19, aktivitetet do të realizohen sipas këtij plani.

- **Më 09, 12 dhe 15 Tetor** (në ditët promovuese për parandalimin e kancerit të gjirit) u mbajtën tri ligjërata në kuadër të edukimit dhe promovimit shëndetësor në komunitet, ku infermierët mbajtën ligjëratë me temën: *Parandalimi dhe zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës* në fshatin Dubravë, Prelez i Muhaxherëve dhe Shkollën “Ahmet Hoxha” ku morën pjesë numër i konsiderueshëm i grave nga komuniteti.

4.2. Shërbimi i vaksinimit

Gjatë **vitet 2020** Shërbimi i Vaksinimit në QKMF ka vazhduar punën brenda mundësive të krijuara nga pandemia. Në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, janë dhënë gjithsej **19 841** vaksina për fëmijë, ndërsa muajt e fundit janë vaksinuar edhe **5 170** nxënës nëpër shkolla. Me arritjen e vaksinave kundër gripit sezonal ato janë shpërndarë nëpër njësi dhe janë vaksinuar **7651** qytetarë, që do të thotë numri i përgjithshëm i vaksinave është **32 662**.

Tabela 7. Vaksinimi sipas qendrave

<i>Qendra</i>	<i>Vaksinat nëpër njësi</i>	<i>Vaksinimi i nxënësve</i>	<i>Vaksina kundër gripit</i>
<i>QKMF</i>	<i>11 401</i>	<i>4 905</i>	<i>3 130</i>
<i>QMF 1</i>	<i>1 552</i>	<i>0</i>	<i>800</i>
<i>QMF 2</i>	<i>3 351</i>	<i>0</i>	<i>1 450</i>
<i>QMF 4</i>	<i>956</i>	<i>0</i>	<i>920</i>
<i>QMF Greme</i>	<i>571</i>	<i>0</i>	<i>350</i>
<i>QMF Komogllavë</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>100</i>
<i>QMF Pleshinë</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>100</i>
<i>QMF Dardani</i>	<i>551</i>	<i>0</i>	<i>250</i>
<i>AMF - të</i>	<i>1 459</i>	<i>265</i>	<i>550</i>
<i>Totali</i>	<i>19 841</i>	<i>5 170</i>	<i>7 651</i>

4.3. Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas

Në Qendrën Informuese për Shëndetin e Gruas në QMF 2, gjatë *këtij viti*, janë ofruar **153** shërbime dhe trajnime individuale dhe grupore, për gra shtatzëna dhe familjet e tyre. Në numrin e shërbimeve të kësaj qendre gjatë këtij viti ka ndikuar gjendja e pandemisë dhe respektimi i rekomandimeve të IKSHPK-së për të parandaluar përhapjen e virusit.

4.4. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

Shërbimi i Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë gjatë *këtij viti*, ka ofruar **2 864** vizita që janë tejet të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, ushqyeshmërinë e fëmijëve dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme apo identifikimin e hershëm të tyre. Një pjesë e këtyre shërbimeve janë ofruar online për shkak të pandemisë Covid-19.

5. SHËRBIMET EMERGJENTE

Shërbimi emergjent si njësi në kuadër të QKMF-së, gjatë *vitit 2020* ka intervenuar në **3185** raste emergjente, mirëpo përveç rasteve emergjente aty janë ofruar edhe **12 935** shërbime të tjera.

Shërbimet emergjente në terren dhe shërbimet e tjera janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 8. Numri i shërbimeve emergjente mjekësore në bazë të entiteteve emergjente:

Shërbimet emergjente	Numri i rasteve
Emergjencat internistike	696
Emergjencat infektive suspekt (covid-19)	707
Emergjencat kirurgjike	8
Emergjencat ortopedike	55
Emergjencat pediatrike	2
Emergjencat gjinekologjike	6
Emergjenca toksikologjike	15
Emergjencat neurologjike	137
Emergjencat psikiatrike	109
Emergjencat geriatrike	295
Trauma në komunikacion	205
Dhimbje akute	321
Trauma në punë	4
Trauma në familje	6
Trauma me armë zjarri	3
Trauma me armë të ftohta	2
Tentim vetëvrasje me mjete kimike	0
Djegje	2
Sëmundje malinje	220
Verifikim i vdekjes	415
GJITHSEJ	3185

Nga niveli qendror, respektivisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është mundësuar projekti i ndërtimit të 27 shtëpive për komunitetin RAE dhe 7 të tjera janë në procedurë. Ne si zyrtar të DSHMS-së jemi të angazhuar në disa grupe punuese për shërbime sociale si në atë të Planit Zhvillimor Komunal, të hartimit të rregullores për të drejtat e fëmijëve, në grupin punues për përgatitjen e planit lokal të veprimit për

komunitetet minoritare, për trajtimin dhe ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar, në komisionin për trajtimin e dhunës në familje, në grupin punues për identifikimin e grupeve dhe personave vulnerabil (të ndjeshme, të cënueshëm) etj.

Edhe pse me shumë sfida dhe obligime marramendëse nga viti i kaluar ne po u përgjigjemi kërkesave dhe nevojave të qytetarëve duke u ofruar shërbime sociale dhe përkrahje materiale.

Në periudhën Janar – Dhjetor kemi shpërndarë ndihma nga subvencionet

DSHMS-ja për vitin 2020 ka pasur në dispozicion mjete financiare si kategori e subvencioneve gjithsej 50.000.00 €, për përkrahje të rasteve më të rënda me shuma simbolike përballë nevojave dhe kostove për trajtime shëndetësore dhe nevojave elementare për artikuj për jetesë të një numri shumë të madh të personave dhe familjeve në nevoja socio-ekonomike.

Në bazë të kërkesave të palëve për shërim si dhe kërkesave të ndryshme tjera, janë përkrahur me mjete financiare nga subvencionet disa raste, për të cilat si ndihmë e njëhershme momentale janë ndarë gjithsej **50.000,00 €**.

Sa i përket çështjes së banimit gjatë vitit 2020 janë ndërtuar dhe dhuruar 22 shtëpi dhe apartamente për familje skamnore në bashkëpunim me donatorë.

Në vazhdim bashkëngjisim Raportin vjetor 2020 të Qendrës për Punë Sociale dhe Shtëpisë së Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore.

RAPORT I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Raporti i punës i shërbimeve sociale për periudhën Janar-Dhjetor 2020

Kategorit mbrojtëse	Rastet e vjetra 2019	Rastet e reja 2020	Gjithsej
Delikuenca e të miturve	55	41	96
Fëmijët me sjellje asociale	33	13	46
Fëmijë e keqtrajtuar	4	1	5
Fëmijët e braktisur të posalindur	5	4	9
Fëm.pa perk.pr.të strehuar tek të afërmit me pagesë		35	35
Kërkesa për Fëmijë me aftësi të kufizuara		504	504
Fëmijë me aftësi të kufizuara në pagesë		121	121
Kujdestaria ndaj fëmijëve	34	3	37
Kërkesa për adoptim vendor	14	3	17
Kërkesa për adoptim ndërkombëtar	0	0	0
Fëmijë jetim	0	0	0
Rrëmbime ndërkombëtare	0	0	0

Vendosja në Strehimore	3	3	6
Dhuna në familje	8	9	17
Viktima të krimeve seksuale	1	2	3
Viktima të trafikimit	0	0	0
Çrregullimet bashkëshortore	33	38	71
Familje strehuese	5	0	5
Mbroj.e personave të moshuar	1	0	1
Klientë të tjerë	813	414	1227
Puna e rrezikshme	3	0	3
Përdoruesit e substancave narkotike		1	1
Përdoruesit e alkoolit	0	0	0
Martesa e të miturve	1	0	1
Intervenimet e përgjithshme	3988	2729	6717
Gjithsej:	5001	3921	8922

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË SHËRBIMIT TË S.N.S- së

Nëpunësit e S.N.S-së të Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj kanë pranuar të gjitha kërkesat e asistencës sociale në harmoni të plotë me Ligjin 2003/15.

Në periudhën **Janar - Qershor - Shtator - Dhjetor - 2020** numri i aplikantëve që kanë aplikuar për herë të parë është :

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Shqyrtim	Gjithsej
Janar	10	1	2	13
Shkurt	12	2	0	14
Mars	6	1	0	7
Prill	0	0	0	0
Maj	0	0	0	0
Qershor	2	0	0	2
Korrik	0	0	0	0
Gusht	10	0	2	12
Shtator	11	1	3	15
Tetor	15	1	11	27
Nëntor	28	3	1	32
Dhjetor	3	0	0	4
Totali	97	9	19	126

Nga lista e pagesave për mos riaplikim largohen një numër i familjeve të cilët nuk vazhdojnë me ndihmë sociale pasi që nuk i plotësojnë kriteret e SNS-ës .

Muaji	Numri i familjeve
Janar	7
Shkurt	8
Mars	8
Prill	0
Maj	0
Qershor	0
Korrik	0
Gusht	0
Shtator	0
Tetor	3
Nëntor	0
Dhjetor	0
Totali	26

NUMRI I FAMILJEVE QË JANË VERIFIKUAR DHE RIVERIFIKUAR

Për shkak të pandemisë nga muaji Prill janë verifikuar vetëm rastet e reja ku totali i tyre për vitin 2020 është 126 raste, ndërsa palët të cilat kanë ri-aplikuar në bazë të udhëzimeve të MPMS-së, nuk ka qenë e domosdoshme verifikimi në terren.

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Totali
Janar	157	11	168
Shkurt	163	13	176
Mars	157	10	167
Prill	151	00	151
Maj	125	00	125
Qershor	82	5	87
Korrik	125	11	136
Gusht	97	9	106
Shtator	91	11	102
Tetor	111	9	120
Nëntor	156	10	166
Dhjetor	120	9	129
Totali	1535	98	1633

Gjatë riverifikimit Nëpunësit e S.N.S-së kanë refuzuar - **98** - familje që nuk i plotësojnë kriteret sipas **Ligjit të SAS-it, 2003/15**.

Prej familjeve që janë aprovuar - **1535** - kërkesa të Asistencës sociale.

Nëpunësit e SNS-së mesatarisht për çdo muaj kanë realizuar përafërsisht - **138** - riaplikime , këtu hyjnë edhe lëndët e vjetra dhe të reja.

Gjatë periudhës **Janar - Mars - Qershor - Shtator - Dhjetor** :janë dërguar - **145** - lëndë në komision mjekësorë - **133** - kërkesa janë aprovuar nga komisioni mjekësor kurse - **1** - kërkesë është kthyer për kompletim të dokumentacionit mjekësor ndërsa nga komisioni mjekësor janë refuzuar - **11** - lëndë.

Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e ndihmave sociale për periudhën: **Janar - Qeshor - Shtator - Dhjetor** : janë - **7** - ankesa .

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (shkalla e dytë) janë refuzuar - **7** – ankesa, ndërsa nga **DNS -ja** janë aprovuar - **0** - ankesa, në shqyrtim janë - **1** - ankesë.

Lëndë që presin prej gjykatës kontestin gjyqësor janë- **0** - lëndë, kurse **lëndë që janë shqyrtuar negative - 0 – dmth lëndë pozitive nga ana e gjykatës nuk kemi.**

Janë lëshuar - 121 - vërtetime për familjet që janë dhe nuk janë shfrytëzues të asistencës sociale, në këto vërtetime përfshihen: ndihmë momentale (urgjente), vërtetim për përfitimin e shtetësisë, bursës, mujorës së udhëtimit, banimit dhe shërbimeve tjera që mundësohen nga SNS-ja.

Palë të cilët kanë kërkuar ndihma të menjëhershme nga DPSF – DNS-ja kërkesa janë - 1 - e aprovuara është - 1, kurse kërkesa negative janë - 0 - në shqyrtim nuk ka - 0-.

Qendra për Punë Sociale në Ferizaj, si çdo qendër tjetër i është ngarkuar zbatimi i Pakos fiskale emergjente (Masa 15) ku me zbatimin e kësaj mase QPS-ja ka pranuar mbi 3150 kërkesa dhe njëherit ka regjistruar në bazën e të dhënave 2977 kërkesa, prej tyre 1102 kërkesa janë të aprovuara dhe 1875 janë të refuzuara.

QPS-Ferizaj ka shpërndarë mbi 700 vendime ku pjesa më e madhe e këtyre vendimeve ishin negative dhe përmes këtyre vendimeve pala e pakënaqur ka ushtruar ankesë përmes QPS-së në DPSF/MPMS dhe ishin 513 ankesa.

Gjatë shqyrtimit të ankesave, Komisioni për shqyrtimin e ankesave në DPSF/MPMS ku shqyrtoi 513 ankesave, 241 prej tyre janë të aprovuara.

Gjatë kohës së pandemisë zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale kanë ofruar shërbime të ndryshme, kanë përpiluar lista të ndryshme si për shtabin emergjent rreth luftimit të pandemisë (Covid 19) në nivel komunal, ashtu edhe për donatorë të ndryshëm.

RAPORTI VJETOR I SHPËRNDARJES SË NDIHMAVE SOCIALE SIPAS KATEGORIVE

Muaji	Kateg - I -	Kateg - II -	Nr. i familjeve	Nr.i anëtarëve	Totali
Janar	586	386	954	4004	102,957.50 €
Shkurt	571	387	958	4180	103,290.00 €
Mars	563	383	946	3964	203,775.00 €
Prill	557	387	964	4042	207,945.00 €
Maj	582	390	972	4075	209,435.00 €
Qershor	573	387	960	4032	102,965.00 €
Korrik	565	383	948	3983	102,265.00 €
Gusht	564	386	950	3978	102,547.50 €
Shtator	553	390	943	3932	101,490.00 €
Tetor	552	389	941	3897	202,025.00 €
Nëntor	566	414	980	4057	210,402.50 €
Dhjetor	573	418	991	4110	213,520.00 €
Totali	6805	4700	11507	48254	1,862,617.50 €

Duhet theksuar gjithashtu se gjatë gjithë pandemisë, në vitin 2020 u shpërndanë mbi 5000 pako ushqimore dhe higjienike nga Ekipi i Shpërndarjes së Ndihmave, për familjet në nevojë, pako ushqimore dhe higjienike si dhe veshmbathje këto të siguruara me fondet e Komunës dhe donatorëve vullnetmirë – bizneseve, nga të cilat me një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Kryetarët e fshatrave dhe zonave urbane, asnjë kërkesë për ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike nuk u refuzua. Nga këto pako ushqimore dhe higjienike përfituan kategori të shumta si: nënat vetushqyese, personat me nevoja të veçanta, personat me të pamur të dëmtuar dhe të verbër, shoqata e invalidëve të luftës dhe OVL e UÇK-së, qendra e kujdesit ditor “Pema”, OJQ “Doun Syndrome Kosova” në Ferizaj, shoqatat e personave me nevoja të veçanta “Handikos” dhe “Hendifer”, komunitetet jo shumicë në Ferizaj, familjet strehuese në Ferizaj dhe kategori të tjera të cilat u përfshinë në listat e ndihmës me pako ushqimore dhe higjienike nga ana e Komunës së Ferizajt.

Vlen të theksohet fakti se një solidaritet të madh treguan edhe bukëpjekësit të cilët për qindra familje gjatë pandemisë, ofruan afro 35 mijë bukë falas për familjet në nevojë gjatë pandemisë.

Familjet shfrytëzuese të asistencës sociale të zëna nga ATK - ja, të cilat punojnë në firma të ndryshme dhe kanë përfituar ndihmën sociale pa bazë ligjore.

Muaji	Kateg -I-	Kateg -II -	Totali
Janar	2	2	4
Shkurt	1	2	3
Mars	0	0	0
Prill	2	0	2
Maj	6	1	7
Qershor	5	2	7
Korrik	2	1	3
Gusht	3	2	5
Shtator	1	0	1
Tetor	0	0	0
Nëntor	4	1	5
Dhjetor	0	0	0
Totali	26	11	37

Nga njoftimet me shkrim të DPSF/MPMS-në, në bashkëpunim me ATK-në, jemi të njoftuar se 37 familje si shfrytëzuese të ndihmave sociale kanë anëtar të familjeve të tyre të punësuar.

Gjatë konsultimit me 37 shfrytëzuesit e SNS-së të cilët janë hasur duke punuar dhe njëherit duke i njoftuar me procedurat dhe pasojat që mund t'i kenë për mos kthimin e pagesave, kemi arritur që t'i bindim për kthimin e ndihmës sociale 25 prej tyre.

Mirëpo falë angazhimit të palodhshëm të nëpunësve të S.N.S- së, duke e parë gjendjen e rëndë ekonomiko - sociale të familjeve të cilët janë në varfëri të skajshme, edhe përkundër kërkesave të mëdha (numrit të madh të popullatës) si dhe numrit të vogël të zyrtarëve i'u janë përgjigjur kërkesave të qytetarëve.

Punonjësit e S.N.S- së gjatë verifikimit dhe riverifikimit të rasteve sociale i përcjellin probleme të shumta nga aplikantët të cilët nuk e gëzojnë asistencën sociale. Një numër i konsiderueshëm i rasteve sociale mendojnë se këto ndihma ju takojnë vetëm pse kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare, të tjerët pse kanë fëmijë të hendikepuar nën 18 vjeçare, por tani ekziston Udhëzimi Administrativ Nr.03/2009 për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme.

Punonjësit e S.A.S-it të Qendrës për Punë Sociale janë duke e zbatuar Ligjin e SNS- së 2003/15 me përpikmëri.

Nr.			
1	Vërtetim për heqjen e shtetësisë.	124	2
2	Vizitë në familje, shkollë, komunitet etj.	96	145
3	Kërkesa që nuk i është marrë aftësia vepruese	259	19
4	Pëlqim për dokument udhëtimi	55	3
5	Vërtetim për punësim	12	1
6	Çrregullime Bashkëshortore	32	24
7	Konstatim zyrtar	10	
8	Vizitë në familjen e fëmijut të keqtrajtuar	26	2
9	Dyshim i keqtrajtimit seksual	1	
10	Shërbime për personat e rritur me çrregullime mendore	18	15
11	Dhunë në familje	18	19
12	Adoptim me elemente vendore	12	7
13	Konsultim për rastin e kontaktit me fëmijë	55	48
14	Përcjellja e kontaktit me fëmijë	22	61
15	Seancë këshilluese lidhur me kontaktin me fëmijë	31	55
16	Përfaqësimi në Polici	42	11
17	Kujdestari për të mitur	8	6
18	Kujdestari për të rritur	5	5
19	Vizitë rivlerësuese e familjes potenciale për adoptim	6	9
20	Vizitë në QAP për regjistrimin e fëmijut në kurs		
21	Seancë këshilluese e familjes lidhur me rishqyrtimin e pensionit i cili iu ka ndërprerë		
22	Vizitë në familje, raste të të miturve në konflikt me ligjin si dhe intervista me të njejtin	55	19
23	Vizitë në familje për propozim për besim të fëmijëve	13	13
24	Seancë këshilluese familjare për të miturin me sjellje asocial	44	26
25	Fëmijë me sjellje asocial	32	24
26	Mbikqyrje e shtuar e organit të kujdestarisë	9	2
27	Seancë këshilluese lidhur me kontaktin e fëmijut	21	34
28	Marrja e deklaratës për besimin e fëmijut	26	14
29	Seancë këshilluese me bashkëshortët-marrdhënie të çrregulluara	53	54
30	Vizitë në familjen strehuese	10	14
31	Vizitë e fëmijut në strehim familjar si dhe dërgimi i tij tek pediatri	2	4

32	Sesion familjar me nënën e fëmiut të keqtrajtuar	1	10
33	Të miturit në konflikt me ligjin	49	18
34	Seancë këshilluese me të miturin/rën	67	45
35	Fëmijë në strehim familjar brenda familjes	5	35
36	Raport për strehimoren “Shtëpia e Sigurtë” Gjakovë për rastin e të miturës.		
37	Përgatitja e lëndës për adoptim	1	8
38	Shërbimi në realizimin e kontaktit me fëmijët e prindërve të ndarë e shkurorëzuar	18	34
39	Përfaqësim në gjykatë	22	21
40	Shërbime të tjera kategori e pa specifikuar	488	244
41	Strehim në shtëpitë për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje	4	3
42	Bashkëpunim në gjykatë –pjesëmarrje	29	12
43	Ndihmë në rregullimin e dokumentacionit të udhëtimit	17	15
44	Shërbime gjatë kujdestarisë jashtë orarit dhe vikendeve	29	8
45	Shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme	25	62
46	Bashkim familjar		1
47	Shërbime për personat e rritur përdorues të drogës	2	3
48	Shërbime për personat e moshuar e pa përkujdesje familjare		16
49	Shërbime për prindërit në nevojë për adoptim	10	11
50	Shërbimet për familjet e vlerësuara për strehim familjar	1	14
51	Shërbimet që strehojnë fëmijë brenda familjes	9	29
52	Strehim i përkohshëm në shtëpitë për strehim të përkohshëm	1	1
53	Strehim në shtëpitë në bazë në komunitet	1	1
54	Shërbime për personat e rritur me nevoja të veçanta	1	31
55	Fëmijë me aftësi të kufizuar	38	5
56	Marrje të deklaratës palëve	141	76
57	Çrregullime të marrdhënieve në familje, këshilla	37	32
58	TOTAL:	1471	1371

III. Sektori për Administratë dhe Financa

Emërtimi i vërtetimitave	Numri i rasteve	Shuma
Vërtetim për humbjen e shtetësisë	96	96x50=5600
Vërtetim për përfitimin e shtetësisë	15	15x5=75

SHTËPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE-FERIZAJ

RAPORT PUNE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2020

- *Gjendja shëndetësore e rezidentëve*
- *Furnizimi me ushqim, barëra, material higjienik,ujë,rrymë etj*
- *Aktivitetet me rezidentë*
- *Vizitat e QPS-ve dhe familjarëve*
- *Sfidat dhe pengesat në punë*

Gjendja shëndetësore e rezidentëve

Vitin që lamë pas, gjendja shëndetësore e rezidentëve kryesisht ka qenë e mirë.

Përkundër situatës me pandemin Covid-19, gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë e menaxhueshme marr parasysh edhe kalimin nga periudha e sezonit dimëror në sezonin pranverorë zakonisht gjatë muajit Mars dhe fillim të muajit Prill ku disa prej rezidentëve shfaqin një lloj agresiviteti të përballueshëm ndaj stafit dhe ndaj rezidentëve tjerë, falë angazhimit të stafit lehtë kalohet kjo periudhë. Pas shfaqjes së pandemisë Covid-19 ne kemi marrë të gjitha masat e rekomanduara nga IKSHPK dhe për fat të mirë gjatë gjithë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë rezident të prekur nga ky virus.

Nën masa të rrepta mbrojtëse ne kemi vazhduar me vizitat mjekësore të përgjithshme dhe ato psikiatrike të rezidentëve, gjithashtu ua kemi bërë edhe analizat dhe për fat të mirë të gjithë kanë rezultuar me shëndet të mirë.

Furnizimi me ushqim, material higjienik, barëra, ujë, rrymë, derivate etj.

Sa i përket furnizimit me ushqim, gjatë vitit 2020 kemi pasur mjaftueshëm dhe të gjithë operatorët të përzgjedhur nga AQP kanë qenë jashtëzakonisht të përgjegjshëm dhe korrekt ndaj kërkesave tona. Duhet cekur se kemi pasur mungesë për pemë dhe perime të cilat kanë qenë më se të nevojshme edhe pse ne kemi vazhduar kërkesën tonë për furnizime, përgjigjet kanë qenë se nuk ka ndonjë përzgjedhje të ndonjë operatori për këtë furnizim.

Barna: Qysh në fillim të vitit kemi bërë kërkesën tonë për furnizim me barna, mirëpo kemi pasur ngecje me furnizime të tilla pasi nga prokurimi kemi marrë përgjigje se nuk ka operator.

Kështu ne jemi ballafaquar pothuajse gjysmë viti me mungesë të madhe të barnave esenciale, kështu që jemi detyruar të bëjmë zgjidhje tjetër deri sa e kemi zgjidhur problemin e furnizimit.

Sa i përket shërbimeve tjera komunale si rrymë dhe ujë në vitin 2020 nuk kemi pasur probleme.

Për ngrohjen e institucionit tonë në vitin 2020 kemi shfrytëzuar kalldajën me naftë nga kompania e cila ka qenë e kontraktuar nga Zyra e Prokurimit në Ferizaj. Furnizimi ka qenë i rregullt dhe me shumë korrektësi nga ana e operatorit për furnizim me derivate për ngrohje.

Aktivitetet e stafit me rezident

Në Shtëpinë e Komunitetit në Ferizaj asnjëherë nuk kanë munguar aktivitete të ndryshme me rezident por prej muajit Mars me paraqitjen e pandemisë Covid-19 për çështje sigurie si dhe mbrojtjen e shëndetit në maksimum të rezidentëve si dhe të stafit nuk kemi mundur të realizojmë këto aktivitete të cilat janë mbajtur zakonisht në Parkun e Lirisë tek pishat poashtu edhe tek Lumi i Nerodimes.

Ndërsa në ambientet e shtëpisë kemi realizuar lojëra të ndryshme, vallëzime etj.

Vizitat e OPS dhe familjarëve të rezidentëve

Sa i përket vizitave nga ana e QPS-ve nuk kemi pasur vizita për shkak të gjendjes së krijuar me Covid-19.

Rezidentët të cilët kanë qenë në gjendje të komunikojnë kanë pasur kontakte me familjarët e tyre kryesisht përmes platformave elektronike të komunikimit.

Sfidat dhe pengesat në punë

Një nga sfidat kryesore të këtij viti ka qenë përballja me pandeminë Covid-19, ku ne si staf shëndetësor jemi përgaditur në maksimum për ruajtjen e shëndetit. Në muajin Nëntor kemi pasur një infermiere të infektuar me virusin Covid-19, pasi bashkëshorti i saj ka qenë i infektuar ne kemi marrë masa që infermierja të hyjë në vetizolim për shkak të dyshimeve se mund ta bartë virusin, pas 7 ditësh ajo ka rezultur pozitiv, për fat të mirë masat që ndërmorëm paraprakisht qenë efektive, kështu që kemi ruajtur gjithë stafin dhe rezidentët. Gjatë kësaj periudhe si masë mbrojtëse kemi bërë dezinfektimin e shtëpisë brenda dhe jashtë dy herë gjatë këtij viti. Për institucionin tonë, sfida ka qenë numri i ulët i stafit, një infermiere ka qenë në pushim lehonie deri në muajin Maj, gjë e cila e ka vështirësuar punën në institucionin tonë. Vlenë të cekët se kemi mungesë edhe për kuzhinier si dhe mirëmbajtës shtëpiak.

Projekti i ndërtimit të depos dhe garazhave

Sa i përket çështjes së depos dhe garazhave janë në përfundim e sipër.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E PRONËS, GJEODEZISË DHE KADASTRIT

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2020

Sabri Murseli
Drejtore i Drejtorisë së Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit

Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë e Komunës së Ferizajt;

Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

Në kuadër të kësaj kjo drejtori është e ndarë në tre sektor; Sektori i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me lëndët e pranuar dhe të administruara nga tre sektorët e Drejtorisë.

Sektori i Kadastrit është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

1 AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

1.1 Në sektorin e Kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- Kërkesa për Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit janë pranuar gjithsej 6540 kërkesa, të miratuara janë 6484, të refuzuara gjithsej janë 56 kërkesa.
- Kërkesa për Regjistrim i Hipotekave janë pranuar 137 nga të cilat janë miratuar 137, kërkesa ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç'regjistrim i Hipotekave janë pranuar 142 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 142, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i Trashëgimeve janë pranuar 335 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 335, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrimi i Shitblerjeve janë pranuar 1398 kërkesa nga të cilat janë miratuar 1374, të refuzuara 24 kërkesa.
- Kërkesa për Regjistrim i Faljeve janë pranuar 401 kërkesa nga të cilat janë miratuar 401, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i këmbimeve dhe ndarjeve fizike janë pranuar 67 kërkesa nga të cilat janë miratuar 67, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i barrave tatimore janë pranuar 7 nga të cilat janë miratuar 7 kërkesa, ndërsa nuk janë refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç'regjistrim i barrave tatimore janë pranuar 4 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 4 kërkesa kurse nuk janë refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa Regjistrim i Masave Siguruese kemi pranuar 6 kërkesa, janë përfunduar 6, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç'regjistrim i Masave Siguruese kemi pasur gjithsej 3 kërkesa, janë përfunduar 3, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Vërtetime për Nevoja Personale i kemi pasur gjithsej 1358 kërkesa, janë përfunduar 1358 kërkesa ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Regjistrim i pronësisë të përbashkët i kemi pasur gjithsej 316 kërkesa, janë përfunduar 316, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

- *STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për sektorin tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.*

Kërkesat e pranuar në sektori Kadastrit gjatë vitit 2020	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë
Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit	6540	6484	56	/
Regjistrim i Hipotekave	137	137	/	/
Ç'regjistrim i Hipotekave	142	142	/	/
Regjistrim i Trashëgimeve	335	335	/	/
Regjistrimi i Shitblerjeve	1398	1374	24	/
Regjistrim i Faljeve	401	401	/	/
Regjistrim i këmbimeve dhe ndarjeve fizike	67	67	/	/
Regjistrim i barrëve tatimore	7	7	/	/
Ç'regjistrim i barrëve tatimore	4	4	/	/
Regjistrim i Masave Siguruese	6	6	/	/
Ç'regjistrim i Masave Siguruese	3	3	/	/
Vërtetime për Nevoja Personale	1358	1358	/	/
Regjistrim i pronësisë të përbashkët	316	316	/	/
Totali	10711	10631	80	/

Totali i kërkesave 10711 lëndëve të pranuar në Sektorin e RDPP-së, gjatë viti ka qenë 10711 kërkesa, të përfunduara janë 10631 kërkesa, dhe janë refuzuar 80 kërkesa për arsye të ndryshme.

SEKTORI I GJEODEZISË është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

• **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA**

1.1 Në sektorin e Gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

• Kërkesa për identifikime janë pranuar gjithsej 20 kërkesa, të miratuara janë 20 ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

- Kërkesa për bashkim të parcelave janë pranuar 226 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 224, ndërsa janë refuzuar 2 kërkesa.
 - Kërkesa për Njoftime për Ngastrën kadastrale janë pranuar 3 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 3, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
 - Kërkesa për identifikimin dhe regjistrimin e njësive banesore janë pranuar 21 kërkesa nga të cilat janë miratuar 21, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
 - Kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri janë pranuar 15 kërkesa nga të cilat janë miratuar 13, një kërkesë është në procedurë, një është pezulluar, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
 - Kërkesa për ndërrim kulture janë pranuar 40 kërkesa nga të cilat janë miratuar 40, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
 - Kërkesa për përmirësimin e parcelave kemi pranuar një kërkesë dhe e njëjta është në procedurë.
 - Kërkesa për përmirësim të katit të njësive banesore është pranuar 1 kërkesë, është miratuar 1 kërkesë, ndërsa nuk është refuzuar asnjë.
 - Kërkesa për Regjistrime të copëtimit kemi pranuar 827 kërkesa, janë miratuar 822, ndërsa janë në proces 5 kërkesa.
 - Kërkesa për Riregjistrim të copëtimit kemi pasur gjithsej 54 kërkesa, janë miratuar 54, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
 - Kërkesa për Rregullim i kufirit janë pranuar 29 kërkesa nga të cilat janë miratuar 28 kërkesa, ndërsa është refuzuar një kërkesë.
 - Kërkesa për Produkte janë pranuar 1027 kërkesa nga të cilat janë miratuar 1021 kërkesa, ndërsa janë refuzuar 6 kërkesa.
 - Kërkesa për Identifikimi të njësisë banesore janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
 - Kërkesa për Përmirësimi të katit banesor janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim të Objektivit - legalizim janë pranuar 80 kërkesa nga të cilat janë miratuar 71 kërkesa, ndërsa janë në procedurë 9 kërkesa.
- Kërkesa për modifikime është pranuar vetëm 1 kërkesë dhe e njëjta është miratuar.

Totali i kërkesave ose lëndëve të pranuar në Sektorin e Gjeodezisë, gjatë vitit 2020 ka qenë 6540 kërkesa, të përfunduara janë 6520 kërkesa, në procedurë janë 16 kërkesa, 1 kërkesë është e pezulluar dhe 3 kërkesa janë refuzuar për arsye të ndryshme.

• **STATISTIKAT**

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Gjeodezisë gjatë vitit 2019	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara -€
Identifikime	20	20	/	/	
Modifikime	1	1	/	/	
Kërkesa për bashkim të parcelave	226	224	2	/	

Kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri	15	13	/	2	
Kërkesa për ndërrim kulture	40	40	/	/	
Përmirësime të numrave të parcelës	1	1	/	1	
Regjistrim i copëtimit	827	822	/	5	
Riregjistrim i copëtimit	54	54	/	/	
Rregullim i kufirit	29	28	1	/	
Produkte kadastrale	1075	1073	2	/	
Përmirësimi i katit banesor	1	1	/	/	
Regjistrimi i njësisë banesore	21	21	/	/	
Kopje të Planit	3470	3470	/	/	
Kopje të Planit Zyrtare	680	680	/	/	
Regjistrim i objektit	80	71	/	9	
TOTALI	6540	6520	3	16	Pezulluar 1

Spektori i Pronës merret me menaxhimin e pronave komunale, ku përfshihet mbajtja e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna, me zhvillimin e procedurës së shpronësimit, këmbimit të tokës në pronësi të Komunës me tokën e personave privat të planifikuar për interes publik, si dhe me trajtimin dhe zhvillimin e procedurave administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

1. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA -

1.1 Në Sektorin e Pronës janë pranuar kërkesat në vijim:

- Në lëmin e uzurpimeve janë pranuar gjithsej 115-kërkesa të përfunduara janë 95, në procedurë 20 kërkesa.
- Në lëmin e destinimeve janë pranuar 205 kërkesa, janë përfunduar 177, në procedurë janë 28 kërkesa.
- lëminë e shpronësimeve janë pranuar 21 kërkesa, të përfunduara 6, në procedurë janë 15 kërkesa.

STATISTIKAT-

Kërkesat e pranuarat në sektorin e Pronës gjatë vitit 2019	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara-shpenzuara €
Uzurpime	115	95		20	
Destinime dhe përgjigje në kërkesa	205	177		28	
Shpronësime	21	6		15	
Totali	341	278		63	

· Në lëmin e uzurpimeve bëjnë pjesë: inçizimet gjeodezike dhe caktimet e kufijeve të Rrugëve, Lumenjëve, Objekteve Shkollore, Objektëve Shëndetësore, Zyrave të Gjendjes Civile etj, të gjitha ato të cilat janë të poshtshënuara.

- Inçizimi i ngastrave dhe caktimi i pikave kadastrale në:
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3554-0 Zk. Komogllavë
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 500-2 Zk. Ferizaj
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2079-0 Zk. Rahovicë
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3091-0 Zk. Ferizaj
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 629-1 Zk. Babush i Ri
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 323-0 Zk. Muhoc
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2961-4Zk. Komogllavë
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 174-15 Zk.Talinoc i Muhaxherëve
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 33-3 dhe 34-3 Zk. Muhoc
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1085-17 Zk.Ferizaj
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1740-5, 1740-8 dhe 1741-2 Zk.Pleshinë
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 809-2 dhe 810-1 Zk. Talinoc i Muhaxherëve
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 728-0 dhe 729-0 Zk. Nikadin
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1060-4 Zk. Talinoc i Muhaxherëve
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3228-0 Zk. Ferizaj
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 920-0 Zk. Babush
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3574-17 Zk. Jezerc
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1978-1 dhe 347-0 Zk. Jezerc
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3201-0 Zk. Ferizaj
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3598-1,2025-0 dhe 345-0 Zk. Jezerc
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 755-7,755-8 dhe 755-9 Zk. Pojatë
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3574-18,2021-0 dhe 306-3 Zk. Jezerc
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3251-0 Zk. Ferizaj
 - Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 755-3,755-4,755-5 dhe 755-6 Zk. Pojatë

- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 185-0,186-0Zk. Prelez i Jerlive
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 884-2 Zk. Bablak
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1496-2 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 883-2 dhe 1312-4 Zk. Zaskok
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 176-0,182-0dhe 184-0 Zk. Prelez i Jerlive
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 486-23 dhe 486-25 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2955-4 dhe 3057-6 Zk.Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 776-1 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3210-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 297-1 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 412-1dhe 412-2 Zk. Nikadin
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 413-1 dhe 413-2 Zk. Nikadin
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 898-0 Zk. Nikadin
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 454-0 Zk. Pojate
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 694-0 Zk. Pojate
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2785-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 565-2 dhe 566-0 Zk. Babush i Ri
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 565-1, 564-0 dhe 563-0 Zk. Babush i Ri
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 201-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 142-0 Zk. Nerodime e Poshtme
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1094-2 Zk. Jezerc
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 240-1 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 437-5 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 132-3 Zk. Sojevë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 379-15 dhe 384-25 Zk.Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3043-2 Zk. Greme
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2850-9 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1200-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1140-3 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 78-0,47-0 dhe 46-0 Zk.Pojatë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 500-3 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 496-3 dhe 500-2 Zk.Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 45-0,44-0,43-0 dhe 42-0 Zk.Pojatë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1553-1Zk.Komogllav
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2523-0 Zk. Balaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 547-1 Zk.Pleshinë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 36-1 Zk. Burrnik
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 53-0,75-0,50-0 dhe 48-0 Zk.Pojatë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1893-3 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 390-0 Zk. Burrnik
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 92-1 Zk. Fshati Vjeter
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2474-0 Zk. Komogllavë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1055-5 dhe 1055-7 Zk. Prelez i Jerlive
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1053-1,1055-0 dhe 2121-0 Zk.Dardani

- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 211-3 dhe 211-4 Zk.Manastirc
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3115-0,3116-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1042-83 dhe 1042-94 Zk.Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 188-34 dhe 188-35 Zk.Nikadin
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 547-1 Zk. Pleshinë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 861-1,649-0 dhe 782-0 Zk. Dardani
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 634-2 Zk. Koshare
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 131-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 21-23 Zk. Nikadin
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 730-5 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 323-0 Zk. Muhoc
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3963-1 Zk. Komogllavë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1260-2 Zk. Komogllavë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 710-0 dhe 1150-0 Zk. Zaskok
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2670-0 Zk.Komogllavë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 186-6 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1211-3 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1110-8 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 464-1 Zk. Talinoc i Jerlive
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 528-11 Zk. Talinoc i Jerlive
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1990-2 dhe 1974-0 Zk.Mirosalë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1158-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 3554-0 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2079-0 Zk. Rahovicë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 770-0 Zk. Burnik
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 81-1 Zk. Slivovë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1577-0 Zk. Komogllavë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 2912-0 Zk. Komogllavë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 581-0 Zk.Rahovicë
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 1165-1 Zk. Ferizaj
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 475-0 Zk.Babush i Ri
- Inçizimi i ngastrave kadastrale me numër 527-2 Zk.Varosh

Në lëmin e destinimeve: bëjnë pjesë propozim-vendimet për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm, propozim- vendimet për kembimin e pronave komunale me pronat private, propozim-vendimet për ndarjen e pronave komunale, propozim-vendimet për dhënien në shfrytëzim etj.

Kërkesat drejtuar Ministrisë së Financave- Departamentit të Tatimit në Pronë-ZVPP-së për parcelat të cilat janë në fazën e vlerësimit të tokave si në lëmin e shpronësimit ashtu edhe në lëmin e këmbimit të pronave, përgjegjet në kërkesa të ushtruar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit për parcelat të cilat janë në fazën e likuidimit, kërkesat të cilat kanë ushtruar qytetarët për ri-regjistrimin e parcelave, kërkesat e qytetarëve për

faljen e paluajtshmërive të tyre për rrugë, varreza, etj, kërkesat brenda sektorëve drejtuar kadastrit dhe gjeodezisë për zbatim të vendimeve në RDPP, certifikata të pronës, produkte, kërkesë për copëtime etj.

Propozim-vendime për Kuvend: 21

- Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale 892-2 me pjesën kadastrale 910-1 Zk.Babush i Ri
- Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale 2080-1, 2066-1 Zk Mirosalë me pjesën e ngastrës kadastrale 1053-1 Zk.Dardani
 - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale 314-1,314-2 dhe 314-3 me pjesën e ngastrës kadastrale 545-1 Zk.Papaz
 - Vendim për ndarjen e pjesës së ngastrës kadastrale nr 529-0 Zk Ferizaj për ndërtimin e Pishinës Publike Gjysmë-Olimpikë
 - Vendim për dhënie për shfrytëzim të ngastrës kadastrale 338-2 Zk Varosh
 - Vendim për ndarjen e ngastrës kadastrale 856-1 Zk Babush i Ri
 - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale 496-14,500-4 dhe pjesa e ngastrës 500-6 Zk.Ferizaj me pjesët e ngastrave 180-1 Zk. Talinoc i Jerlive
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për pjesën e ngastrës kadastrale 400-0 Zk. Talinoc i Muhaxherëve.
 - Vendim për ndarjen e pjesës së ngastrës kadastrale 228-1 Zk Prelez i Muhaxherëve
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të objektit (pompë e derivateve Jugopetrol) të ndërtuar në ngastrën kadastrale 2764-1 Zk Ferizaj
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngastrave kadastrale 508-0, 527-0 dhe 528-0 zona kadastrale Dremjak
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 2254-0,2518-0,2520-0,2523-0,2641-0,2642-0,2647-0,2643-0,70-0,67-0,72-0,71-0,2062-2 dhe 2069-0 Zk. Jezerc.
 - Vendim për ndarjen e pjesës së ngastrës kadastrale 2529-0 Zk Mirash
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 1678-0,1839-0 dhe 1840-0 Zk Mirosalë
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesëve të ngastrave 614-0,621-0 dhe 622-1 Zk. Sojevë
 - Vendim për shpalljen e interesit të përbashkët të pjesëve të ngastrave kadastrale 1243-0,1244-0 dhe 1245-3 Zk Sojevë
 - Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 1791-0 Zk.Pleshinë

Në lëminë e shpronësimeve: Bëjnë pjesë lëndet të cilat janë në Gjykatën Themelore në Ferizaj në kuadër Vendimeve Përfundimtare të Shpronësimit, respektivisht rritjes së shpërblimit për tokat e shpronësuara, lëndë të cilat janë për vlerësim në MF. Po ashtu kemi filluar përgatitjet e lëndëve për zhvillimin e procedurave administrativo - juridike për shpronësimin e parcelave të cilat janë; në Zk. Jezerc (Memorial i UÇK-së), në Zk. Greme pusi i ujit, shpronësimi i rrugës Metush Krasniqi II, shpronësimi i rrugës Mirosalë II, shpronësimi i rrugës Sojevë, etj.

Po ashtu gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2020 kemi pasur 43 përfaqësime në Gjykatën Themelore në Ferizaj për çështjet pronësore-juridike respektivisht rritjen e vlerës së shpërblimit të pronave të shpronësuar me Aktvendime të Gjykatës Themelore dhe lëndë të cilat janë proces ne mesin e tyre bëjnë pjesë;

-Xhemajl dhe Behar Fejzullahu për ng.kad. 496-1 Zk. Ferizaj me sipërfaqe prej 227 m²

-Milot Misini nga Ferizaj për ng.kad. 1055-7 Zk. Prelez i Jerlive me sipërfaqe prej 5450 m²

-Ymer Mehmeti etj nga Ferizaj për ng.kad. 465-38 Zk. Ferizaj me sipërfaqe prej 11 m².

-Halil Fazliu nga fshati Nikadin për ng.kad.195-1 Zk. Nikadin me sipërfaqe prej 102 m².

-Bedri Blenishti nga fshati Zaskok për ng.kad.206-3 me sip. prej 226 m², 206-4 me sip. prej 130 m² dhe ng.kad. 206-1 me sip.38 m² Zk. Zaskok.

-Ekrem Selmani nga Ferizaj për ng.kad. 469-4 Zk. Ferizaj me sipërfaqe prej 192 m².

-Sadri Gashi nga Ferizaj për ng.kad. 496-7 Zk. Ferizaj me sip. prej 63 m².

-Zenun Fazliu nga Ferizaj për ng.kad.295-2 Zk. Ferizaj me sip. 83 m².

-Njazi Ferizi nga Ferizaj për ng.kad. 173-2 Zk. Zaskok me sip. 673 m².

- Labinot Krasniqi nga Talinoc i Muhaxherëve për ng.kad. 227-0 Zk. T. Muhaxherëve me sip. prej 616 m².

-“Mabetex Holding”. SH.P.K rrethoja e objektit me sipërfaqe prej 580 m.

-“Mabetex Holding”. SH.P.K per ng.kad. 497-2 Zk. Ferizaj me sip. prej 2400 m² dhe ng.kad.631-1 me sip. prej 539 m², ng.kad. 689-2 me sip. prej 204 m² dhe ng.kad. 632-0 me sip. 1688 m² Zk. T. i Jerlive.

-Sadulla Sylja nga Ferizaj për ng.kad.446-3 Zk. Ferizaj me sip.65m².

-Daut Rexhepi nga Ferizaj për ng.kad 879-1 Zk Ferizaj me sip.532m², ng.kad 879-15 me sip.24m², ng.kad. 879-16 me sip 5m² dhe ng.kad.879-2 me sip.115m².

-Bashkim Mehmeti nga fshati Nikadin për ng.kad.185-3 Zk Nikadin me sip.60 m².

-Fatmir Hamdiu nga Ferizaj për ng.kad 1083-0 Zk Talinoc i Muhaxherëve me sip.623m².

-Ramadan Avdyli etj nga fshati Pleshinë për ng.kad.176-2 Zk Zaskok me sip 249m² dhe ng.kad 177-0 me sip 130m² Zk Zaskok.

-Ramadan Salihu nga Ferizaj për ng.kad 3085-4 Zk Ferizaj me sip.75m², ng.kad.3085-3 me sip 23m², ng.kad 3585-2 me sip 81m² dhe ng.kad.3085-1 me sip.19m²

-Valdete Hyseni nga fshati Bibaj për ng.kad 512-2 me sip350m² Zk Ferizaj.

- **Deklarata për Falje 22**

- Deklaratë për falje nga Menderez Gajtoni të ngastrës kadastrale 1085-1 me sip.305m² Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Ramiz Sherifi, Tahir Tahiri per ng.kad.2960-3, me sip 17 m² Zk. Komogllavë
- Deklaratë për falje nga Bekim, Afrim, Ismet ,Emin dhe Fatmir Fetahu për ng.kad. 174-15 me sip. 1625m², Zk. Talinoc i Muhaxherëve.
- Deklaratë për falje nga Sherif, Ali dhe Hamdi Rexhepi për ng.kad. 33-3 me sip. 716 m² dhe 3234-3 me sip. 685 m² Zk. Muhoc

- Deklaratë për falje nga Ahmet Hamzaj, Mirdita Ramadani, ng.kad.1741-2 me sip. 12 m²,1740-5 me sip 236 m²dhe 1740-8 me sip264m² Zk. Pleshinë.
- Deklaratë për falje nga Halil Osmani për ng.kad810-1 me sip. 47 m², 809-2 me sip.35 m² Zk.Talinoc i Muhaxherëve.
- Deklaratë për falje nga Alush Berisha dhe Sefa Ramadani, ng.kad. 728-0 me sip. 747 m²dhe 729-0 me sip 480 m² Zk. Nikadin
- Deklaratë për falje nga Asllan Spahiu, ng.kad. 1060-4 me sip. 410m² Zk. Talinoc i Muhaxherëve
- Deklaratë për falje nga Fazli Obrazhda, ng.kad. 3228-0 me sip.167m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Alil Llabjani , ng.kad. 920-0 me sip. 307 m²,Zk. Babush
- Deklaratë për falje nga Rexhep Azemi etj, ng.kad. 3201-0 me sip. 295m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Imrija Latifi , ng.kad. 3251-0 me sip. 544 m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Emri Aliu , ng.kad. 755-8 me sip.1316 m², Zk. Pojatë.
- Deklaratë për falje nga Milaim Mihalica etj, ng.kad. 186-0 me sip. 33m²,185-0me sip 68m² ,184-0 me sip50 m² ,183-0 me sip41m²,182-0 me sip 213 m², 176-0 me sip91 m² Zk. Prelez i Jerlive dhe ngastra kad.884-2 me sip 585m² Zk Bablak .
- Deklaratë për falje nga Bashkim Mehmeti , ng.kad. 883-2 me sip. 575m² dhe ng.kad.1312-4 me sip.368m² Zk. Zaskok
- Deklaratë për falje nga Shemsi Qerkini dhe Rasim Reshani , ng.kad.486-23 me sip. 99m² dhe ng.kad.486-25 me sip.235m²,ng.kad 2955-4 me sip.121m² dhe ng.kad.3057-6 me sip.383m² Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Selim Ashani , ng.kad. 776-1 me sip. 286 m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Fatlum Agushi , ng.kad.3210-0 me sip. 121m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Mehdi , Nexhatdhe Gani Dervishi , ng.kad. 823-4 me sip.314 m² dhe ng.kad 102-14 me sip 757 m²Zk. Nikadin
- Deklaratë për falje nga Hetem Luzha , ng.kad.379-15 me sip. 518m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Avni Murseli, ng.kad. 3255me sip. 575m², Zk. Ferizaj
- Deklaratë për falje nga Bardhyl Qerkini, ng.kad.3221 me sip. 1528m²,ng.kad 480-11 me sip.280m² dhe ng kad. 480-15me sip 125m² Zk. Ferizaj.
- Gjatë periudhës një vjeçare Janar- Dhjetor 2020 ne Sektorin e Pronës vullnetarisht pronarët e paluajtshmërive në zonen urbane dhe rurale kanë falur pronat e tyre për rrugë me sipërfaqe totale prej 1.55.74 m² ose (01.55.74 ha).

Spektori i Pronës gjatë periudhës njëvjetore Janar-Dhjetor (2020) ka kryer edhe keto punë:

- Përfaqësime në Gjykatën Themelore në Ferizaj në cilësinë e përfaqësuesit juridik 43.
- Përgjigje në padi, me paditë e ushtruar në Gjykatë lidhur me shpronësime 12
- Pagesa të shpronësimeve 34
- Pagesa të furnitorëve 24
- Pagesa e punëtorëve me kontratë mbi vepër 30
- Formularë për furnitorë sistem 40



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Burim Bajrami
Drejtore i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në kuadër të aktivitetit të saj ka në përbërje katër njësi:

- Njësinë e Lavërtarisë,
- Njësinë e Blegtorisë,
- Njësinë e Zhvillimit Rural,
- Njësinë e Pylltarisë,

Të gjitha këto njësi kanë në kuadër të tyre staf të përgatitur profesional dhe aktivitetin e tyre e zhvillojnë konform rregullave dhe ligjeve të parapara në këtë sektor.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë periudhës raportuese në vazhdimësi ka zbatuar politikat sektoriale sipas:

- Strategjive zhvillimore,
- Planit të punës së Drejtorisë të hartuar për vitin 2020,
- Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës 2014 – 2020,
- Planit Zhvillimor Komunal,
- Vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe sipas kërkesave të qytetarëve.

Aktivitetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe janë fokusuar kryesisht në realizimin e subvencioneve dhe projekteve si dhe në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave në lëmi të ndryshme të fermerëve.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë vitit 2020 ka zhvilluar këto aktivitete:

1. Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me fidane të perimeve -

Fermerët janë subvencionuar për fidane të perimeve, fermerët përfitues furnizimin me fidane të perimeve apo kultivimin e tyre e kanë bërë vetë, ndërsa kompenzimin e pagesës apo shpenzimeve e ka bërë Drejtoria e Bujqësisë, përfituesve u janë pranuar nga 4 fidane/m² me çmim deri 0.25€/fidan. **Përfitues kanë qenë 34 fermerë, me gjithsej 56,000 fidane të perimeve që kultivohen në sipërfaqe prej 14000m² serrë.**

2. Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore- pleh artificial i kombinuar NPK 15:15:15

Përfitues të këtij subvencionimi kanë qenë 375 fermerë që kanë mbjellë grurë në vjeshtën e vitit 2019. Sasia e tërësishme e plehut ishte 150,000kg (6000thasë nga 25kg) për një sipërfaqe prej 2545ha. Shpërndarja e plehut është bërë në mënyrë proporcionale bazuar në sipërfaqen që kishin të mbjellur fermerët e Komunës së Ferizajt.

3. Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë

Projekti i ngritjes së serrave është realizuar me pjesëmarrje të fermerëve me 25%, ndërsa 75% e vlerës është subvencionuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë. Janë ngritur 146 serra me sipërfaqe 50m², dhe 16 serra me sipërfaqe 300m².

Në këtë subvencionim është përfshirë konstruksioni i serrës, folia, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes.

4. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra- Me këtë subvencionim janë ngritur 18ha me pemishte të arrave, përfitues kanë qenë 36 fermerë me nga 0.50ha. Subvencionimi ka qenë në sigurimin e fidaneve dhe të sistemit të ujitjes për pemishtet që do të ngriten.

5. Përkrahja e fermerëve me mekanizim bujqësor

Me realizimin e këtij projekti janë përkrahur 78 fermerë me nga një pajisje bujqësore varësisht nga veprimtaria e tyre. Fermerët janë përkrahur me këto pajisje:

Nr.	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Mbjellëse gruri me 16 rende	copë	7
2	Mbjellëse misri pneumatike 4 rendëshe	copë	6
3	Kosa roto 135	copë	13
4	Freza 1.6 M	copë	16
5	Plugj dyrendësh	copë	10
6	Shpërndarëse të plehut 350 litra	copë	13
7	Grabuja diellore	copë	13

6. Furnizimi i fermerëve me sistem të ujitjes pikë-pikë - me realizimin e këtij projekti janë përkrahur 40 fermerë kultivues të pemëve dhe perimeve me sistem të ujitjes pikë-pikë. Në këtë projekt janë përfshirë të gjitha pajisjet e nevojshme të sistemit të ujitjes për kultivimin e 0.50 ha pemishte apo për kultivimin e 0.15ha perime.

7. Përkrahja e fermerëve me pajisje - sistem kundër breshërit

Ferizaj është e vetmja Komunë që realizon projektin për sistem kundërbreshërit. Me këtë projekt do të përfshihet sipërfaqja prej 4 ha pemishte. Të gjitha furnizimet nga Operatori Ekonomik tek fermerët janë kryer, për shkak të kushteve jo të përshtatshme – thatësisë, montimi i sistemit ende nuk është kryer, edhe me kontratë është paraparë që montimi të kryhet në pranverë kur lejojnë kushtet atmosferike.

8. Organizimi i trajnimeve për fermerët në lëmi të ndryshme – gjatë implementimit të këtij projekti janë organizuar trajnime në nëntë lëmi të ndryshme, janë mbajtur trajnime praktike dhe vizita në terren. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur një broshurë rreth temave të trajnimit dhe rreth aktiviteteve të Drejtorisë. Është organizuar një takim gjithëpërfshirës me shumë akterë që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë me temën: Sfidat dhe perspektiva e zhvillimit të bujqësisë në Komunën e Ferizajt.

9.Trajtimi i lopëve të qumështit kundër endoparazitëve- Parazitët paraqesin problem të vazhdueshëm në shëndetin e këtyre kafshëve duke u përcjellë me humbje të mëdha ekonomike. Mbrojtja apo parandalimi kundër parazitëve përmes trajtimit me medikamente përbën një rëndësi të veçantë për faktin se humbjet ekonomike të fermerëve do të jenë shumë më të vogla. Drejtoria e Bujqësisë e ka realizuar projektin për trajtimin e lopëve të qumështit në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale kundër endoparazitëve. Janë trajtuar 2000 krerë lopë të qumështit.

10.Trajtimi i bagëtive të imëta (dele,dhi) kundër endoparazitëve- Drejtoria e Bujqësisë e ka realizuar projektin për trajtimin e bagëtive të imëta në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale kundër endoparazitëve . Janë trajtuar 12300 krerë **dele, dhi**.

11.Vaksinimi i fondit blegtoral - Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar projektin për vaksinimin gjedheve, deleve dhe dhive kundër sëmundjeve clostridiale në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale. Janë vaksinuar 4200 krerë gjedhe dhe bagëti të imëta (dele dhe dhi) 13578 krerë. Arsyeja e realizimit të këtij projekti është bërë nga se ky vaksinim parandalon sëmundjet infektive duke bërë që humbjet ekonomike në fermat e fermerëve të jenë shumë më të ulëta, rritjes së kualitetit të prodhimit dhe shëndetit të mirë të kafshëve me këtë edhe të njeriut duke konsumuar prodhime të shëndosha të mishit dhe qumështit të këtyre kategorive të kafshëve të imëta.

12.Vaksinimi i qenve me pronarë - Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka bërë imunizimin apo vaksinimin e qenve me pronarë kundër sëmundjes së tërbimit. Tërbimi është një sëmundje e rrezikshme dhe ne si Komunë e kemi mbështetur projektin “Vaksinimin e qenve me pronarë”. Ne, kemi shërbimin (Therrjet) ndërsa vaksinat i ka siguruar AVUK (Agjensioni i Veterinës). Përfitues të këtij projekti janë të gjithë pronarët e qenve shtëpiak. Janë vaksinuar 2989 qen me pronarë.

13.Rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore- Sëmundjet e thundrrave ndikojnë në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtorale ku vjen deri tek rënia e prodhimtarisë e njëherit edhe tek humbjet ekonomike në ferma. Është bërë rregullimi i thundrrave tek 2800 krerë lopë qumështore.

14.Repelimi i gjedheve (lopëve të qumështit, mështjerrave dhe viçave) kundër sëmundjeve virale e parazitare nga insektet e ndryshme-Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka realizuar projektin “Repelimi i gjedheve” (lopëve të qumështit, mështjerrave dhe viçave) në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale të Komunës së Ferizajt. Kjo masë preventive nënkupton trajtimin e kafshëve përmes repelentëve adekuat me qëllim parandalimin e bartjes së sëmundjeve nga insektet në gjedhe si atyre virale e parazitare. Me repelim bëhet sidomos parandalimi i babeziozës si sëmundje parazitare mjaft problematike duke shkaktuar humbje të mëdha ekonomike tek fermerët sepse një numër i tyre përfundon me fatalitet. Janë repeluar 3800 krerë gjedhe.

15.Repelimi i deleve kundër sëmundjes Gjuha e Kaltërt - Kjo masë preventive nënkupton trajtimin e deleve përmes repelentëve adekuat me qëllim parandalimin e bartjes së sëmundjeve virale nga insektet artropode (mushkonjat). Me repelim bëhet sidomos parandalimi i shfaqjes së sëmundjes virale infektive „Gjuha e Kaltërt” mjaft problematike e cila shkakton humbje të mëdha ekonomike tek fermerët sepse një numër i këtyre kafshëve (deleve) përfundon me fatalitet. Janë repeluar 13000 krerë dele në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale.

16. Subvencionimi i fermerëve me koshere të bletëve– Komuna e Ferizajt, është duke i kushtuar rëndësi shumë të madhe bletarisë. Bletaria paraqet një mundësi reale të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Produktet e bletës janë të pasura me vitamina e minerale, që i bëjnë ato të kenë rolin më shumë se sa ushqimor rol kurativ, terapeutik, dietal etj. Një përkrahje e fermerëve me koshere të bletëve do të ndikoj në zhvillimin më të madh të kësaj lëmie. Janë përkrahur me koshere dy katëshe të kombinuara dru dhe plastik fermerët të cilët kanë mbi 30 zgjoje të bletëve. Janë shpërndarë 400 koshere tek 134 fermerë. Realizimi i këtij subvencionimi është me pjesëmarrjen e fermerëve me 20%, në vlerën e tërësishme të projektit.

17. Furnizimi i fermerëve me lopë të racës simental- Drejtoria e Bujqësisë në mbështetje të mbarshkuesve të fondit blegtoral ka nënshkruar kontratën për subvencionimin e fermerëve me krerë të lopëve të racës Simental. Janë furnizuar 75 fermerë me nga një lopë të racës simental. Realizimi i këtij subvencionimi është bërë me pjesëmarrjen e fermerëve me 25%, në vlerën e tërësishme të projektit.

18. Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave -Që ferma të jetë rentabile, përveç ushqimit të mirë, patjetër që duhet të investohet në përzgjedhjen e drejtë të racës së kafshës me këtë mundësohet kontrolli i sëmundjeve infektive dhe trajtimi i problemit të fertilitetit të ulët. Me material gjenetik do të mbarësohen të gjitha lopët dhe mështqerrat e komunës sonë. Ky projekt është në implementim dhe ka kohëzgjatje 24 muaj por deri më tani për vitin 2020 janë mbarësuar 6000 krerë.

19. Rregullimi i rrugëve të arave me zhavor- është projekt trevjeçar, është duke vazhduar, deri tash është arritur të rregullohen këto rrugë: në fshatin Bibaj rruga me gjatësi 577m dhe gjerësi 4m, në fshatin Dardani rruga me gjatësi 351m dhe gjerësi 4m, në fshatin Prelez rruga me gjatësi 800 m dhe gjerësi 4m, në fshatin Bablak rruga me gjatësi 430 m me gjerësi 4m, në fshatin Rahovicë rruga me gjatësi 1700 m me gjerësi 5m.

20. Rregullimi i Tregut të Kafshëve dhe ndërtimi i Strehimores për Qentë Endacak- është projekt trevjeçar, punët kanë filluar sipas dinamikës së planifikuar.

Pas implementimit të projekteve të planifikuara, nga mjetet e mbetura nga kontratat me Operatorët Ekonomik, Drejtoria e Bujqësisë ka marrë vendim që me ato mjete të realizoj edhe tri projekte që tek ne nuk janë realizuar asnjëherë e këto janë:

21.Furnizimi i fermerëve me spërkatëse me kapacitet prej 45 l - me këtë projekt janë janë 55 fermerë përfitues me nga një spërkatëse, kryesisht janë kultivues të perimeve në serra.

22.Furnizimi i fermerëve me makina për shtrirjen e folisë dhe sistemit të ujitjes pikë-pikë – me realizimin e këtij projekti me nga një makinë për shtrirjen e folisë janë furnizuar 6 fermerë që janë kultivues të perimeve në serra me sipërfaqe mbi 30 ari dhe të dredhëzave në fushë të hapur.

23.Furnizimi i fermerëve me centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit – Për një cilësi të produkteve të mjaltit rol të rëndësishëm ka përdorimi i pajisjeve për bletë e sidomos makinat për nxjerrjen e mjaltit. Me këtë projekt janë furnizuar 27 fermerë me nga një centrifugë elektrike.

Realizimi i projekteve në bashkëfinancim me donatorë

24.Ngritja e pemishteve me qershia- ky projekt është realizuar në bashkëfinancim me IKC-në. Janë ngritur 15 pemishte me sipërfaqe prej 0.25ha, gjithsej 3.75ha.

25. Furnizimi i fermerëve me pajisje – mjete bujqësore – ky projekt është realizuar me bashkëfinancim në mes të Organizatës "Qatar Charity" dhe Komunën e Ferizajt. Kanë qenë 33 fermerë përfitues me këto përkrahje: 18 serra, 6 freza, 5 motokultivatorë, 3 krerë lopë dhe një tufë delesh prej 10 krerësh.

- Sipas kërkesave të fermerëve janë bërë vlerësimet e humbjeve të fermerët për shkak të pandemisë dhe vlerësimet e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.
- Janë monitoruar të gjitha projektet dhe subvencionet e realizuara nga viti paraprak dhe gjatë këtij viti.

- **Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - kryhet në zyret e Drejtorisë së Bujqësisë. Kjo fazë ka zgjatë mbi dy muaj, ishte një punë shumë voluminoze, këtë vit për shkak të pandemisë ishte shumë e vështirë dhe me rrezikshmëri, tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ishte i angazhuar në kryerjen e këtyre punëve:**

- *Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione,
- *Përcaktimi i termineve të fermerëve,
- *Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve,
- *Regjistrimi në Regjistrin e Fermës,
- *Digjitalizimi i parcelave në ELPIS,
- *Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2020 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 1070 fermerë për këto subvencione: lopë 2416 krerë, dele 9254 krerë, dhi 475 krerë, pula 86300 copë, bletë 9586 zgjoje, grurë 3066ha, misër 2070 ha, thekër 6 ha, molla 61 ha, mjedra 58 ha, kumbulla 15 ha, patate 40 ha, kunguj 152 ha, qepë 16 ha, shalqinjë 3 ha, lakra 3.5 ha , aronija 4 ha, manaferra 2 ha, arra 34 ha, vishnje 2 ha, lajthia 21 ha, dredhëza 7 ha, fasule 21 ha , domate 1 ha, specia 2 ha, marulla 1ha.

- Subvencionimi i fermerëve për sasi dhe cilësi të qumështit nga MBPZHR që bëhet për çdo tre muaj, aplikimi me të gjitha procedurat është bërë në Drejtorinë e Bujqësisë, ku kriter është të kenë sasinë së paku 1500 l/për tre muaj .

Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë bërë:

- Pagesat për të gjitha subvencionet e realizuara,
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave,
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara,
- Pagesat e participimit të fermerëve gjatë realizimit të subvencioneve,
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore,
- Janë bërë përgatitjet për korrije-shirje,
- Jemi të kyçur në komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale,
- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj Drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjedhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

- Mbajtja e trajnimeve është një instrument i rëndësishëm për realizimin e politikave të zhvillimit të bujqësisë. Trajnimet me komunitetin e fermerëve janë bërë me forma të ndryshme komunikimi dhe me një sërë aktivitete. Janë mbajtur trajnime me fermerë në sektor të ndryshëm të bujqësisë me tema mbi: teknikat dhe teknologjitë për prodhimin bimor dhe blegtoral, impute cilësore, menaxhimin e fermës, kooperimin e fermerëve, plane biznesi, mundësitë e kreditimit, marketingun e prodhimeve bujqësore, çmimet e tregjet, potencialet prodhuese, mundësitë e përpunimit, prognoze-sinjalizimin i sëmundjeve dhe dëmtuesve, sigurinë ushqimore, etj. Janë shpërndarë rreth 1000 broshura dhe fletëpalosje fermerëve për tema të ndryshme të përgatitura nga Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike. Misioni i këtij shërbimi është siguri dhe ofrimi i informacionit dhe njohurive teknike dhe ekonomike për rritjen e prodhimit dhe të ardhurave për kategoritë e ndryshme fermerësh.

Njësia e Pylltarisë

	Objekti	Aktivitetet	Rezultatet
Njësia e Pylltarisë Ferizaj	1. Mbrojtja e Pyjeve	<i>Rojet e pyjeve kanë ngritur</i>	Fletëparaqitje Penale –133 lëndë me vëllim 431.91 m ³ në vlerë 61416.09 €
			Fletëparaqitje për Kundërvajtje-350 lëndë me vëllim 551.45 m ³ në vlerë 76335.41 €.
			Gjithsejt fletëparaqitje: Fletëparaqitje-483 copë Vëllimi – 983.36 m ³ Vlera – 137748.50 €
		<i>Konfiskimi i masës drusore</i>	Dru zjarri- 178.30m ³ .
			Dru teknik–0.0 m ³
			Nga masa drusore e konfiskuar sipas Vendimit të KK të Ferizajt me 01.Nr.128/20 të datës 24.11.2020 me dru zjarri janë furnizuar 10 familje skamnore me nga dy metra dru. ri.
		<i>Janë zhvilluar –</i> Janë zhvilluar 200 kontrole dhe monitorime të pyjeve publike në rrugët pyjore dhe jopyjore. Kontrole janë bërë te Lumi i Madh, Lumi i Vogël, te Livadhet e Papazit, te livadhet e Burrnikut, në fshatin Pleshinë e Epërme (te podi, te kurtaliqët). Policia në 20 raste ka has në transportues ilegal të druve në	

		rrugë. Katër aksione janë bërë në tregun e druve në qytet, te Plus Marketi. <i>Takimet e mbajtura-</i> <i>Potenconi nëse keni aktivitete në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe sëmundjet.-Gjatë këtij viti në pyjet e Ferizaj gjatë muajve të pranverës sidomos gjatë muajit Prill janë shfaqur disa zjarre dhe atë: në pyjet e rajonit të Dremjakut, në pyjet e rajonit të Pleshinës dhe të Burrnikut. Zjarret kryesisht kanë përfshirë drunjët të llojit qarr, dushqe etj. Sipërfaqja e përgjithshme e përfshirjes së zjarreve ka qenë rreth 32.70 hektarë. Zjarret kanë qenë sipërfaqësore. Në fikjen e zjarreve kanë marrë pjesë rojet e rajonit, zjarrëfikësit si dhe në rajonin e Dremjakut ku ishte përhapur zjarr më i madh në ndihmë na kanë dalë edhe punëtorët sezonal të APK-së.</i> <i>Seancat gjyqësore-Gjatë këtij viti janë mbajtur mbi 200 seanca në Gjykatën Themelore –Divizioni Penal në Ferizaj.</i> Aktgjykimet e pranuar nga Gjykata Themelore-Divizioni Penal. Gjithsej-189 aktgjykime. Pozitive-128, Të pezulluara-58 dhe negative-3. Aktvendimet e pranuar nga Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje. Gjithsej-294 aktvendime Pozitive-198, Të pezulluara-95 dhe negative -1.
	2. Masat Silvikulturore	<i>Aktivitetet në shfrytëzimin e pyjeve publike, damkimin, realizimin etj.</i> Sipas planeve menaxhuese të APK-së për vitin 2020 për shitjen e druve me pakicë në Njësinë Menaxhuese të Zhegocit është realizuar ky plan i shfrytëzimit për këtë vit. Ngastra 24 (pisha të rrëzuara) është realizuar kjo masë drusore, dru teknik-27.0 m³ dhe dru zjarri 9.18 m³. Ngastra 25 (pisha të thata) është realizuar kjo masë drusore: dru zjarri 37.05 m³. <i>Aktivitetet në shfrytëzimin e pyjeve private-</i> Janë shqyrtuar 33 kërkesa. Nga APK-ja janë damkosur 794.52 m³ dru zjarri dhe 131.29 m³ dru teknik. Leje për prerje: Janë lëshuar 33 leje për prerje, 24 leje janë

		lëshuar nga damkosja e APK-së për toka pyjore private, ndërsa 8 leje tjera janë lëshuar për tokë jopyjore (toka bujqësore, kullosa etj) me vëllim prej: dru zjarri- 715.61 m³, dru teknik- 56.16 m³. Janë vulosur: Dru zjarri-982.49 m³ dh dru teknik-57.14 m³. Janë lëshuar 291 fletëpërcjellëse me vëllim prej 917.06 m³. Nga taksat për shërbime të pyjeve private janë inkasuar- 1885.11 €.Taksa për ritransport janë inkasuar – 6 €.
	3. Aktivitetet tjera	<i>Angazhimet në komisione të ndryshme-</i> Stafi i pylltarisë është angazhuar në komisione për verifikimin e druve në pyje private si dhe në regjistrimin e dëmit pyjor.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2020

Arben Halili

Drejtore i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

1. HYRJJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushëveprimtarisë së vetë ka sektorin e shërbimeve publike dhe sektorin e emergjencave.

Sektori i shërbimeve publike mbulon aktivitete që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavor, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara si sheshet, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj, çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fundvitit dhe festave tjera zyrtare.

Gjatë vitit 2020 janë pranuar 1456 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pas shqyrtimeve të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të Drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara, anuluara	Kërkesa në proces, pezulluara
1456	1315	136	5

2.SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

- Gjatë këtij viti kemi pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.
- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror ku për këtë qëllim të kontraktuara janë 5 operatorë ekonomik.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit, kompanitë publike. Vlen të përmenden reshjet e shiut, vërshime dhe stuhi ere në muajin Korrik dhe Gusht, sidomos në fshatrat Sojevë, Gërllicë, Dardani, Zllatar, Talinoc i Muhaxherëve, Bibaj, Fshati i Vjetër si dhe akset rrugore Ferizaj –Gjilan konkretisht te Kampi “Bonsteel” dhe Ferizaj- Prishtinë konkretisht te “Euromiti” dhe Ferizaj-Shkup tek “Eli Abi”.
- Përcjellja e punëve në mbjelljen e 30.000.00 copë luleve verore dhe vjeshtore si dhe 770 copë të drunjve dekorativ në hapësirat e gjelbëruara të qytetit përmes kompanisë publike NPL-AMBIENTI..
- Është bërë krasitja e drunjve dekorativ në sheshin e qytetit në mënyrë profesionale, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara si parqet, sheshet, lapidarët.
- Janë shënuar edhe data me rëndësi mjedisore si Dita e Pranverës, Dita e Tokës dhe Dita e Mjedisit si dhe data tjera me rëndësi ekologjike dhe mjedisore.
- Identifikimi i 41 deponive ilegale me materiale të ngurta dhe urbane në qytet dhe fshatra në bashkëpunim me GIZ-in gjerman si dhe eliminimi i tyre nga ana e kompanive publike K.R.M.,Pastërtia’’ dhe NPL,,Ambienti’.
- Gjatë vitit 2020 është kontraktuar për herë të parë operatori ekonomik për pastrimin e varrezave të qytetit të të gjitha komuniteteve fetare si ato muslimane, katolike dhe ortodokse.
- Mirembajtja e aparateve ultrasonike kundër shpezëve.
- Vendosja e 30 ulëseve dhe 50 shportave të mbeturinave në shkollat e qytetit dhe fshatrave.
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga AKK-së dhe GIZ-i gjerman për menaxhimin e mbeturinave si dhe trajnimeve për kanalizime dhe ujësjellës.
- Mbajtja e punëtorive me AME-në për menaxhimin e fatkeqësive natyrore.
- Pajisja e Shërbimit të Zjarrfikjes me pompa të ujit, fshesa metalike dhe mjete tjera të punës.
- Vendosja e 8 hidrantëve në pika të ndryshme në zonën qendër të Ferizajt të vendosura në këto lokacione: Sheshi “Dëshmorët e Kombit” (afër Hotel “Lybetenit, rruga “Brahim Ademi” (Salla e Sporteve “Bill Clinton”), rruga “Zenel Hajdini” (afër shkollës “Ahmet Hoxha”, rruga “Kadri Zeka” (afër “BAU Market”), rruga “Rexhep Bislimi” (afër Marketit “Eli Ab”), rruga “Riza Matoshi” (afër shkollës fillore - Nikadin), rruga “Ilmi Ferizi” (Talinoc i Muhaxherëve), rruga “Shaban Vika” (afër shkollës fillore – Doganaj);
- Funksionalizimi i Qendrës Operative Emergjente Lokale-QOEL në Ferizaj në kuadër të Shtabit Emergjent Lokal për menaxhimin e pandemisë COVID-19 me orar të veprimit 24/7.

2.1. Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 70.495.55m gjatësi të kanaleve dhe shtretërve të lumenjve si dhe janë vendosur 319 m gjatësi të gypave dhe janë eliminuar 52 m-3 të shkurreve dhe drunjve.

Me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në këto fshatra: Komogllavë, Prelez i Jerlive, Talinoc i Muhaxherëve, Pleshinë, Gërllicë, Kosinë, Koshare, Greme, Gaçkë, Dardani, Sojevë, Mirosalë dhe do të vazhdohet edhe në fshatrat tjerë.

2.2. Largimi i deponive ilegale, masat parandaluese dhe investimet në ndermarrje publike

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastërt si dhe largimin e mbeturinave nga hapësirat publike janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve.

- Kompania KRM, „Pastërtia” dhe kompania NPL, „Ambienti” ka eliminuar rreth 40 deponi ilegale apo rreth 1626 ton mbeturina me materiale inerte dhe ato urbane.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve (gjashtë raste të demolimeve të kulmeve të shtëpive dhe objekteve përcjellëse), të shkaktuara nga era e fortë dhe reshjet atmosferike.
- Gjatë vitit 2020, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar 2 projekte të rëndësishme duke ndihmuar Kompaninë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave duke i furnizuar me 500 komposterë shtëpiak për kompostimin e materialeve biorganike, 16 kontenjerë 1.1 litërsh, 4 kabina për vendosjen e kontenjerëve për mbeturinat e të cilat janë shpërndarë në qytet duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
- Gjithashtu, përmes marrëveshjes tripalëshe në mes të Komunës-Gizi-t dhe KRM Pastërtia, Komuna e Ferizajt ka financuar në blerjen e 3 kamionëve për mbeturina shumë prej 100 mijë eurove.
- Po ashtu gjatë këtij viti është bërë edhe mirëmbajtja e kontenjerëve nëntokësor të vendosur në qytet me ç’rast është bërë mirëmbajtja dhe ndërrimi i pjesëve apo elementeve të dëmtuara të kontenjerëve nëntokësorë si kapakët e shtyllave për hedhjen e mbeturinave, shtyllat për hedhjen e mbeturinave, platformat mbyllëse, rezervarët për hedhjen e mbeturinave, rregullimi i kubëzave mbi platforma.

3. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtëpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuarëve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2020, kemi pranuar kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor.

Gjatë vitit 2020 kemi kryer shumë raste aty ku ka pas mundësi për deblokime në bashkëpunim me kompaninë KRU „Bifurkacioni” kemi bërë deblokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e gypave, dhe kyçjet e reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

3.1. Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2020 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë

funksionit për të cilin janë të dedikuar kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimeve fekale dhe atmosferike në zonat urbane dhe rurale të Komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 7141 metra gjatësi.

Gjatesia e riparimeve të rrjetit të ujësjellësit arrin 1949 metra gjatësi.

3.2. Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavor, riparimi i trotuareve

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetarëve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke patur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar mbi 19826 metra katror të rrugëve me asfalt, mbi 7175.50 metra katror të trotuareve me kubëza si dhe 118445 metra katror të rrugëve me zhavor.

3.3. Mirëmbajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali, druri dhe plastika

Në bazë të nevojave të paraqitura nga institucionet e ndryshme është punuar edhe në mirëmbajtjen dhe vendosjen e konstruksioneve metalike, rrethojave të oborreve të shkollave, rrjetave të fushave sportive, shportave të mbeturinave, ulëseve në riparimin e mureve të objekteve institucionale etj. Keto punë janë kryer kryesisht në objekte arsimore –shkolla dhe fusha sportive, parqe, ura në këto lokalitete: Pleshinë, Doganaj, Koshare, Neredime, Varosh, shkolla “Kuvendi i Arbërit”, Jezerc, shkolla “Zenel Hajdini”, Kosinë, Gaçkë, Parku Liria, shkollat “Tefik Canga”, “Faik Konica”, “Gjon Serreçi” etj.

4. NJËSIA E TRAFIKUT DHE TRANSPORTI RRUGOR

Njësia e trafikut dhe transportit rrugor gjatë vitit 2020 ka pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme si leje për taksit individual, pengesa në rrugë, bllokime të rrugëve, leje për transport të mallrave, kërkesa për shenja të trafikut etj.

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, njësia e trafikut dhe transportit rrugor gjatë periudhës njëvjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

4.1. Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

- Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksit është në një nivel të kënaqshëm, ku nga dyzet e pesë fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, dyzet e dy prej këtyre fshatrave janë të përfshira në transportin publik dhe vazhdimisht inspektohet nga inspektori i transportit.
- Janë miratuar të gjitha kërkesat për vazhdim të lejeve për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve taksit të regjistruara në vitet paraprake,
- Së bashku me inspektorin e transportit janë kryer kontrole të rregullta në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave si dhe kemi bërë vizita të shpeshta edhe në Stacionin e Autobusëve lidhur me mbarëvajtjen e transportit të udhëtarëve me autobus dhe pengesat që janë paraqitur nga disa taksitë brenda Stacionit.

- Në bashkëpunim me inspektorin e trafikut dhe Policinë e Kosovës kemi mbajtur takime të vazhdueshme për mbarëvajtjen e qarkullimit në trafik dhe eliminimin e pengesave të cilat janë paraqitur nga operatorët e transportit me autobus dhe transportuesit e udhëtarëve me automjete taksi.

4.2. Trafiku rrugor

Në këtë pikë është bërë rregullimi teknik i qarkullimit në trafik dhe ngritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, ku së bashku me njësinë e trafikut të Policisë kemi analizuar disa rrugë të qytetit dhe kemi bërë ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt dhe ngritja e këtyre shërbimeve në një shkallë më cilësore për qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve motorike si dhe rregullimin e infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta.

4.2.1. Mirëmbajtja e rrugëve me shenja të trafikut rrugor

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto punë në sinjalizimin e rrugëve me shenja ndriçuese, shenja horizontale dhe shenja vertikale.

4.2.2. Shenjat horizontale të trafikut:

Në rrugët urbane “Zenun Beqa”, “Ali Asllani”, “Alishefik Spahiu”, “Lidhja e Prizrenit”, “Gëzim Sahiti”, “Gjon Serreçi”, “Reçaku”, në fshatin Balaj në rrugën “23 Marsi”, në fshatin Nerodime e Ulët në rrugën “Isuf Sejdiu”, “Vëllezërit Gërvalla”, “Agim Ramadani”, segmenti rrugor fshati Talinoc i Muhaxherëve – Rahovic – Mirash, konkretisht rruga “Hilmi Ferizi”, në fshatin Mirash rruga e lagjes “Cakaj” dhe rruga “Mejdi Xhaferi”, rruga “Xhemajli”, rruga “Sali Salihu”, rruga “28 Nëntori”, “Fatmir Ratkoceri”, “Din Hasiqi” dhe rruga “Dëshmorët e Kombit”.

Në kuadër të shënimit të rrugëve me sinjalizim horizontal në rrugët e qytetit dhe fshatrave janë kryer këto punë:

- Janë shënuar vijat gjatësore për ndarjen e shiritave rrugor në gjatësi rreth 22764.0 [lm],
- Janë shënuar vijat tërthore në rrugë (vendkalimet e këmbësorëve dhe ishujve të ndryshëm për orientimin e trafikut) në sipërfaqe të ngjyrosur rreth 1086 [m²].
- Kemi bërë shënimin e vend parkingjeve publike përgjatë aksit rrugor nën këndin 180° në zonën urbane të qytetit si dhe ato të mbyllura në disa zona të fshatrave në gjatësi rreth 841.6 [lm],
- Kemi shënuar sipërfaqet e parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara (me ngjyrë të kaltër në katër pozicione).
- Kemi bërë shënimin e sipërfaqeve të vend-ndaljeve të autobusëve dhe vend-parkingjeve për automjetet taksi (4 vend-ndalje të autobusëve dhe 11 vend-parkingje taksi).
- Kemi bërë shënimin e shtigjeve për biçikleta në gjatësi rreth 2025 [lm].
- Kemi bërë vendosjen e pengesave rrugore në afërsi të institucioneve arsimore (shkolla, çerdhe) për qetësimin e komunikacionit (19 lokacione).
- Punimi i shigjetave udhëzuese një drejtimesh (24 copë).
- Punimi i shigjetave udhëzuese një drejtimesh (11 copë).

4.2.3. Shenjat vertikale të trafikut

Në rrugët e qytetit dhe fshatrave kemi bërë mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave vertikale të rrezikut, urdhërave të prera dhe shenjat e lajmërimit, ku me prioritet i kemi vendosur shenjat para institucioneve arsimore dhe janë përfshirë vendosja e shenjave për kufizimin e shpejtësisë dhe atyre të paralajmërimit të prezencës së fëmijëve në ato segmente rrugore.

Rrugët në të cilat është intervenuar me shenja vertikale të trafikut:

- Rruga urbane “Ramadan Rexhepi” me rrugët anësore dhe te kryqëzimi me rreth-rrotullim.
- Fshati Koshare – në të gjitha rrugët e asfaltuar brenda fshatit kemi bërë vendosjen e shenjave të trafikut.
- Rruga urbane “Dëshmorët e Kombit”, në të gjithë segmentin e kësaj rruge është bërë vendosja e shenjave vertikale të trafikut për shkak të rikonstruktimit të rrugës.
- Rruga urbane “Motrat Qiriazi”.
- Rruga urbane “Nënë Tereza”,
- Rruga urbane “Aleksandër Moisiu”,
- Rruga urbane “Prekazit”,
- Rrugën urbane “Sterjo Spase” dhe “Sherif Frangu”,
- Rruga urbane “Hamzë Jashari” dhe “Bob Doll”.
- Rrugët urbane “Zenun Beqa”, “Lidhja Prizrenit”, “Arsim Zeqiri”, “Alishefik Spahiu”, “Fehmi Lladrovci” dhe “Gëzim Sahiti”.
- Rrugët urbane “Gjon Serreçi”,
- Rrugën urbane “Rexhep Bislimi” me rrugët anësore.
- Në rrugën urbane “Reçaku”.
- Në të gjitha rrugët e fshatit Cërnillë,
- Në rrugët urbane “Hysen Tërpeza” dhe “7 Shtatori”.
- Në rrugën e fshatit Zaskok rruga kryesore me rrugët anësore.
- Në rrugën “Bekim Osmani”,
- Te SHFMU. “Ahmet Hoxha” dhe “Tefik Çanga”.

Sasia e shenjave vertikale të vendosura në rrugët e lartshënuara :

- Furnizimi dhe instalimi i 127 paneleve rrugore rrethore, trekëndore dhe katrore me dimensione Ø60, 3x900 dhe 600x600 [mm].
- Furnizimi dhe instalimi i 5 paneleve rrugore katërkëndëshe me dimensione 600x900 [mm].
- Furnizimi dhe instalimi i 2 paneleve rrugore katërkëndëshe udhëzuese me dimensione 1250x400 [mm].
- Furnizimi dhe instalimi i 6 paneleve katërkëndëshe për informata shtesë me dimensione 600x300 [mm].

4.3. Kamerate e sigurisë

- Komuna Ferizajt, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë vazhdimisht bënë mbikëqyrjen dhe instalimin e kamerave të sigurisë për nevojat e Stacionit Policor në Ferizajt.
- Këtë vit kemi bërë vendosjen e tridhjetë e tri (33) kamerave të reja të sigurisë, si dhe mirëmbajtjen e njëqind e njëzet e dy (122) kamerave ekzistuese.

4.4. Punë tjera:

- Pjesëmarrja në komisione brenda Komunës,
- Pjesëmarrja në trajnime dhe seminare të ndryshme të organizuara nga DEMOS, USAID, HELVETAS, GIZ, Asociacioni i Komunave etj.
- Vlen të veçohet hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i cili ka filluar të hartohet në vitin 2019 por për shkak të pandemisë ka përfunduar si draft në vitin 2020 e që pritet të miratohet në Kuvend gjatë vitit 2021. Ky projekt është mbështetur nga Asociacioni i Komunave kurse është duke u hartuar nga ekspertët nga Kolegji “Tempulli” në bashkëpunim me zyrtarët adekuat të Komunës së Ferizajt.

5.NJËSIA E NDRICIMIT PUBLIK

- Gjatë vitit 2020 ka vazhduar puna kontinuele në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues si dhe është punuar intenzivisht në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në rrugët dhe hapësirat ku nuk ka pasur ndriçim publik më parë duke u bazuar edhe në mundësitë buxhetore.
- Gjatë vitit 2020 janë vendosur gjithsej 3039 trupa ndriçues LED (poça eficient) dhe atë: 2506 trupa ndriçues 50v, 232 trupa ndriçues 80v, 176 trupa ndriçues 100v, 70 trupa ndriçues 150v, 3 reflektorë 100v, 48 reflektorë 200v, 4 reflektor 400v në rrjetin ekzistues të shtyllave të KEDS-it si dhe në shtyllat e reja (metalike-572 copë dhe atyre të drurit-94 copë) të vendosura nga Komuna. Shprehur në vijë gjatësore gjatë vitit 2020 janë realizuar 109 km ndriçim publik. Ndiriçimi publik si fushë me rëndësi e shërbimeve publike është bërë një infrastrukturë shumë e nevojshme për lëvizjen e lirë. Konform kësaj edhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e ndriçimit publik në hapësirat apo lokalitetet ku ata banojnë janë gjithnjë në rritje.
- Rrjeti i ndriçimit publik po vjen vazhdimisht duke u zgjeruar dhe deri më tani pjesa dërmuese e rrugëve të qytetit dhe fshatrat e Komunës së Ferizajt janë të mbuluar me ndriçim publik dhe me këtë natyrisht është rritur edhe kostoja e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve. Përveç punës në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në fund të vitit 2020 edhe pse vit pandemik si rezultat i COVID-19, me qëllimin e vetëm që të kthehet shpresa për normalitet të jetës së qytetarëve, kemi bërë dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit duke i vendosur dritat dekorative, bredhin e Vitit të Ri dhe elementet tjera dekorative në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, në sheshin para objektit komunal, në sheshin “Hyrë Emini” .
- Këtë vit kemi bërë disa risi dhe zbukurime paksa më ndryshe se viteve tjera në dekorimin e qytetit, të cilat me plotë të drejtë mund të themi se i kanë dhënë një pamje mbresëlënëse qytetit të Ferizajt dhe është listuar si qyteti i dytë më i zbukuruari për festat e fundvitit dhe për këtë treguesit më të mirë

janë qytetarët e Komunës së Ferizajt, të cilët kanë qenë mjaft të kënaqur dhe të cilët më së miri e kanë përjetuar këtë zbukurim gjatë ditëve dhe mbrëmjeve të para Vitit të Ri.

6.NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Në vitin 2020 Shërbimi zjarrfikjes dhe Shpëtimit ka pasur 556 dalje të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë të paraqitura në pjesën e dytë të raportit përmes pjesës grafike të intervenimeve.

Gjatë vitit 2020, Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit pati intervenime nga më të ndryshmet, zjarret, aksidentet, largimin e objekteve të demoluara nga erërat si dhe intervenime tjera të natyrave të ndryshme si rezultat i fatkeqësive natyrore që ishin gjatë vitit 2020.

Duhet potencuar se sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdejt në punën e këtij shërbimi ka qenë numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional, mosplotësimi i kriterëve numerikisht për një shërbim me standarde të parapara me Ligjin Nr. 04/-L-049 dhe Rregullorja NR 16/2012 për numër të banorëve në Komunën tonë.

Poashtu duhet përmendur edhe vonesat nga ana e AME-së si çështje prioritare në zhvillimin dhe avancimin e këtij shërbimi, aktivizimi i Qendrës së Alarmimit dhe Shpëtimit në rr. “Enver Topalli”, ku objekti i ri ka përfunduar me vite por vetëm duhet plotësuar me inventarë shtesë, automjete dhe pranimin e punëtorëve zjarrfikës sipas procedurave të AME-së dhe ligjeve në fuqi.

Gjatë vitit 2020 janë bërë disa investime në furnizimin e këtij shërbimi si në mjete pune (shpinore, lopata zjarri dhe pompa të ujit), gjithashtu nga ana e AME-së ky shërbim është pajisur me rroba profesionale dhe nga Komuna janë pajisur të gjithë zjarrfikësit me rroba dhe veshmbathje pune.

Komuna gjatë vitit 2020 ka bërë investime në vendosjen e 8 hidrantëve të ujit në zonën urbane me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për punë e cila do të ndikoj drejtpërdrejt në sigurinë e jetës dhe të mirave të shoqërisë dhe qytetarëve.

	Muajt	Dalje	Objekte Ndërtimore	Zjarre Malore	Zjarre Fushore	Aksidente I rranku	Autonjete	Pajisje elektrike	Alarme te dymshmita	Sherbime	Intervencime teknike	Mbeturina	Boca Gazi	Objekte te tjera	Vershime	Oxhaqe	Ushqim kalsheve	Gjendje Mobile	Eksplozive	Te lënduar	Te vdekur	Totali
1	Janar	36	0	0	8	1	3	6	0	0	3	7	0	1	0	7	0	0	0	1	0	36
2	Shkurt	59	2	3	16	0	2	7	1	0	13	7	0	2	0	6	0	0	0	2	0	59
3	Mars	78	4	17	24	3	2	2	1	1	3	11	0	4	1	4	1	0	0	4	3	78
4	Prill	67	3	25	17	1	0	2	2	3	0	11	0	1	0	2	0	0	0	0	0	67
5	Maj	26	3	3	2	0	1	1	1	1	3	9	0	2	0	0	0	0	0	0	0	26
6	Qershor	29	2	3	2	1	2	1	2	3	7	4	0	2	0	0	0	0	0	0	0	29
7	Korrik	45	2	0	7	3	1	5	3	1	9	10	1	1	0	0	2	0	0	1	1	45
8	Gusht	46	3	0	8	2	3	4	0	3	14	4	1	1	2	0	1	0	0	1	0	46
9	Shtator	36	0	2	4	2	2	4	0	4	7	9	1	0	0	0	1	0	0	1	0	36

1 0	Tetor	41	1	2	4	0	1	9	2	2	6	10	1	1	0	1	0	1	0	0	1	41
1 1	Nëntor	34	1	1	5	0	2	11	0	0	3	5	1	1	0	4	0	0	0	0	0	34
1 2	Dhjetor	59	6	0	1	0	1	31	1	1	5	3	0	4	0	6	0	0	0	1	0	59
	Totali	55 6	27	56	98	13	20	83	13	19	73	90	5	20	3	30	5	1	0	11	5	556

Tabela: Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera Janar-Dhjetor 2020

**Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenime tjera
Janar-Dhjetor 2020**

NJPZSH - FERIZAJ

Daljet e përgjithshme	Numri i zjarreve	Intervenime Teknike	Aksidente Rrugore	Vërshime	Shërbime	Boca gasi	Gjendje mobile
556	442	73	13	3	19	5	1

**Struktura e zjarreve dhe klasifikimi i tyre gjatë intervenimeve të vitit 2020 nga NJPZSH -
FERIZAJ**

Zjarre në objekte ndërtimore	Zjarre në sipërfaqe të hapura fushore - malore	Zjarre në automjete	Zjarre në pajisje elektrike	Zjarre mbeturinash	Zjarre në oxhaqe	Zjarre në ushqime të kafshës	Alarme të rrejshme	Objek. tjera	Gjithsejt
27	154	20	83	90	30	5	13	20	442